

Rrugat e Arbërit



www.rrugearberit.com

GAZETË E PAVARUR. NR. 8 (112). GUSHT 2015. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

REPORTAZH

Gjinnazistë nga Dibra dhe Franca bashkë në skenë

NGA BENA KËRLUKU - FAQE 9

PROFIL

Kopshti i Breshias, 45 vite në shërbim të fëmijëve

NGA OSMAN XHILI - FAQE 8

STUDIMI

Mbi këngën e Jovan Nokës

Si u rregjistrua kënga? Kush e krijoi dhe kush e këndoi? Çfarë tregonte kënga?

NGA DHIMITËR S. SHUTERIQI - FAQE 18

ESE

Disidencë dibrane

NGA EDMOND HASANI

Tre histori nga Luginë e Drinit të Zi

NGA DIONIS XHAFA

Kam dy Atdhe!

NGA SEFULLA KATA

Zjarret në pyje, dora e njeriut apo ndëshkim i natyrës?

- Zjarri dhe shfrytëzimi pa kriter i pyjeve nuk është një çështje e ditëve të sotme.
- Që pas rrëzimit të sistemit komunist, mbi këtë pasuri natyrore kanë vazhduar masakrat ditë pas ditë, herë me zhurmë e herë në qetësi, herë ditën e herë natën, duke sjellë sot dëme që duan shekuj të riparohen.
- Ndryshimet klimatike dhe rritja e temperaturës ka influencuar në shtrirjen e zjarreve në pyje.
- Shumica e zjarreve ndodhin kryesisht për shkak të pakujdesisë së njerëzve që punojnë dhe kalojnë në pyll, kryesisht barinj, grumbullues lulesh, frutash, rrënjësh, drurësh, vizitorë e turistë.
- Por ka edhe nga ata që vendosin zjarre për konflikte individuale. Ka të dhëna se shumica e zjarreve janë të qëllimshme.
- Zjarret në pyjet e larta janë tentativa për të mbuluar gjurmët e prerjeve të paligjshme.

Intervista dhe opinione ekskluzive nga ekspertët e pyjeve
HAKI KOLA, REXHEP NDREU dhe MUNIR HOXHA

- Pyjet, kjo pasuri e paçmuar
- Zjarret në pyje, një problem i madh e kompleks
- Delegim përgjegjësish të banorët që jetojnë afër pyjeve
- Zjarret shkrumbojnë 100 hektarë me pyje ahu dhe pishë

RAPORT SPECIAL i përgatitur nga Bujar Karoshi, Hamdi Hysuka dhe Hysen Likdisha - Faqe 2,3,4,5,6

Intervista

Së shpejti në Shqipëri një tur kundër racizmit dhe diskriminimit

Inva Halili – Kuhn ka lindur në Peshkopi dhe pas studimeve në Kolegjin Turk në Tiranë, ka studiuar për Shkenca Politike në Vjenë dhe Berlin dhe prej vitesh është aktiviste në lëvizjen e të majtës jashtëparlamentare dhe antikapitaliste, sidomos në fushatat kundër neonazizmit dhe racizmit. Aktualisht jeton në Berlin dhe punon si referente pedagogjike në një projekt mbi ndërhyrjen kundër antisemitizmit.

Bisedoi: HYSEN UKA - FAQE 14-15

“Edhe unë kam një ëndërr”

Eva Zaimin, themeluesen e fondacionit Down Syndrome Albania: Dyqani i luleve DSA, një nga projektet fituese që do të ndihmojë në të ardhmen fondacionin në ndihmë të fëmijëve që vuajnë nga Sindromi Down. Bulqiza mund të bëjë jo vetëm veten e vet Zvicër, por të gjithë Shqipërinë. Herën e fundit që isha pata mundësinë të shëtis mbi një makine me rimorkio liqenet e Dhoksit. Kam qarë si fëmijë, kur kam parë ç’masakër ishte bërë me prerjen e pemëve. Është shumë e trishtë të përballesh me atë pamje, kur për shumë vite ke ruajtur në kujtimet e tua “një paradys”. Me trishton po ashtu fshati im, Zerqani. S’ka më atje rini. Kërkoj me sy shokët e shoqet e fëmijërisë, kushërinjtë... pres që në ato oborre të atyre shtëpive të shoh fëmijët e tyre, por në fakt aty s’ka më zhurmë, siç bënim në njëherë e një kohë. Janë të gjithë në emigrim...

Bisedoi: SASHENKA NDREKA - FAQE 21

Vranjti, fshati që po mirëpret Knauf-in, gjigantin e ekonomisë botërore

Rruga 6 km e gjatë dhe 8 metra e gjerë po ndërtohet me shpejtësi. Rritet vlera e pronës dhe shpresat për punësimin e banorëve. Filozofia e Knauf: bashkëpunim me komunitetin. “Fuqia jonë buron nga toka”, është njëri nga sloganet e kompanisë, kështu që ekologjia dhe ekonomia janë për Knauf të pandara. Zhvillimi i kompanisë lidhet me lëndën e parë, gjipsin. Kjo lidhje me tokën forcon ndërgjegjen e kompanisë për ekologjinë dhe ekonominë.

Nga Miran Tafa, Bujar Karoshi - Faqe 12, 13

KNAUF BASHKËPUNON ME KOMUNITETIN

Në numrat e ardhshëm, intervistë me z. Urim Murati, menaxheri rajonal për Shqipërinë dhe Kosovën i gjigantit të madh botëror Knauf. Gjithçka e detajuar rreth investimit në Vranjt, shfrytëzimin e gjipsit, bashkëpunimin me komunitetin, punësimin, ruajtjen e mjedisit, zhvillimin e ekonomisë lokale etj.

Zjarri dhe shfrytëzimi pa kriter i pyjeve nuk është një çështje e ditëve të sotme. Që pas rrëzimit të sistemit komunist, mbi këtë pasuri natyrore kanë vazhduar masakrat ditë pas ditë, herë me zhurmë e herë në qetësi, herë ditën e herë natën, duke sjellë sot dëme që duan shekuj të riparohen.



Gazetë e pavarur.
Nr. 8 (112). 1 - 31 Gusht 2015

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtorët e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më datë 20 të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "e".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:

Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Korrespondentë të përhershëm:

Sashenka NDREKA
Hysen LIKDISHA
Abdurahim ASHIKU

Kontribuan për këtë numër:

Haki KOLA
Rexhep NDREU
Hysen UKA
Bena KËRLUKU
Osman XHILI
Ramiz GJINI
Edmond HASANI
Ilmi DERVISHI
Vezir MUHARREMAJ
Dionis XHAFI
Sulejman TOMÇINI
Dhimitër S. SHËTERIQUI
Miran TAFI
Sefulla KATA
Nerilda MEDA
Inva HALILI – KUHN
Eva ZAIMIN
Zabit LLESHI

Arkivi i gazetës është ME pagesë në faqen e internetit www.rrugearberit.com.

Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.

Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë. Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:

Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. Ilog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL90202112190000004700036640


Adresa e gazetës:

Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Pyjet në Liqenin e Zi, djegur vite më parë. Banorët e zonës thonë se këto zjarre janë vendosur qëllimisht për të fshehur shfrytëzimin kriminal të pyjeve.
Foto: © Bujar Karoshi, 2014.



Zjarret në pyje, dora e njeriut apo ndëshkim i natyrës?

Nga **BUJAR KAROSHI**

Ndërsa banorët e Fushë Bulqizës protestonin në fillim të gushtit kundër shfrytëzimit të pyjeve në malet mbi fshatin e tyre, duke rrezikuar kurorën e fshatit dhe pasuritë ujore, në anën tjetër të maleve, poshtë Liqenin të Zi, një zjarr i madh mbulonte pyjet e Tërnovës.

Media raportoi se duke filluar nga dhjetëditësi i fundit i korrikut, mbi 100 hektarë pyje me ahe e pisha janë djegur në Malin e Tërnovës. Zjarret u konstatuan nga një roje i një firme private të një hidrocentrali dhe ndërhyrja për t'i shuar ishte shumë e vështirë. Ndërsa Zoti nuk ndihmoi me asnjë pikë reshje.

Zjarri dhe shfrytëzimi pa kriter i pyjeve nuk është një çështje e ditëve të sotme. Që pas rrëzimit të sistemit komunist, mbi këtë pasuri natyrore kanë vazhduar masakrat ditë pas ditë, herë me zhurmë e herë në qetësi, herë ditën e herë natën, duke sjellë sot dëme që duan shekuj të riparohen.

SHKAQET E ZJARREVE

Haki Kola tani është drejtor i Fondacionit CNVP për Kosovën. Për një periudhë të gjatë është marrë me projektet e Bankës Botërore në Shqipëri, kryesisht për çështjet e pyjeve dhe mjedisit. Ai thotë në një intervistë për gazetën se "ndryshimet klimatike dhe rritja e temperaturës ka influencuar në shtrirjen e zjarreve në pyje".

Ndërsa Rexhep Ndreu nga Federata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale, thotë se shumica e zjarreve ndodhin kryesisht për shkak të pakujdesisë së njerëzve që punojnë dhe kalojnë në pyll, kryesisht barinj, grumbullues lulesh, frutash, rrënjësh, drurësh, vizitorë e turistë. Por, thekson Ndreu, ka edhe nga ata që vendosin zjarre për konflikte individuale. Sipas tij, ka të dhëna se shumica e zjarreve janë të qëllimshme.

Haki Kola mendon se shkaku kryesor i zjarreve në pyjet e larta janë tentativa për të mbuluar gjurmët e prerjeve të paligjshme.

Munir Hoxha, një specialist i vjetër i pyjeve, thotë se mungesa e vrojtues-sinjalizuesve të zjarreve vitet e fundit është një

- **Ndryshimet klimatike dhe rritja e temperaturës ka influencuar në shtrirjen e zjarreve në pyje.**
- **Shumica e zjarreve ndodhin kryesisht për shkak të pakujdesisë së njerëzve që punojnë dhe kalojnë në pyll, kryesisht barinj, grumbullues lulesh, frutash, rrënjësh, drurësh, vizitorë e turistë. Por ka edhe nga ata që vendosin zjarre për konflikte individuale. Ka të dhëna se shumica e zjarreve janë të qëllimshme.**
- **Zjarret në pyjet e larta janë tentativa për të mbuluar gjurmët e prerjeve të paligjshme.**

nga arsyet për dëmet e mëdha në pyje. Në rast të sinjalizimit të zjarrit, brenda 2-4 orësh është e mundur izolimi i tij me fuqi të paktë njerëzore, por në qoftë se kanë kaluar katër orë nga zjarri, zjarri është i vështirë për t'u izoluar, sidomos kur fryn erë.

SI MUND TË PARANDALOHEN?

Parandalimi i zjarreve kërkon angazhim në disa fusha. Së pari në hartimin e një legjislacioni bazuar mbi realitetin shqiptar si dhe përfshirjen e komunitetit në mbrojtjen e pyjeve.

"Në 10 vitet e fundit asnjë zjarr në pyjet tradicional ku fermerët ndjehen pronarë, madje ka shumë shembuj nga Selanet, Kalaja e Dodës, Slllovës, Melanit, Kasdriotit që vetë fshati vendos roje gjatë gjithë vitit dhe jo vetëm në verë. Kalaja e Dodes ka 25 vjet që paguan 7 roje nga vetë banorët", thotë Rexhep Ndreu. Sipas tij duhet të bëhet një reformë e shpejtë në këtë drejtim, pasi një pjesë e madhe e pasurisë pyjore në veri, nuk ka shkuar te pronarët e vërtetë.

"25 vjet pas ndarjes nga sistemi centralizuar, privatizimi i tokës është bërë vetëm për tokën bujqësore që ndodhet në fushë, toka e malësorëve në veri e jug, historikisht e qeverisur prej tyre ka mbetur pronë shtetërore. Ajo është kryesisht tokë pyjore dhe administrohet me ligje komuniste. Verilindja dhe veriu janë të varfër pasi fshatarëve u është mohuar padrejtësisht privatizimi i tokës së tyre, vetëm se përdorimi aktual i saj, quhet pyll. Në Pukë fshatarëve u është privatizuar 4% e tokës së tyre, ndërsa në Fier 96 % e

tokës", thotë në një intervistë ekskluzive për gazetën "Rruga e Arbërit", Rexhep Ndreu.

Munir Hoxha vendos theksin në mungesën e një kuadri të specializuar në terren. Vitet e fundit nuk ka kuadër profesional në terren si dhe nuk motivohen edhe ata që janë në punë, për ta ruajtur këtë pasuri kombëtare.

"Pylli është një pasuri e madhe, thotë ai, dhe megjithatë, ne nuk kemi një helikopter për ndërhyrjet në terrene të vështira. Në ndihmë vijnë nga vendet fqinjë, megjithëse sipërfaqja e tyre pyjorë është shumë herë më e vogël, thotë Munir Hoxha.

Haki Kola thotë se "zjarret në pyjet që i kanë në kujdestari fshatrat apo familjet janë më të kufizuara. Nëse ndodhin vihen shpejt në kontroll. Ndaj ky është një shembull se si ky mekanizëm mund të funksionojë për pyjet e lartë që ndodhen më larg fshatrave.

Sipas Kolës, masat shtrënguese e kontrolluese duhen shoqëruar edhe me masa lehtësuese e delegim përgjegjësish te banorët që jetojnë afër pyjeve.

Rexhep Ndreu mendon se nuk duhet neglizhuar edhe edukimi i popullatës në këtë drejtim. Futja e kurrikulave të posaçme në shkolla si dhe ndihma e medias elektronike dhe e shkruar me shkrime dhe emisione të posaçme mund të jape efektet e duhura në mbrojtjen e pyjeve.

Gjithashtu, Ndreu mendon se urgjente është trajnimi i personave që merren me shuarjen e zjarreve, të cilët sot, shumica e tyre janë të patrajnuar.

Shtabet e emergjencës të të gjitha qyteteve duhet të rrisin fuqinë e tyre për të vepruar

Zjarret në pyjet që i kanë në kujdestari fshatrat apo familjet janë më të kufizuar. Nëse ndodhin vihen shpejt në kontroll. Ndaj ky është një shembull se si ky mekanizëm mund të funksionojë për pyjet e lartë që ndodhen më larg fshatrave.

Në 10 vitet e fundit asnjë zjarr në pyjet tradicional ku fermerët ndjehen pronarë, madje ka shumë shembuj nga Selanet, Kalaja e Dodës, Sllövës, Melanit, Kasdriotit që vetë fshati vendos roje gjatë gjithë vitit dhe jo vetëm në verë. Kalaja e Dodes ka 25 vjet që paguan 7 roje nga vetë banorët.

kundër zjarreve me mjetet zjarrfikëse, ndërkohë që edhe vullnetarët dhe çdo qytetare duhet gjithmonë janë të gatshëm të marrin pjesë në aksionet anti-zjarr.

BASHKITË E REJA DHE PYJET

Disa specialistë pyjesh kanë ngritur shqetësimin se me organizimin e ri lokal, nuk janë paraparë kompetencat dhe përgjegjësitë për punonjësit e shërbimit pyjor. Në strukturat e reja për bashkitë deri në fund të këtij viti nuk ka në organikë specialistë, inxhinierë pyjesh për menaxhimin e fondit pyjor e kullor në pronësi pushtetit vendor. Ndaj specialistët ngrenë shqetësimin se si mundet që kjo pasuri e madhe kombëtare nuk është në vëmendjen e pushtetit lokal. Ata që kanë qenë në organikat e ish-komunave tashmë janë pa punë dhe në këtë drejtim, sipas tyre, vihet re një mungesë koordinimi mes Ministrisë së Mjedisit, atij të Pushtetit Vendor dhe bashkive.

Rexhep Ndreu thotë se po punohet për një ligj që pritet të miratohet së shpejti, dhe ky ligj parashikon përgjegjësinë për pasurinë pyjore. Në varësi të formës së pronësisë fondi pyjor dhe kullor, administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, për fondi pyjor e kullor brenda kufijve territorial administrativ dhe ministria për fondin pyjor dhe kullor që është pjesë e rrejtës së Zonave të Mbrojtura të Republikës së Shqipërisë si dhe pronarët privatë për pyjet, kullotat dhe livadhet në pronësi të tyre. Njësitë e qeverisjes vendore ngrenë strukturën e saj për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor dhe kullor brenda kufijve territorial administrativ me personel inxhinier-technik me arsim pyjor. Numri i nëpunësve në strukturën e administrimit të fondit pyjor dhe kullor përzgjidhet në funksion të sipërfaqes: një nëpunës për 750 – 1000 ha për pyjet e lartë; një nëpunës për 1500 – 2500 ha për pyjet e ulët dhe shkurre dhe një nëpunës për 4000 – 6000 ha për kullotat dhe livadhe.

Rexhep Ndreu thotë se “në ngritja e një shërbimi pyjor bashkiak profesional është emergjente. Gjithashtu, duhet të vendosen në detyrë ata specialistë që plotësojnë kriteret profesionale dhe pa dallime partiake. Hartimi i strategjisë së me një plan veprimi për menaxhimin i qëndrueshëm dhe shumë funksional i Pyjeve dhe Kullotave. Nxitja e një decentralizimi të mëtejshëm të pyjeve dhe kullotave duke i dhënë prioritet kalimit dhe zgjidhjes së të drejtave të pronësisë apo të përdorimit tek përdoruesit tradicionalë. Bashkia duhet që pyjet dhe kullotat që ka në pronësi të regjistrojë në pronësi të veten pranë ZRRPP. Mbyllja e këtij procesi do t’i hapë rrugë dhënies në përdorim të pyjeve dhe kullotave përdoruesve tradicionalë për një mbrojtje të sigurtë dhe menaxhim të qëndrueshëm të këtyre burimeve si dhe zjarret”.

Zjarret tashmë ikën bashkë me verën. Por vera tjetër vjen shpejt dhe nuk është asnjëherë vonë të merren masa për ruajtjen e kësaj pasurie kombëtare. Kudo që zjarri bie aty po digjet pak pasuri jona e përbashkët.

Bulqizë, zjarret shkrumbojnë 100 hektarë me pyje ahu dhe pishe



Nga HYSEN LIKDISHA

Disa vatra zjarresh të shfaqura në dhjetditëshin e fundit të korrikut, në Malin e Tërnovës, të ish komunës Zerqan në rrethin e Bulqizës, kanë përshkuar jo pak, por rreth 100 hektarë me pyje ahu e pishe. Këto vatra zjarresh, të ndihmuara edhe nga temperaturat e larta dhe era, janë përhapur me shpejtësi në të gjithë shpatin e malit, duke përparuar edhe në drejtim të kurorës së Liqenit të Zi. Sipas burimeve mësohet se zjarri është konstatuar nga rojet e firmës private që po punojnë në këtë zonë për ndërtimin e Hidrocentralit të Valikardhës, të cilët kanë lajmëruar autoritetet përkatëse si, Bashkinë Bulqizë, Ndërmarrjen Pyjore dhe Komisaratin e Policisë Bulqizë. Një zjarrfikëse e vetme që ka në dispozicion rrethi i Bulqizës, e ka patur të pamundur ndërhyrjen për fikjen e zjarrit, për arsye të terrenit të vështirë malor. Me tu sinjalizuar për rënien e zjarrit në vendngjarje kanë shkuar forca të policisë, Ndërmarrjes Pyjore dhe Bashkisë Bulqizë, të ndihmuar edhe nga vullnetarë banorë të zonës. Një ndihmesë të madhe për fikjen e zjarreve ka dhënë edhe firma ndërtuese e HEC-it të Valikardhës, që ka vënë në dispozicion forca materiale dhe njerëzore. Kështu me mjete të saj, firma ka punuar për hapjen e kanaleve, për ndërprerjen e flakëve dhe izolimin e tyre që ata të mos përparojnë në drejtim të kurorës së Liqenit të Zi, ku ata po punojnë për vendosjen e tubacioneve të HEC-it. Megjithatë këtë ndërhyrje, flakët e zjarreve të shtrira në një sipërfaqe të madhe, për asnjë rast nuk janë vënë nën kontroll të plotë, por kanë vijuar për ditë e javë të tëra. Në asnjë rast vatrave të zjarreve nuk janë neutralizuar plotësisht, gjë e cila ka bërë që ata të riaktivizohen herë pas here. Sipas policisë lokale të Bulqizës, një situatë e tillë ku shuarja e flakëve ka qenë e pamundur, ka bërë që të kërkohet ndërhyrje urgjente nga ajri, pasi zjarri i fuqishëm për çdo ditë e më tepër i afrohej Liqenit të Zi, ku prekja e kurorës së tij u sjell dëme serioze banorëve të zonës së Zerqanit, pasi ka lidhje direkte me burimet e ujit të pijshëm dhe për vaditje, por jo vetëm pasi Liqeni i Zi është shpallur “Park Natyror” dhe si i tillë mbetet një resurs dhe atraksion turistik me mjaft vlera edhe pse ende mbetet i virgjër në këtë drejtim për mungesë infrastrukture.

DYSHIMET PËR ZJARRVËNIEN

Sipas policisë lokale mësohet se vazhdojnë hetimet për të përcaktuar shkaqet e kësaj zjarrvënie, e cila mund të jetë e qëllimshme, por nuk përjashtohet rasti dhe pakujdesia e ndonjë bariu që kullot bagëtitë në këtë rajon. Në shumë raste zjarrvënia në pyje bëhet qëllimisht nga

ana e barinjëve të cilët kërkojnë kështu që të zgjerojnë sipërfaqet e kullotave për bagëtitë, duke sjellë kështu dëme serioze dhe me pasoja për pyjet. Ndaj Policia dhe Shërbimi Pyjor i rrethit të Bulqizës, u kanë bërë thirrje banorëve me anë të mediave që të jenë tejet të kujdesshëm për të mos përdorur lëndë ndezëse në zonat pyjore, pasi një pkujesi e vogël në këtë drejtim mund të bëhet shkak për zjarrvënie. Gjithsesi hetimet vazhdojnë dhe do të jenë ditët në vazhdim ata që do të përcaktojnë shkaktarët e vërtetë të kësaj zjarrvënie me pasoja të rënda, pasi dihet mirfilli se pyjet dhe kullotat janë burimet më të rëndësishme natyrore të vendit. Me këto pasuri janë të lidhura interesat jetësore, ekonomike dhe ekologjike të popullatës si në qytete dhe në fshatra. Por këto interesa janë cënuar ndjeshëm, po të kemi parasysh se veç zjarreve, kjo zonë pyjore e një rëndësie të veçantë, po dëmtohet gjatë këtyre ditëve edhe nga prerjet e paligjshme. Për çdo ditë 5-6 “Ifa” të ngarkuara me dru zjarri kontrabandë, zbresin nga kjo zonë nëpërmjet rrugës dytësore “Vorret e Vrame”- Zerqan, për t’iu shmangur kontrolleve të policisë pyjore dhe askush të paktën deri më tani nuk është interesuar për ta parandaluar një masakër të tillë në Malin e Tërnovës.

RREZIKU I ZJARREVE VAZHDON TË MBETET

Vatrave të zjarreve të rena në Malin e Tërnovës, asnjë herë nuk janë neutralizuar plotësisht, por janë përgjumur e riaktivizuar kohë pas kohe. Kështu edhe shiu i rënë në këtë zonë në mbremjen e 16 gushtit, vetëm se i ka përgjumur këto vatra. Por riaktivizimi i ndonjërisë apo disa prej tyre, mbetet permanent, thotë Shukri Lica, roje i makinerive të firmës ndërtuese të HEC-it të Valikardhës, që punon në zonën e rënies së këtyre zjarreve. - Kështu ka ndodhur edhe herë të tjera, ku është dukur se zjarret janë fikur, por krejt befasisht pas disa ditësh janë rishfaqur përsëri, thotë Shukriu. - Kështu duket sikur janë fikur, por vatrave të zjarreve janë të shumta dhe ka prej tyre që janë tejet të fuqishme ku janë djegur ahe dhe pisha qindra vjeçarë, të cilat nuk mund ti fikë një shi i rënë në disa orë të ditës, thotë Qemal Lila, një tjetër roje i firmës së ndërtimit të HEC-it. Gjithsesi temperaturat e larta, numri tejet i madh i vatrave të zjarreve, sipërfaqja tejet e madhe e përhapjes së zjarreve, në masivin pyjor të Tërnovës, lënë në ankth banorët e fshatrave të Zerqanit, pasi dëmet për ta janë të rënda, po të kemi parasysh se ata lidhen me vetë jetën dhe të ardhmen e tyre dhe të fëmijëve. Por, në ankh mbeten edhe punonjësit e firmës së ndërtimit të HEC-it të Valikardhës, pasi befasia e përhapjes së flakëve mund tu dëmtojë makineritë dhe shtrirjen e tubacioneve të marrjes së ujit nga Liqeni i Zi.

Kërkohen korrespondentë në Peshkopi dhe Dibër të Madhe

Gazeta “Rruga e Arbërit” kërkon korrespondentë zyrtarë për PESHKOPINË dhe DIBRËN E MADHE. Të interesuarit duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.

Të interesuarit të shkruajnë email në adresën

<rrugaearbërit@gmail.com> ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Redaksia

Intervistë me z. Rexhep Ndreu nga Federata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale: Pyjet dhe kullotat janë burimet më të rëndësishme natyrore, pasuri e ripërtërishme, ku janë të lidhura interesat jetësore, ekonomike dhe ekologjike të njerëzve në qytete, por veçanërisht në fshatra.

Zjarret në pyje, një problem i madh e kompleks

- Zjarret shkatërruan mbi 100 hektarë pyje në Malin e Tërnovës. Pse mendoni se zjarret në pyje janë shtuar vitet e fundit?

REXHEP NDREU: Pyjet dhe kullotat janë burimet më të rëndësishme natyrore, pasuri e ripërtërishme, ku janë të lidhura interesat jetësore, ekonomike dhe ekologjike të njerëzve në qytete, por veçanërisht në fshatra.

Zjarret e pyjeve paraqiten si një problem i madh e kompleks, i cili është përtej marrëdhënies së thjeshtë me klimën, në origjinën e shumë pasojave mjedisore, sociale dhe ekonomike. Humbja e habitateve, erozioni dhe emetimet e CO2 janë shembuj të pasojave ekologjike, ndërsa ndikimi në shëndetin e njeriut, aktivitetin bujqësor dhe turistik, si dhe të tregut rajonal të punës janë shembuj të efekteve shoqërore, ekonomike dhe ekologjike.

Janë të shumta dhe komplekse arsyet e rënies së zjarreve në Shqipëri. Kemi të dhëna që flasin se pothuajse shumica janë zjarrvënie të qëllimshme, kryesisht në jug, ku protagonistë janë çobanët, të cilët e kanë për traditë të përdorin këtë teknikë të rrezikshme për të rigjeneruar kullotat, për të vrarë insektet dhe përmirësuar cilësinë e barit të tyre. Ndërsa në pjesët tjera të Shqipërisë zjarret ndodhin kryesisht për shkak të pakujdesisë së njerëzve që punojnë dhe kalojnë në pyll (barinjë, grumbullues lulesh, gjethesh, frutash, rrënjësh, krandsesh, drurësh, vizitorë e turistë). Të gjithë e dimë se nga fillimi i lulëzimit të drurëve pyjorë dhe deri në vjeshtë, kur grumbullohen frutat e pyllit njerëzit janë të pranishëm dhe shpesh nga një pakujdesi në ndezjen dhe fikjen e zjarreve, ndezjen dhe fikjen e cigareve bëhen shkak të rënies së zjarreve. Ka patur në disa raste në Shqipërinë e mesme njerëz që tentojnë të vënë zjarre të qëllimshme për të tjetërsuar sipërfaqen pyjore dhe kullosore për ta shndërruar në ullishte e pemtore. Ka dhe nga ata që i vënë zjarrin pyllit sepse kanë konflikte individuale për përdorimin e tij. Nga përvoja në asnjë rast, zjarret në Shqipëri nuk duket të jenë shkaktuar drejtpërdrejt nga temperaturat e larta apo reaksionet ektozotmike, por temperaturat kanë ndikuar në përshkallëzimin dhe përhapjen e shpejtë të flakëve sidomos këtë vit, ku dhe në zonat më të largëta temperaturat i kaluan 40 °C.

- A mendoni se janë mundësitë e parandalimit të tyre?

REXHEP NDREU: Teknikat e luftimit të zjarreve në botë janë duke u sofistikuar, tanimë përdoren edhe informacionet me satelit për të monitoruar tokën e thatë dhe për të paralajmëruar zjarret e mundshme në avancë, gjëra të tilla në Shqipërinë duket akoma e pamundur.

Këtë vit është aktivizuar sistemi i vrojtimit-sinjalizimit, bazuar në një skemë efikase menaxhimi ku thuhet se janë përfshirë rreth 110 vrojtues, sinjalizues dhe roje mjedisore nga Drejtoritë e Shërbimit Pyjor, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Inspektoriat Shtetëror i Mjedisit dhe i Pyjeve si dhe 130 punonjës të punësuar me kontrata provizore si dhe baza materiale dhe logjistike ekzistuese. Duhet të pranohet se deri më tani në nivel Kombëtar rastet e rënies së zjarreve janë më të pakta dhe për pasojë dhe dëmtimet dhe djegiet janë më të reduktuara.

Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me Ministrinë e Tjera dhe strukturat e Emergjencave Civile duhet të përcaktojë masa të përhershme, domethënë gjatë gjithë vitit dhe jo vetëm në periudhën e zjarreve në pyje: masat parandaluese, masat përgatitore, masat e lokalizimit dhe shuarjes. Për këtë shteti shqiptar i adreson këto çështje në Kushtetutë dhe ligjet e tjera dhe me aktet nënligjore. Meqë pyjet janë një thesar kombëtar, të gjithë qytetarët janë përgjegjës për parandalimin e zjarreve.

Por, sipas mendimit tim, te masat parandaluese "edukimi" mbetet faktor i rëndësishëm që duhet përmirësuar në vazhdimësi me të gjithë grup-moshat dhe veçanërisht, trajnimet, leksione të ndryshme për parandalimin e zjarrit në pyje e kullota. Futja si kurrikula të posaçme në shkollat është njëra nga mënyrat.

Media elektronike dhe e shkruar gjithashtu,



përmes artikujve, emisioneve të posaçme etj., mund të ndihmojë në edukimin. Libra me fotografi apo lojëra të ilustruara që përfshijnë përmbajtjen, e cila ka të bëjë me mbrojtjen kundër zjarreve të pyjeve dhe që janë efektive për fëmijët parashkollorë dhe shkollorë. Për të arritur një sukses më të madh, masat informative – propaganduese mund të kombinohen me masat edukative. Gjatë viteve të fundit ne kemi realizuar trajnime për zjarret në Kukës, Dibër, Pukë, Mirditë, Berat, Elbasan dhe rezultoni se mungojnë masat dhe mjetet për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri, në shumë raste ka mungesë fondesh, pajisjet dhe mjetet e nevojshme për një operacion të shuarjes së zjarrit.

Personat që marrin pjesë në operacionet e shuarjes së zjarreve shpesh janë të pa trajnuar, mungojnë planet paraprake për edukimin dhe masat parandaluese, vështirësi në mbërritjen në terrene të prekura dhe rrezikuara nga zjarret, mosnjohje e mirë e bazës ligjore për rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve në rastet e zjarreve. Shtabet e emergjencës të të gjitha qyteteve kanë deklaruar pafuqinë e tyre për të vepruar kundër zjarreve në pyje, për shkak të terrenit, ndërkohë që edhe vullnetarët jo gjithmonë janë të gatshëm të marrin pjesë në aksionet anti-zjarr. Pavarësisht të gjitha fenomeneve që përmendëm më lartë, ka shembuj shumë pozitiv nga e gjithë Shqipëria që tregojnë për përgjegjshmërinë e njerëzve.

Në 10 vitet e fundit asnjë zjarr në pyjet tradicionale ku fermerët ndjehen pronarë, madje ka shumë shembuj nga Selanet, Kalaja e Dodës, Sllövës, Melanit, Kastriotit që vetë fshati vendos roje gjatë gjithë vitit dhe jo vetëm në verë. Kalaja e Dodes ka 25 vjet që paguan 7 roje nga vetë banorët.

- Si mendoni në lidhje me legjislacionin shqiptar, a është i plotë në drejtim të ndëshkimit ndaj zjarrvënësve dhe dëmtuesve të pyjeve në përgjithësi?

REXHEP NDREU: Për fat të keq që nga e kaluara e deri sot, shfrytëzimi i pakontrolluar, mbikullotja dhe zjarret kanë çuar në degradimin e pyjeve dhe të tokës, për rrjedhojë me mjaft probleme për vendin.

Rezultat i tyre janë: erozioni, i kthyer në problem kombëtar, degradimi i tokës, pakësimi i sipërfaqes së pyjeve dhe mungesa e produkteve pyjore. Kjo filloi në vitet 70' dhe 80' por po vazhdon edhe në ditët tona.

Legjislacioni përcakton masat dhe aktivitetet të cilat duhet të merren nga subjektet përgjegjës, për parandalimin e zjarreve në pyje sikurse dhe dënimet për të vepruar në përputhje me ligjin. Disa nga ligjet bazë të miratuara janë: Ligji Nr. 8.756, datë 26.3.2001 "Për Emergjencat Civile", Ligji Nr. 8766, datë

5.4.2001 "Për mbrojtjen nga Zjarri dhe për Shpëtimin", Ligji Nr. 8934, datë 5.9.2002 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", Ligji Nr. 8.897, datë 16.5.2002 "Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja", Ligji Nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor" Etj..

Sipas ligjit Nr.8756, datë 26.3.2001, për emergjencat Civile (neni 11)... Çdo ministër është përgjegjës për organizimin e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile në veprimtarinë që ka në përgjegjësi. a) Hartojnë planet për përgatitjen për emergjencë civile sipas llojit të veprimtarisë dhe të përgjegjësisë të tyre dhe i paraqesin këto në Ministrinë e Pushtetit Vendor për bashkërendim. b) Zbatojnë planet dhe përcaktojnë masat për parandalimin e fatkeqësive natyrore ose të fatkeqësive të tjera dhe të pasojave nga fatkeqësi të tilla në fushën e përgjegjësisë së tyre.

Po sipas Ligjit, Prefekti ka detyrë të organizojë dhe të bashkërendojë punën për hartimin e planeve të përgatitjes për emergjencë civile në qark dhe për zbatimin e masave të mbrojtjes; të grumbullojë dhe të përpunojë të dhënat e nevojshme nga bashkitë dhe komunat për zbatimin e detyrave të planizimit dhe përballimit të emergjencave civile; etj... g) të caktojë drejtuesin e operacionit për përballimin e emergjencës civile brenda qarkut të tij.

Kryetari i bashkisë ka për detyrë: të drejtojë organizimin dhe bashkërendimin e punëve për hartimin e planeve të përgatitjes për emergjencë civile në bashkinë dhe në komunën përcaktuese dhe për zbatimin e masave të mbrojtjes; të grumbullojë dhe të përpunojë të dhënat e nevojshme nga njësitë administrative të bashkisë dhe komunës për zbatimin e detyrave të planizimit dhe përballimit të emergjencave civile; të organizojë sistemin e lajmërimit të popullatës për rrezikun dhe të kujdeset për funksionimin e mjeteve të lajmërimit; të parashikojë burimet dhe rezervat e nevojshme për sistemimin e popullatës në raste të emergjencës nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera; të realizojë organizimin, bashkërendimin dhe pajisjen e forcave operacionale.

Organet e shërbimit pyjor, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore dhe me strukturat e shërbimit për mbrojtjen nga zjarri dhe të shpëtimin, organizojnë punën për parandalimin e zjarrit në fondin pyjor kombëtar.

Rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe në kullota, si dhe për krijimin e njësitë të shuarjes së zjarreve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në zonat pyjore, të caktuara për çlodhje, argëtim, turizëm dhe për prirjen e publikut, organet e shërbimit pyjor caktojnë vendqëndrimet dhe rrugët e lëvizjes, si dhe vendet ku mund të lejohet ndezja e zjarreve.

Për dëmtuesit masat ndëshkimore duhet

Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me Ministrinë e Tjera dhe strukturat e Emergjencave Civile duhet të përcaktojë masa të përhershme, domethënë gjatë gjithë vitit dhe jo vetëm në periudhën e zjarreve në pyje: masat parandaluese, masat përgatitore, masat e lokalizimit dhe shuarjes.

Meqë pyjet janë një thesar kombëtar, të gjithë qytetarët janë përgjegjës për parandalimin e zjarreve. Por, sipas mendimit tim, te masat parandaluese "edukimi" mbetet faktor i rëndësishëm që duhet përmirësuar në vazhdimësi.

ashpërsohen dhe ne kemi kërkuar ndryshimin e ligjit.

Ministria e Mjedisit po punon për hartimin e ligjit të ri për pyjet dhe kullotat. Ligji duhet të njohë përdoruesit aktualë të pyjeve komunalë në nivel familje, fisi dhe fshati, si dhe të drejtën e tyre jo thjesht për përmbushje të nevojave personale, por edhe për përfitim ekonomik.

- Si e mendoni ju zgjidhjen e këtij problem?

REXHEP NDREU: Ngritja e një shërbimi pyjor bashkiak profesional. Të vendosen në detyrë ata specialistë që plotësojnë kriteret profesionale dhe pa dallime partiake. Pas kësaj duhet hartimi i strategjisë së me një plan veprimi për menaxhimi i qëndrueshëm dhe shumë funksional i Pyjeve dhe Kullotave. Nxitja e një decentralizimi të mëtejshëm të pyjeve dhe kullotave duke i dhënë prioritet kalimit dhe zgjidhjes së të drejtave të pronësisë apo të përdorimit tek përdoruesit tradicionalë (familje, fis, fshat). Si fazë tranzitore, mbi bazën e legjislacionit aktual Bashkia duhet të fillojë kalimin e pyjeve në përdorim të përdoruesve tradicional mbështur me dokumentacionin ligjor të regjistruar në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive Paluajtshme (ZRRPP). Për arritjen e këtij qëllimi Bashkia duhet fillimisht që pyjet dhe kullotat që ka në pronësi të regjistrojë në pronësi të vetën pranë ZRRPP. Mbyllja e këtij procesi do t'i hapë rrugë dhënies në përdorim të pyjeve dhe kullotave përdoruesve tradicionalë për një mbrojtje të sigurtë dhe menaxhim të qëndrueshëm të këtyre burimeve si dhe zjarrjet.

Rritja e bashkëpunimit me Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave (SHPPKK) dhe mbështetja në misionin e tyre. Përmirësimi i praktikave menaxhuese të pyjeve, duke i dhënë prioritet menaxhimit të pyllit të familjes si pikënisje e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve bashkiake. Mbështetja e menaxhimit të shumëfishtë duke përfshirë biomasën për zhvillimin e energjisë së rinovueshme dhe stokimin e karbonit.

Komunitetet dhe familjet që menaxhojnë këto pyje ndeshen me shumë sfida, por ndoshta ky problem i mosdukshmërisë është shkaku i të gjitha të tjerave dhe e vështirëson gjetjen e zgjidhjeve efektive. Sfida kryesore e Shoqatës Kombëtare të Pyjeve e Kullotave Komunale (SHKPKK) është gjetja e rrugëve për t'u bërë të dukshme burokratëve, juristëve, drejtuesve apo shkencëtarëve të qytetit, këtë realitet rural, si dhe të gjendet mënyra që të shpjegohet se nëse do të stimulojmë shtimin e peshkut, mbjelljen e hardhive e pemëve frutore, përpunimin e bimëve mjekësore, e nëse do të rregullojmë juridikisht pronësinë mbi pyllin e familjes, kontribuojmë në pakësimin e erozionit apo që fshatrat e malet e shpatet të duken më të gjelbër

(Vijon në faqen 10)

Flet Haki Kola, Drejtor i Fondacionit CNVP për Kosovën: Ka vite që flitet për mundësinë që rikthimi i pyjeve të mundësohet duke qartësuar të drejtat dhe detyrimet e banorëve, por duke zbatuar edhe skema që janë filluar, por kanë mbetur shumë të kufizuara, skema të pagesave për shërbime mjedisore.

Delegim përgjegjësish te banorët që jetojnë afër pyjeve



- Zjarret, edhe këtë vit, bënë një dëm të konsiderueshëm në pyje. Media ka raportuar se në Zërqaq mbi 100 hektarë pyje ahu dhe pishe janë djegur, ndërsa burime të tjera thonë se kjo sipërfaqe mund të jetë edhe më e madhe. Sipas jush, pse janë shtuar zjarret

në pyje kohët e fundit?

HAKI KOLA: Janë dy arsye themelore, e para janë ndryshimet klimatike dhe rritja e temperaturës që kanë influencuar në dy ekstreme, në rrebeshet e përmytjet e papitura dhe në rritjen e temperaturave gjatë periudhës së thatësirës gjatë verës. Kjo, sipas mendimit tim, ka influencuar në shtrirjen e zjarreve në pyje.

Arsyeja e dytë qëndron në anarshinë që e shoqëroi kalimin nga ekonomia e centralizuar në atë të tregut. Pas viteve 1990 pylli shqiptar e mbajti një pjesë të madhe të barrës së lëvizjes së popullsisë drejt qyteteve kryesore, si burim lënde druri por edhe si burim jetese. Kjo e shtoi tej mase aktivitetin ilegal në pyjet e Shqipërisë pas viteve 1990. Pylli mbeti një pronë shtetërore, e cila u gjeneronte banorëve të ardhura financiare. Vetë shteti i shkriu strukturat që e menaxhonin pronën e tij. Këto ishin ndërmarrja e shfrytëzimit të pyjeve bashkë me ndërmarrjen e pyjeve. Këto dy struktura bashkëvepronin për të realizuar menaxhimin legal të pyllit dhe ndërsa ndërmarrja e shfrytëzimit realizonte zbatimin e planeve të menaxhimit, ndërmarrja e pyjeve bënte planifikimin vjetor e shumëvjeçar si dhe monitoronte zbatimin e tij.

Shkrimi i këtyre dy strukturave që kishin bashkëvepruar me pyllin për më se gjysmë shekulli krijoi një boshllëk. Ndërmarrjet e vogla të shfrytëzimit që sapo u krijuan nuk kishin ekspertizë e pajisje. Vetë drejtoritë e pyjeve që u mbeti detyra e planifikimit dhe e monitorimit pas viti 1992 ishin të papërgatitura për ta kryer atë detyrë. Pra, u krijuan një boshllëk, i cili u mundësoi kontrabandistëve të merrni komandën për më se dy 10 vjeçarë.

Banka Botërore dhe të tjerë donatorë asistuan për ta kapërcyer këtë situatë, duke mbështetur përfshirjen e komuniteteve. Kjo është histori më se 20 vjeçarë, e cila për pjesën ku fshati e familja u angazhuar rezultoi me një pejsazh të ri e rreth fshatrave ku pylli i dushkut është rritur, duke krijuar në shumë vende pamje të bukura të fshatit. E kundërta ka ndodhur me pyllin malor që mbeti jetim. Ai pothuaj është prerë plotësisht.

Sipas mendimit tim, shkaku kryesor i zjarreve në pyjet e larta është pikërisht tentativa për të mbuluar gjurmët e prerjeve të paligjshme. Lajmi i keq është se atje ku kalon njëherë zjarri terreni bëhet shumë i ndjeshëm dhe janë shumë të mëdha shanset që zjarri të kthehet në ciklik, i përsëritshëm në çdo 4 - 5 vite që japin kohë të rritet biomasa, që në këtë rast bëhet si grumbullim karburanti dhe në çdo 5 vite që temperaturat e korrik-gusht-shtatorit janë të larta e mungojnë pothuaj totalisht reshjet, zjarret marrin përmasa gjigande. Ka shumë pyje që



janë djegur mbi 3 here në 20 vitet e fundit duke krijuar pasojë shumë të rënda për ripërtëritjen

- A mendoni se janë mundësitë e parandalimit të tyre?

HAKI KOLA: Një mik nga Mustafa më tregonte para disa vitesh, që fshati ishte detyruar që të paguante roje nga zjarri në periudhën korrik - shtator. Kjo për faktin se pylli i dushkut është rikthyer në Mustafa dhe në shumë lagje ka mbuluar edhe shtëpitë. Pra, nuk rrezikohej vetëm pylli nga zjarri, por edhe shtëpitë. E në fakt, me sa di unë, zjarret në pyjet që i kanë në kujdestari fshatrat apo familjet janë më të kufizuara. Nëse ndodhin vihen shpejt në kontroll. Ka edhe mekanizma që kjo të funksionojë për pyjet e larta që ndodhen më larg fshatrave.

Unë mendoj se masat shtrënguese e kontrolluese duhen shoqëruar edhe me masa lehtësuese e delegim përgjegjësish te banorët që jetojnë afër pyjeve. Ka vite që flitet për mundësinë që rikthimi i pyjeve të mundësohet duke qartësuar të drejtat e detyrimet e banorëve, por duke zbatuar edhe skema që janë filluar, por kanë mbetur shumë të kufizuara, skema të pagesave për shërbime mjedisore. Mustafa e ruan pyllin. Pylli jep një kontribut jo vetëm për Mustafën e Dibrën por për shoqërinë e planetin tonë. Në shkallë vendi janë përfshirë rreth 6 mijë hektarë pyje në skemat për sekuestrimin e karbonit. Kjo ka filluar para 10 vitesh dhe mundësitë e interesimi i banorëve lokale ka qenë për të përfshirë mbi 100 mijë hektare. Po ashtu, ka skema të tjera për biodiversitetin, ruajtjen e hidrocentraleve nga mbushjet e plot të tjera. Metodatat e propozuara bujqësore, pyjore ekologjike, të cilat mbështeten në zëvendësimin e lëndëve djegëse fosile nga biomasa, për të siguruar

ushqim të shëndetshëm dhe të punës dhe sekuestrimit të karbonit.

Projektet për shërbime mjedisore synojnë në mbështetje të biomases e të energjisë së rinovueshme, ashtu siç e kanë prodhuar nga zabeli e pylli fshatarët, energji e prodhuar në vend duke punësuar banorët, por edhe në vend-kontrolluar. Këto metoda shpërblehen pasi ndikojnë në ulje të emetimeve të karbonit, duke i mbajtur produktet nga burimet natyrore në komunitete. Kjo çon edhe në uljen e kostove, shtim të punësimit e sigurimit të nevojave për energji, si e drejtë themelore e njeriut.

Një energji që harxhohet duke e djegur pyllin, mund të vijë nga pylli duke i shërbyer mirërritjes së tij. Zbatimi i të tilla projekteve nëse ndodh do të mbjellin fara e të cilave do të japë fryt të mjaftueshme për këdo që kujdesen për të kërkuar ndryshim dhe do të kontribuojë për të ndërtuar një model të demonstruar për qeverinë dhe njerëzit duke i ndryshuar praktikatat aktuale, ku biomasa dhe dielli ngaqë keqmenaxhohen, me djegie në vend që të na ngrohin, modelet janë të mundshme dhe mund të premtojnë një të ardhme të bukur të Shqipërisë. Por, modelet e aplikuar kanë mbetur spontane dhe nuk ka një politikë të qartë nga qeveria, megjithëse ka interesim të donatoreve, por ata nuk mund të bëjnë detyrat e qeverisë apo shoqërisë tonë.

Nëse ne bëjmë rregullime ligjore, zbatimi i këtyre skemave është i mundshëm. Përndryshe, edhe një projekt që financohet aktualisht nga Banka Botërore për shërbimet mjedisore, duket si i patokëzuar e do mbetet thjeshtë raporte të bukura pa impaktin e mundshëm. Pra, Shqipëria nuk ka patur zjarre, ose ato kanë qenë të kufizuara. Teorikisht, pyjet e ahut nuk vetëdijgen pasi janë në vende të freskëta. Shqipërinë e ka kapur sëmundja e zjarreve

Shkrimi i këtyre dy strukturave që kishin bashkëvepruar me pyllin për më se gjysmë shekulli krijoi një boshllëk. Ndërmarrjet e vogla të shfrytëzimit që sapo u krijuan nuk kishin ekspertizë e pajisje. Vetë drejtoritë e pyjeve që u mbeti detyra e planifikimit dhe e monitorimit pas viti 1992 ishin të papërgatitura për ta kryer atë detyrë. Pra, u krijuan një boshllëk, i cili u mundësoi kontrabandistëve të merrni komandën për më se dy 10 vjeçarë.

Projektet për shërbime mjedisore synojnë në mbështetje të biomases e të energjisë së rinovueshme, ashtu siç e kanë prodhuar nga zabeli e pylli fshatarët, energji e prodhuar në vend duke punësuar banorët, por edhe në vend-kontrolluar.

që ngjan me atë të drogës apo alkoolit, është sëmundje që ekologjikisht krijon ndërvarje dhe kërkon kohë që kjo sëmundje, duke u trajtuar të shërohet. Unë kam frikë se akoma nuk është diagnostikuar kështu që shërimi mund të vonojë.

- Si mendoni në lidhje me legjislacionin shqiptar, a është i plotë në drejtim të ndëshkimit ndaj zjarrvënësve dhe dëmtuesve të pyjeve në përgjithësi?

HAKI KOLA: Që të jem i sinqertë, nuk jam krejt familjar me ndryshimet e plotësimit që janë bërë këto 6 vitet e fundit që unë punoj në Kosovë. Por, kjo pyetje me kujtoi një situatë të pakëndshme kur punoja për zbatimin e projektit të financuar nga Banka Botërore për pyjet. Ishte viti 2003, kur në diskutim me përfaqësues të komisionit EU, ramë dakord për një projekt për kontrollin më të mirë të zjarreve. Kishim një avantazh që në bashkëpunim me FAO ishte miratuar edhe një strategji për kontrollin e zjarreve. Projekti që e shkruam ishte kryesisht në zbatim të strategjisë për pajisje por edhe asistencë për ndërgjegjësim e përgatitje të kuadrit ligjor. Projekti i kaloi me sukses dy etapa të miratimit, dhe me pas u hodh poshtë në atë kohë nga Ministria e Bujqësisë. Unë dua të besoj se kjo ndodhi nga padija. Në fakt, u argumentua se kishte shumë asistencë teknike. Sidoqoftë, fakti që kemi kontroll të zjarrit në sipërfaqet bujqësore e zonat urbane tregon se nëse ligji zbatohet është e mundshme edhe në tokat pyjore. Por, e ritheksoj që të shkruash një ligj të mirë duhet të bazohesh në strategji.

Le të shpresojmë se dikush e ka ruajtur në sirtar atë strategji të përgatitur në vitin 2002-2003 e të ketë një reflektim.

Bisedoi: Bujar Karoshi

OFROJMË
 redaktime - korrigjime
 - ftesa - fletëpalosje
 - fotokopje - kartvizita
 - printime - lidhje libri duke filluar nga 1 kopje e vetme!
 Çmime të favorshme dhe shpejtësi!
 Telefono: 068 65 08 441

LIBRI PRANË JUSH
 LIBRARIA FLETA XXI,
 PRANË MUZEUT,
 PESHKOPI

Bëj pajtimin tënd me

 përmes emailit
 <rrugaearberit@gmail.com>
 Një pajtim vjetor kushton:
 Në Shqipëri: 600 lekë.
 Në Europë: 10 Euro.
 Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
 Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Kontribuo për vendlindjen duke u pajtuar në gazetën
RRUGA E ARBËRIT
 Merr versionin PDF ose kopjen print.
 Për informacion shkruaj:
 rrugaearberit@gmail.com



Pyjet, kjo pasuri e paçmuar

Nga **HAMDI HYSUKA**

Mati ka bukuri të shumta mjedisore e natyrore. Relievi mbi të cilën është vendosur, pozicioni gjeografik dhe kushtet klimaterike, janë të favorshme për të zhvilluar bujqësi moderne me prodhime biologjike të pastra, për të konkurruar tregjet brenda e jashtë vendit. Gjithashtu shquhet për pasuri nëntokësore e mbitokësore me pyje, lumenj, liqene, florë e faunë, zona me përparësi turizmin malor, qendër kurative e pushuese. Fondi pyjor i Matit shtrihet në një sipërfaqe prej 44.520 ha, ose 53% e teritorit. Masivet e ahut, dushkut dhe pishës janë shumicë. Sipas statistikave, bimësi pyjore ka 3015 ha, djerrë 574 ha, inproduktive 4867 ha, ndërsa bujqësore 20825 ha, kullota 6115 ha dhe pyll 46116 ha. Aju ze një sipërfaqe prej 10840 ha, ose 24.3% të fondit pyjor, lloji halor (pisha e zezë) 6420 ha, e barabartë me 14.5% të sipërfaqes. Dushqet zenë 18500 ha, ose 42%. Tërë volumi, i llogaritur në këmbë, kalon shifrat mbi 5 milion m³.

Dikur ekonomia pyjore ka dhënë ritmikisht lëndë drusore anekënd atdheut, pa përfituar për vete. Jo më kot pyjet vlerësohen si mushkëritë e gjelbra të mjedisit jetik, me funksione prodhuese e mbrojtëse, ekonomike, sociale e mjedisore. Është fakt që Mati, për florën, faunën, bimët mjekësore etj, renditet ndër rrethet e pasura. Masivet pyjore në Ulzës, Qafë-Shtamë, Balgjaj, Zall-Gjoçaj, Guri i Bardhë janë të denja për parqe kombëtare, turizëm malor etj.

Si në të gjitha fushat e ekonomisë dhe në pyje periodua e gjatë e tranzicionit ka bërë punën e saj. Ka patur dëmtim të rëndë të pyjeve, i cili vazhdon edhe sot. Por, në mbështetje të strategjisë dhe zhvillimit të sektorit të pyjeve, me ndihmesën e DPPK-së Tiranë dhe strukturave të tjera të pushtetit, krahasuar me vitin e kaluar, Inspektoriati Shtetror i Mjedisit dhe Pyjeve Mat, me masat që ka marrë, ka bërë të mundur reduktimin e prerjeve të paligjshme në masën 60%. Nga sasia e lëndës së prerë kondrabandë është sekuestruar rreth 30% e saj dhe, për dëme të shkaktuara në fondin pyjor, janë bërë rreth 20 denoncime penale.

Ndryshimet ekonomiko-sociale kanë krijuar

një plan negativ në ekosistemin pyjor, duke gjymtuar biodiversitetin në mënyrë të theksuar. Prerjet e paligjshme e të pakontrolluara, që kanë ndodhur gjatë tranzicionit të stërzgatur, kanë shkaktuar degradim të këtyre pasurive pyjore. Zjarret gjithashtu janë një tjetër rrezik për biodiversitetin. Shpyllëzimet masive për hapjen e tokave të reja, ndotja e ujit dhe ajrit, sidomos ajo me origjinë industriale, shfrytëzimi intensiv i tokës gjatë viteve të fundit, kanë bërë të mundur pakësimin e sipërfaqeve pyjore, duke shkaktuar dëme kritike në pakësimin e disa llojeve pyjore të florës dhe faunës, infektimin e ujërave nëntokësore dhe pakësimin e gjallesave të lumenjve e liqeneve.

Drejtues ndër vite të Shërbimi Pyjor Mat janë shprehur publikisht për ruajtjen dhe restaurimin e ekuilibrit natyror në pejzazh, mbrojtjen e diversitetit të të gjitha formave të jetës, të vlerave dhe bukurive natyrore, brenda dhe jashtë zonave të mbrojtura. Sipas ing. Mehmet Rami, ish-drejtor i Shërbimit Pyjor, për fatin e mirë të matjanëve, pavarësisht qëndrimeve negative të qeverive të kaluara, në raport me rrethet e tjera, Mati ka një mjedis dhe pyje më të mira se shumë rrethe të tjera të vendit. Arsytet që kjo pasuri e paçmuar nuk është ruajtur, janë varfëria ekonomike e zonës dhe politikat qeverisëse të papërgjegjshme për ta ruajtur këtë pasuri kombëtare. Më tej shton se, padrejtësisht pyjet e Mati i kanë shfrytëzuar subjekte private të papërgjegjshme të rretheve fqinj. Konkretisht nga Dibra është shfrytëzuar Balgjaj e Mbasdeja, Guri i Bardhë nga Tirana, ndërsa Qafë-Shtama e Trodhna nga Kruja.

Vite më parë, siç thotë ing. Skënder Lata, ish-drejtor i Shërbimit Pyjor, pyjet e rrethit të Matit patën hyrë në fazën e zhvillimit dhe të mbrojtjes së tyre, ripërtëritjes, trajtimeve komerciale dhe ndërgjegjësimin të komunitetit pjesmarrës në këtë mjedis. 23500 ha pyje shtetërore u kaluan në pronësi të 10 komunave të rrethit, duke garantuar bilanc ruajtjeje dhe zhvillim. Me projekt, për çdo komunë u investuan rreth 95000 \$. Nga puna për mbrojtjen dhe zhillimin e këtyre pyjeve përfituan deri në 12000 familje. Por më tepër përfitoi mjedisi i ndërgjegjësuar, i cili ka shumë nevojë dhe në të ardhmen. Megjithkëtë,

dhe atëherë ka munguar ligji i saktë për të ndarë drejtësisht dhënien në pronësi të pyjeve në zonat e ulta, sidomos dushkajave, që janë afër komunitetit, të cilit i shërbejnë, si dhe mosqartësia e komunitetit për të mbajtur qëndrim serioz ndaj kësaj prone të çmuar.

Qëllimi strategjik i zhvillimit të pylltarisë shqiptare është mbrojtja dhe shtimi i pyjeve e kullotave, ndarja e funksioneve, e pronësisë dhe e qeverisjes së pyjeve për garantimin e vijueshmërisë së prodhimeve drusore e jodrusore të pyllit, për ruajtjen e habitateve të florës dhe faunës, mbrojtjen e pellgjeve malore, mbrojtjen nga erozioni, krijimin e zonave strikt të mbrojtura, zonave ekoturistike, parqeve kombëtare si dhe biodiversitetin në përgjithësi. Edhe pse "zyrtarisht" janë marrë masa administrative dhe njerëzit janë "ndërgjegjësuar" ndaj ligjshmërisë, flora dhe fauna në rrethin e Matit ndjehen të kërcënuara. Ka patur dëmtime si asnjëherë tjetër, veçanërisht në pyjet e lartë, pyje industriale, me vlera për shoqërinë. 7% në shkallë kombëtare, nga 1.300.000 ha gjithsej, janë minus 100 ha. Si pasojë e dëmtimeve dhe zjarreve, nga 43100 ha gjithsej në Mat, 300 ha prej tyre kanë dalë jashtë funksionit, janë joproduktivë.

Ka kohë që pyjet janë ngritur në nivel ministrie, gjë që përbën një hap pozitiv për mbrojtjen, shtimin dhe menaxhimin më të mirë të pasurive pyjore në shkallë vendi, që do të thotë vlerësim më i madh për pyjet e mjedisit, florën e faunën. Këto vlera janë për të siguruar të ardhura nga mbrojtja dhe shtimi i pyjeve, mbrojtja e florës dhe faunës, e bimëve mjekësore. Është në dorën e qeverisjes vendore që pyjet të jenë bukuri natyre për banorët pranë dhe burim të ardhurash me interes jetik. Por, a ka bashkëpunim transparent midis DSHP-së dhe qeverisjes vendore? Ndhimesë konkrete është ndryshimi i disa neneve të Ligjit për Pyjet, i cili parashikohet të hyjë në fuqi në korrik të vitit 2016. Sipas z. Idriz Klosi, përgjegjës i Sektorit të Pyjeve në Mat, gjithë fondit pyjor do të administrohet e menaxhohet nga bashkitë e reja. Bashkitë, shton ai, do të kenë për detyrë mbrojtjen e pyjeve nga kundravajtjet, zjarret, rrëshqitjet, gërmimet, sëmundjet etj.

Krahas bujqësisë e blegtorisë, matjani e ka lidhur jetesën dhe me mbrojtjen, shtimin dhe shfrytëzimin e pyjeve për lëndë drusore, dru zjarri e bazë ushqimore për blegtorinë. Por tranzicioni i gjatë, papunësia, tokat e pakta, shfrytëzimi nga njerëz joprofesionalë, pa njohuritë e duhura, pa mekanizmin e duhur, kanë shkaktuar humbje të konsiderueshme në vëllimin e lëndës drusore në këmbë. Shqetësuese vazhdojnë të mbeten prerjet ilegale, sidomos nga banorë afër masiveve, me justifikimin se janë të fisit a të fshatit, siç është dëshmuar në Zall-Gjoçaj, Xibër, Selicë, Bushkash etj. Shërbimi pyjor vazhdimisht ka bërë thirrje për ndërgjegjësim në interes të ruajtjes e shtimit të pyjeve, për të parandaluar prerjet e paligjshme, kullotjen pa kriter, si dhe gjuetinë e jashtëligjshme.

Jeta e njeriut ka qenë dhe do të jetë e lidhur organikisht me ekonominë pyjore. Por si ka qenë dhe si do të jetë raporti i marrëdhënieve

Për vitin 2015 në territorin e Matit janë shfaqur 6 raste zjarresh, të cilat kanë qënë sipërfaqësore. Për fat të mirë nuk ka patur dëm ekonomik. Në Mat nuk ka infrastrukturë për shuarjen e zjarreve, sepse mungojnë mjetet dhe forcat. Nga viti 2010 e në vazhdim nuk janë mbjellë fidane në pyje. Panorama e sotme në pyje pranohet se është shkatërrimtare. Organizimi i fushatës së pyjeve përbën një mbështetje serioze për faktin se qëllimi kryesor i saj është senibilizimi dhe përfshirja e opinionit publik në këtë fushë, si një faktor tepër i rëndësishëm për mbrojtjen, shtimin dhe përmirësimin e pyjeve.

të ekonomisë pyjore me komunitetin? Nga shkurti i vitit 2014 tashmë ruajtjen e pyjeve e ka në funksion Inspektoriati Shtetror i Mjedisit dhe Pyjeve me qendër në Dibër. Janë gjithsej 10 specialistë për të mbrojtur e ruajtur 14 mijë ha, kur përqindja më e lartë e punonjësve të ISHMP-së janë jashtë specialitetit.

Për vitin 2015 në territorin e Matit janë shfaqur 6 raste zjarresh, të cilat kanë qënë sipërfaqësore. Për fat të mirë nuk ka patur dëm ekonomik. Në Mat nuk ka infrastrukturë për shuarjen e zjarreve, sepse mungojnë mjetet dhe forcat. Nga viti 2010 e në vazhdim nuk janë mbjellë fidane në pyje.

Panorama e sotme në pyje pranohet se është shkatërrimtare. Kush të ngrihet më herët pret pa asnjë leje në xhep. Mbrojtësit e pyjeve janë kthyer në bashkëpunëtorë me masakruesit. Por për të ulur prerjet e paligjshme në pyje, për t'i mbrojtur nga zjarret si dhe për të siguruar një mbrojtje të qëndrueshme të pasurisë pyjore dhe kullosore, mbrojtjen e florës dhe faunës, shërbimi pyjor ka bërë dhe vazhdon t'i bëjë kërkesë opinionit qytetar të Matit për t'u distancuar nga prerjet dhe gjuetia e paligjshme si dhe për të marrë masat e nevojshme mbrojtëse për florën dhe faunën e kërcënuar. Organizimi i fushatës së pyjeve përbën një mbështetje serioze për vetë faktin se qëllimi kryesor i saj është senibilizimi dhe përfshirja e opinionit publik në këtë fushë, si një faktor tepër i rëndësishëm për mbrojtjen, shtimin dhe përmirësimin e pyjeve, mbrojtjen nga erozioni, mbrojtjen e florës, faunës dhe mjedisit në përgjithësi.

Asnjë lloj progresi në fushën e ruajtjes dhe menaxhimit të natyrës, pejzazhit dhe biodiversitetit në vend nuk mund të arrihet pa pjesëmarrjen aktive dhe përfshirjen e komunitetit. Prandaj është koha të ndahen përgjegjësitë, të bashkohen përpjekjet dhe forcat për të mbrojtur trashëgiminë tonë natyrore dhe biologjike për brezat e sotëm dhe ata që do të vijnë. Të vlerësojmë realisht këtë pasuri të çmuar të natyrës, që t'ua lëmë trashëgim pasardhësve. Masivet me pyje, këto perla që natyra na i ka falë, mos t'i shkatërrojmë, por t'i rehabilitojmë, mbrojmë e shtojmë. Prioritet i drejtuesve të Shërbimit Pyjor mbetet sigurimi i një mbrojtjeje të qëndrueshme, menaxhimi bashkëkohor i mjedisit natyror, biodiversitetit dhe gjithë potencialit biologjik me të gjitha vlerat e mëdha që disponojmë. Le të mendojmë ndryshe, por për progresin. Të japim ide e mendime, të propozojmë rrugëzgjidhje e të punojnë së bashku për t'i realizuar ato. Të zgjidhen në drejtim njerëz të aftë, të ndërgjegjshëm, ekspertë në fushat e tyre, të përkushtuar për të punuar me komunitetin e për komunitetin. Prandaj të ndajmë përgjegjësitë, të bashkojmë përpjekjet për ta bërë Matin perlën e Shqipërisë, ashtu siç duhet, që nesër të jetë me ekonomi të zhvilluar, jo me rend e qetësi të trazuar, të sondojë qetësia dhe dashuria e dikurshme, me prodhim bujqësor e blegtoral për të plotësuar nevojat dhe të eksportojë, me natyrë e pyje të pa dhunuara. Këto duken të vështira, por duan punë, ndërgjegje, falje, bashkim idesh e mendimesh, dashuri e respekt për vendlindjen.



Një makinë me dru e ndaluar nga policia.

Siguria e minatorëve, qeveria ndalon aktivitetet në 62 zona të rrezikshme

Ministri i Energjisë dhe Industrisë Damian Gjiknuri shpjegoi gjatë një konference shtypi Vendimin e Këshillit të Ministrave për përcaktimin e zonave të rrezikshme minerare si dhe programin e ri 3 vjeçar të aktivitetit minerar në vend.

“Vendimi rishikon dhe përcakton 62 zonat e rrezikshme minerare, kryesisht në Bulqizë dhe Batër, në të cilat do të jetë e ndaluar dhënia e lejeve dhe ushtrimi i aktivitetit minerar. Konkretisht, në rajonin krommbajtës të Bulqizës, do të ndalohet ushtrimi i aktivitetit minerar në një pjesë të Zonës D e cila konsiderohet me rrezikshmëri për jetën”, tha Gjiknuri.

“Përcaktimi i zonave të rrezikshme do rrisë sigurinë për jetën e minatorëve. Do të revokohen tërësisht lejet kur zonat tyre të shfrytëzimit janë vendosur në pjesën më të madhe mbi zonën e rrezikshme. Gjithashtu, do revokohen pjesërisht lejet kur zonat e tyre të shfrytëzimit janë vendosur një pjesë mbi zonën e rrezikshme”.

Sipas Ministrit, në total, janë rreth 18 leje shfrytëzimi të cilat do të revokohen duke patur si objekt kryesor rritjen e sigurisë në punë dhe ndalimin e aktivitetit në pjesën e rrezikshme.

“Në koordinim me Policinë e Shtetit dhe Inspektoratin e Punës do të bëhet monitorimi i këtyre zonave të rrezikshme që të ndalohet çdo aktivitet ilegal që cënon jetën e qytetarëve”.

Më pas Ministri iu rikthye edhe njëherë gjendjes së sektorit minerar kur koalicioni i majtë erdhi në pushtet.

“Dua të kthehem pak tek gjendja në të cilën e trashëguam sektorin minerar. Në vitin 2005 rezultoni rreth 430 leje minerare aktive. Para dy vitesh, kur ne erdhëm në drejtim të vendit, gjetëm rreth 800 leje minerare të lëshuara, jashtë çdo lloj kontrolli shtetëror.

Qeverisja e Partisë Demokratike u tregua e papërgjegjshme në trajtimin e kësaj industrie, duke dyfishuar dhe parcelizuar në mënyrë kriminale zonat minerare.

Pavarësisht se në industrinë minerare në të gjithë botën ndodhin aksidente, ky shfrytëzim barbar në 8 vitet e qeverisjes së djathtë përkeqësoi situatën duke marrë jetën e dhjetëra minatorëve. Cënoi themelet e sigurisë në punë, mbolli konflikte të cilat e kthyen kryesisht Bulqizën në “Far uest”-in shqiptar, çka rëndoi edhe më keq bilancin e viktimave brenda e jashtë minierave.

Hapi i parë që ndërmorëm ishte rikthimi i kontrolleve periodike në miniera. Filluam procesin e kontrollit individual për secilin subjekt, jo vetëm në aspektin e plotësimit të kriterëve të sigurisë në punë por edhe sa i takon zbatimit të detyrimeve ndaj Buxhetit të Shtetit.

Revokuar mbi 200 leje minerare të cilat nuk respektonin kriteret e sigurisë dhe nuk shlyenin detyrimet që kishin ndaj shtetit ndërsa janë në procedurë heqjeje edhe 32 të tjera. Janë pezulluar pjesërisht në aktivitetin e tyre qindra subjekte të tjera deri në plotësimin e kushteve të sigurisë.

Përmes ndërhyrjeve ligjore i dhëm zgjidhje problematit të konfliktit mbi rrugët e kalimit, ashtu sikurse eliminoam fenomenin e mbivendosjeve duke revokuar 20 leje minerare. Ndalua shfrytëzimin e sterileve. Të gjithë i mbani mend dy vite më parë pamjet e grave dhe fëmijëve rreth grumbujve të mineraleve.

Vumë nën kontroll ndryshimet e herë pas hershme të kufijve në zonat minerare duke u vënë fre zgjerimeve të pakontrolluara. Kemi sanksionuar me ligj rehabilitimin progresiv mjedisor duke detyruar subjektet të ngrijnë fondin për rikthimin e mjedisit në gjendjen e para shfrytëzimit minerar.

Janë mbyllur 119 galeri të braktisura dhe për vitin 2015 janë planifikuar të mbyllën 64 galeri të tjera.

Ndryshe nga qeverisja e mëparshme që i la në mëshirën e fatit, kjo qeveri mbajti premtimet. Ulja me 5 vjet e moshës së daljes në pension apo dyfishimi i pensioneve për 3840 minatorë, sot është një realitet.

MINIERA E SELISHTËS

Humbi jetën dy minatorë, punonin në të zezë

Një aksident ka ndodhur në fund të gushit në Minierën e Selishtës, e për pasojë kanë mbetur të plagosur rëndë e më pas kanë humbur jetën gjatë rrugës dy minatorë, kushërinj me njëritjetrin. Media bëri të ditur se aksidenti ndodhi gjatë një avari në minierë, çka sjolli shembjen e një masivi dheu. Fillimisht është raportuar i plagosur rëndë drejtuesi teknik Miftar Losha, 54 vjeç, ndërsa ka mbetur i bllokuar brenda minierës Albert Losha, 35 vjeç.

Në vendin e ngjarjes ka shkuar policia dhe mjekët e Spitalit të Peshkopisë, pasi ambulanca e ka pasur të pamundur të shkojë për shkak të terrenit të vështirë. Pas disa orëve, është nxjerrë nga miniera edhe Albert Losha dhe të ty të plagosurit janë dërguar me helikopter drejt Qendrës Spitalore të Traumës në kryeqytet. Por sipas policisë së Dibrës, ata nuk kanë mundur t’u mbijetojnë plagëve të marra dhe kanë ndërruar jetë gjatë rrugës. Policia po heton për zbardhjen e rrethanave të kësaj ngjarjeje tragjike që u mori jetën dy minatorëve.

Balkanëeb, nga burime të saj, theksonte firma kishte licensë për këtë galeri, por nuk ushtronte aktivitet prej kohësh. Ndërkohë që ishte raportuar për veprimtari ilegale në këtë galeri. Sipas gazetës, Ministria e Energjisë ka nisur në terren një grup verifikimi, e cila pritet që së shpejti të bëjë publike raportin.

Fatkeqësisht, edhe gjatë këtyre dy viteve ka patur viktima në aktivitetin minerar. Jemi të vetëdijshëm se ka ende shumë punë për të vënë rregull në këtë sektor të nxjerrë plotësisht jashtë binarëve.

Ju e dini se konjunktura aspak e favorshme e çmimeve të mineraleve në tregun botëror ka bërë që të ulët kërkesa edhe për mineralet shqiptare. Gjithsesi, paralelisht me forcimin e masave të sigurisë në punë, po punojmë intensivisht për zhvillimin e sektorit në tërësi dhe industrisë përpunuese në veçanti.

Është bërë e mundur fillimi i punës dhe janë investuar mbi 6 milion USD për hapjen e pusit të thellësisë në Bulqizë që do i zgjasë jetëgjatësinë minierës.

Vazhdon puna për hapjen e traverbankut të Qaf buallit dhe traverbankut të Klosit, që shërben për shkarkimin e të gjitha ujërave të vendburime të Bulqizës. Janë investuar mbi 3 milion USD të tjera në impiantin e seleksionimit të kromit në Klos, Uzinën e Ferrokromit Burrel dhe Uzinën e Ferrokromit Elbasan. Është rritur me 35% sasia e ferrokromit të prodhuar, krahasuar me vitin e parë të qeverisjes.


Pritet që të ketë investime në sektorin e bakrit në minierat e Perlatit dhe Spaçit. Gjithashtu priten investime në minierën e bakrit në Rehovë dhe në atë të hekurikelit në Myc, Mamez, Kukës. Këtë vjeshtë do të vihet në punë fabrika e pasurimit të kromit në Kalimash, ku janë investuar rreth 7 milion dollarë.

Nisur nga situata e trashëguar, rivendosja e ligjshmërisë në sektorin minerar është një proces i vështirë por qeveria është plotësisht e vendosur për ti shkuar deri në fund.

Përmes masave të marra dhe atyre që do të ndërmerren në vazhdim, shpreh bindjen se po ecim në rrugën e duhur për rritjen e sigurisë, shtimin e investimeve, rritjen e eksporteve dhe zhvillimin e industrisë përpunuese.

Rikthimi i sektorit minerar në binarët e ligjit do të thotë siguri më e madhe për minatorët dhe përfitime më të mëdha për Buxhetin e Shtetit”, përfundoi deklaratën e tij Ministri i Energjisë dhe Industrisë, Damian Gjiknuri.

ZONAT E RREZIKSHME, BULQIZË SE BASHKU ME LEJET QE PREKEN



MINISTRI SHKËLQIM CANI NË BULQIZË:

Sektori minerar në fokus, lufta informalitetit

BULQIZË- Qeveria shqiptare më 1 shtator do të nisë një aksion të gjerë në luftën ndaj informalitetit, ku në fokus do të jetë dhe sektori minerar, që konsiderohet mjaft problematik. Deklarata u bë dje nga ministri Shkëlqim Cani gjatë një takimi të zhvilluar në veri të vendit me sipërmarrës të sektorit minerar. Gjatë takimit në Bulqizë ishin të pranishëm dhe shprehën qëndrimin e tyre edhe zv/ ministri i Energjisë dhe Industrisë, Ilir Bejtja, si dhe drejtorët e përgjithshëm të DPT dhe DPD.



“Qeveria shqiptare është angazhuar prej kohësh në hartimin e një strategjie ndaj luftës së informalitetit dhe në 1 shtator do të fillojë zbatimin në terren të kësaj reforme, në mënyrë që të shkëputemi njëherë e mirë ndaj niveleve të papranueshme të evazionit fiskal”, tha Cani në çelje të bashkëbisedimit me sipërmarrësit e minerareve.

Duke folur për strategjinë dhe problematikën e evazionit fiskal, ministri i Financave sqaroi se problematike mbetet nëndeklarimi i të ardhurave, mungesa e licencimeve, si dhe mosdhënia gjithnjë e kuponëve tatimorë etj.

Lidhur me sektorin minerar, ministri Cani nënvizoi se është një pjesë e rëndësishme e ekonomisë Shqiptare.

“Sektori i minierave përbën një sektor që ka qenë në fokus të politikave tona fiskale për t’u zhvilluar dhe për t’u lehtësuar nga barra fiskale (kemi ulur taksimin për përpunimin në vend, kemi ulur moshën e pensioneve për minatorët etj. Mirëpo – shtoi ai – është e papranueshme që në një sektor të stimuluar me politika fiskale, të privilegjuar, pasi iu është dhënë e drejta për të siguruar ardhura nga pasuria kombëtare, të kemi nivele të larta informalitetit”, tha Cani. Në këtë drejtim, ministri Financave sqaroi se problem mbetet deklarimi i cilësisë së ulët të mineraleve të eksportuara, me qëllim që të paguhen më pak rente në doganë.

“Prandaj – tha Cani – Drejtoria e Përgjithshme e Doganave do të bëjë verifikimet për çdo rast me të gjitha vendet ku janë eksportuar mineralet tona. Do të bashkëpunojmë me Ministrinë e Energjetikës për të marrë informacion mbi cilësinë e mineralit të secilit subjekt, mbi bazën e të dhënave të lejeve të shfrytëzimit sipas zonave”, theksoi Cani. (balkanweb.com)



Kopshti i Breshias, 45 vite në shërbim të fëmijëve

Nga **OSMAN XHILI**

Po bëhen gati 45 vjet. 45 vjet që atëherë, kur kopshti i Breshias në Dibër të Madhe, po hidhte hapat e parë. Që të dy palët po hidhnin hapat e parë, institucioni që po formatohej dhe vogëlushët që zhurmonin klasat e sallonet e godinës. Tërmeti i vitit 1967 kishte shkatërruar çdo gjë, e çdo gjë duhej ringritur nga fillimi. Një grup studentësh e profesorësh nga Breshia e Italisë, vizitojnë qytetin e demtuar. Keqardhja më e madhe e mysafirëve, binte mbi vogëlushët që kishin mbetur pa strehë, pa çerdhen e tyre të ngrohtë e të dashur. Ata jo vetëm që përveshën krahët duke punuar me përkushtim, por dhanë një ndihmesë të madhe në materiale e fonde monetare. Falë kësaj ndihme të pakusyer, misionarët e huaj gdhendën në portalin e ndërtesës, emrin e qytetit të tyre bujar, dhe kështu u bë emërtimi zyrtar "Kopshti i Breshias".

PAK HISTORI

Me tej kopshti i Breshias do të vazhdonte rrugëtimin e tij duke prekur fundin e mijëvjeçarit dhe fillimin e tjetrit. Drejtori i parë vullnetar ishte Halit Basha, një mësues, humlutes e krijues i nderuar i shumë gjinive. Tre edukatorët e para janë Lirie Jani, Gjulsime Pjeça dhe Zora Viçishka. Emra të tjerë drejtorësh pasojnë në kohë. Hysen Kosovrasti, Cvetka Llalceviski, Fuat Poceska, Gjorgji Ilevski, Vehap Duka, Shirete Grazhdani, Sevdije Vojnika dhe drejtoresha në vazhdim, Ajrie Daçi. Pavarësisht sa kohë drejtuan secili, mënyrës se si, apo temperamentit e karakterit të tyre, një gjë e kishin të përbashkët. Që të gjithë punuan plot përkushtim duke dhënë më të mirën që kishin në dijen e personalitetin e tyre. Dhe ashtu punëtorë e krijues, bashkë me stafet respektive, ata u gdhendën në memoriet e përfytyrimet e atyre vogëlushëve, për ti imituar se ç'ka do të ishin e mund të bëheshin në jetë.

DISA TREGUES

Nuk mund të krijosh përshtypjen dhe idenë për kopshtin e Breshias, pa qenë më parë vizitor i tij. Ky institucion ka 27 punonjës së bashku me drejtoreshën, që kryejnë më së miri detyrat që kanë marrë përsipër. Është me të vërtetë një barrë shumë e rëndë, detyrë shtetërore, përgjegjësi para Zotit dhe amanet i prindërve të këtyre vogëlushëve. Numri i fëmijëve është 230 dhe kurba ka qenë gjithnjë në rritje, pasi vetëm para shtatë vitesh ky numër ka qenë 80 më pak. Njëmbëdhjetë grupe, që nga bebet disa mujore e deri në moshën gjashtë vjeçare, i japin gjallëri e kuptim jetës këtu. Njëri nga grupet është bilingual, shqiptarë – maqedon, e kështu shkëmbehen përvojat reciproke e vlerat më të mira të këtyre dy komuniteteve. Risi tjetër është hapja e dyerve për fëmijët e moshës 7 deri 10 vjeç, duke mësuar e shpenzuar këtu një pjesë të kohës në mënyrë shumë efektive.

Sigurisht, ky numër i madh nxënësish, do të donin hapësira jo të vogla për të mësuar, lëvi-

zur e luajtur me njëri tjetrin. Fatmirësisht, ato nuk mungojnë. Në dispozicion të vogëlushëve janë mbi 1000 metër katror salla, sallone, klasa, rrobaqepësia, mensa, kuzhina, infermiera e çdo gjë tjetër, që mund të jetë e nevojshme për ta. Kësaj sipërfaqeje i shtohen dhe tetë dynym me kënde lojërash të ndryshme, duke e bërë tepër interesante e të larmishme jetën e tyre, ndaj unë shtroj pyetjen, e po vetë mendohem si mund ta quaj institucionin, kopsht apo universitet?

VEPRIMTARITË

Janë kaq të shumtë e të larmishëm, sa nuk di nga të fillosh përshkrimin e tyre. Çdo muaj e sezon ka festat e veta. Njëherë në javë, ata kanë ditë të hapura për prindër, ku këto të fundit vijnë e bëhen njësh me vogëlushët e tyre. Çdo vit nga 6 deri më 13 tetor, është java e fëmijëve, java e të drejtave të tyre. Sërish, bashkë me prindër, zhvillojnë lojëra pa kufi në qytete të ndryshme si Strugë, Tetovë e Dibër. Fëmijët garojnë në shpejtësi, shkathtësi, forcë, kërcim litari, basketboll, drejtpeshim në tre e plot gara të tjera. Këtë vit këto gara u zhvilluan me shumë sukses në Tetovë, ku fëmijët dibranë zunë shumë vende nderi.

Viti i ri përmbyll aktivitetin vjetor dhe realizohet një program i madh artistik. Të gjithë grupmoshat e fëmijëve marrin dhuratat të ndryshme duke uruar për vitin që vjen më shumë mbarësi, paqe e begati për të gjithë fëmijët e globit. Dita e Verës pritet me shumë interes nga fëmijët. E kush nuk do ti gëzohej stinës së re me plot lule e gjelbërim? Fëmijët e kopshtit Breshia kanë një program të përcaktuar artistik. Më pas dalin në natyrë për të mbledhur kukurekët e lule të tjera, bëjnë buqeta e kolazhe me to. Nënën e tyre të dashura u kanë mbushur çantat plot me gështenja, vezë, simite e keke

shumë të shijshëm.

Një prilli dhuron një tjetër festë për fëmijët, festa e karnavaleve. Bëhet një paradë në qytet e më pas bëhet vlerësimi i maskave më të mira. Buzëqeshje e dhurata nga të gjithë e për të gjithë.

Po ndërsa viti i ri mbyll vitin kalendarik, 1 qershor mbyll vitin akademik, për të filluar e vazhduar me pushimet verore. Është një vit pune, lodhje e sakrificë për stafin e fëmijët. Por dhe sukseset nuk kanë qenë të pakta. Kam pasur fatin të jem disa herë i ftuar në aktivitete të tilla, bashkë me kolegë të shkollës, në kuadrin e një binjakëzimi ndërkuftar. Kemi parë programe artistike, a thua se është një trupë profesioniste e vërtetë në skenë. Veshje kaq të larmishme sa nuk se si të mos adresosh fjalë zemre për Lulzime Koçin, mjeshtren dhe ideatoren e këtij dekori plot kolorit. Kanë ardhur këtu miq nga kopshte e shkolla të ndryshme, punonjës e drejtues institucionesh. Ka të ardhur nga Kosova, Shqipëria, Bosnja, Serbia, Banja Luka, e ja tek i sheh të ulur të gjithë së bashku në një drekë pune. Nuk di pse shoh gjithë këtë skenë e përlozem. Atë që politika nuk arrin ta bëjë kurrë, e bën kopshti i Breshias dhe drejtoresha e talentuar Ajrie Daçi. Nuk di ç'farë formule apo recete ka përdorur. Besoj që ka marrë buzëqeshje fëmijësh, aroma lulësh, u ka hedhur doza humanizmi e solidariteti, duke transformuar urretjen etnike në dashuri pa kufi me të gjithë e për të gjithë.

PROJEKTE TË REJA

Projekte të shumta e të qarta janë ravijëzuar e po konsolidohen çdo ditë. Vitin e kaluar për pesë ditë me radhë u zhvillua në qytetin e Zagrebit projekti me temë i respektojmë dallimet. Ideja dhe realizimi i këtij eventi i takonin Ambasadës së parë të fëmijëve në



botë, "Megjashi", me përfaqësi në Shkup. Mesazhi i projektit ishte që fëmijët të ndjehen të barabartë me njëri-tjetrin, duke rrafshuar barrierat e racës, ngjyrës, kombësisë apo dallime të tjera. Dhe fëmijët me të meta fizike apo mendore të pranohen e të mos përbuzen nga bashkëmohatarët e tyre. Mëshirë e tolerancë, kështu na mëson Krijuesi i botës dhe ky është morali më i mirë që duhet ndjekur. Për këtë do të bëhet dhe një libër në të ardhmen me titull "I respektojmë dallimet".

Një tjetër projekt i rëndësishëm, është ai ekologjik. Sot, kur shpesh njeriu, fatkeqësisht, është në luftë me mjedisin ku jeton, këta fëmijë mundohen të japin vizione pozitive. Mbledhin e riciklojnë mbeturinat, kursejnë ujën dhe energjinë, mbjellin pemë, e kur të rriten akoma, do ti çojnë këto projekte më përpara në rrugën e realizimit.

Shumë interesant e me vlera ka qenë projekti i titulluar; "Fëmija për fëmijën". Lodra, rroba, libra dhe ushqim, sillen nga fëmijët që i posedojnë këto materiale për shokët e tyre në nevojë, duke zbutur sadopak problemin. Kështu zbatohet një porosi hyjnore, kujdesi e mëshira për të tjerët.

Së fundmi, por jo më pak i rëndësishëm ka qenë te mësuarit e zanateve dhe mjeshtërive të ndryshme. Fëmijët tregojnë ku i punojnë prindërit, dhe përshkruhet me detaje profesioni i tyre. Nganjëherë thirren prindër për të bërë ndonjë bisedë të këtij lloji. Veç kësaj bëhen vizita në reparte pune, argjendari, qëndistari, ne banjat e Dibërës, te fabrika e mermerit, apo diku tjetër. Nuk është aspak herët që tek fëmija të kultivohet dashuria për punën si burim të mirash materiale, për të ushqyer veten dhe familjen në të ardhmen.

SHUMË MEDALJE

Zyra e drejtoreshës Ajrie Daçi, është e mbushur me certifikata e dekorata. "Unë, jam vetëm një arkëtare e tyre, - thotë drejtoresha, - pasi stafi dhe fëmijët janë më shumë meritortë për këtë. Ata vijnë nga personalitete, shoqata e shtete të ndryshme, të cilët vërtet vërtet janë bindur për vlerat dhe kreativitetin e kopshtit të Breshias. Ato vijnë nga Bullgaria, Shkupi, Zagrebi si mirënjohje për punën e tyre të palodhur. Ka dhe të tilla nga shoqatat e luftëtarëve apo invalidëve, në respekt të ndihmës me programe dhe ushqim. Motivimet kanë qenë të ndryshme. Ne Zagreb u vlerësuan si kopshti i parë pilot, kurse në ekspozitën e Shkupit u dalluan për punë kreative në punime të zhanreve të ndryshme".

Vështrimi i drejtoreshës Ajries shënon lartësi të reja. Vetëm pak ndalet për të kundruar arrijtet. Sa për tu bërë një analizë të shkurtër, për të rregulluar ndonjë gabim të bërë dhe hartuar projekte të reja. Në planet e ardhshme bien në sy idetë për një sallë sporti dhe dy ushtrimore, që do ta përmirësojnë ndjeshëm veprimtarinë e fëmijëve. Është krijari një rreth, i quajtur rrethi i miqësisë, që nënkupton, qëndrime njëjavore në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Do të ketë miqësi të reja, shkëmbim eksperiencash dhe përvojash reciproke.

Vitin e ardhshëm kopshti i Breshias do të festojë 45 vjetorin e krijimit të tij. Do të ketë një takim brezash, ëndrra të realizuara apo të tilla që për arsye të ndryshme koha i ka mbuluar me pluhurin e harresës e që ndoshta sërish mund të shpalosen në qiellin e mundësisë e të realizimit. Është menduar që e gjithë kjo punë, këto arritje e realizime gati në një gjysmë shekulli, ndoshta është e udhës të hidhen në një historik që do tu mbesë brezave si një dëshmitar i ndershëm dhe besnik. Deri atëherë mund të tentohet një lidhje me qytetin e Breshias, pse jo të takohet një apo më shumë nga ata misionarë me zemër të madhe që ndihmuan kopshtin në ato ditë dhe kohë të vështira.

Drejtoresha Ajrie Daçi në rininë e saj pati ëndërruar të bëhej mjekë, të ishte në shërbim të njerëzve. Por koha bëri të vetën dhe e kaloi në një tjetër shërbim, në atë për fëmijët. Punoi në fshatrat Balancë e Mugoçë si kujdestare për bebet, për ti kaluar të gjitha statet e tyre, për tu bërë tashmë një eksperte e vërtetë e punës me to. Ka shtatë vjet që drejton me plot vizion, pasion e kompetencë kopshtin e Breshias e ne nuk na mbetet tjetër, veçse ti urojmë dhe shumë vite të tjerë në drejtim.

Drama me motive ballkanike "Mërmëritja e Antigonës" është huazuar nga "Antigona" e Sofokliut dhe është rishkruar në një version bashkëkohor nga shkrimtari freng Jean Anouilh.

Gjimnazistë nga Dibra dhe Franca luajnë në skenë Antigonën e Sofokliut

Nga BENA KËRLUKU*

Arti, përpos faktit që të shkakton kënaqësi estetike, forcon urat e komunikimit, e bën më të lehtë integrimin dhe i jep kuptim shkëmbimit të eksperiencave mes njerëzve që i bashkon vetëm dashuria për të bukurën.

Këtë mësim, unë dhe shokët e mi gjimnazistë dibranë e morëm gjatë qëndrimit tonë dy javor në Ifs, komunë në rrethinën e Caen-it, në rajonin e Normandisë në Francë, kohë gjatë së cilës u bëmë pjesë e projektit teatror "Mërmëritja e Antigonës", dramë e shkrimtarit francez Jean Anouilh.

Projekti ynë, i cili është në realizim e sipër e që po jetësohet edhe falë bashkëpunimit mes dy komunave të binjakëzuara në vitin 2009, komunës sonë Dibrës dhe asaj së Ifs, bazohet mbi idenë e qëlluar, e cila synon si nxitjen ashtu edhe krijimin e hapësirave dhe mundësive për të rinjtë, në mënyrë që ata të shfaqin para publikut talentin dhe aftësitë e tyre prej aktorësh.

Përmes këtij projekti, po ashtu u arrit trajnimi i nxënësve në fushën e artit, çka edhe nxiti komunikimin mes tyre si në aspektin profesional ashtu edhe në atë personal, çoi në njohjen e anasjelltë të traditave dhe kulturave mes vendeve tona. Një përvojë e tillë ndikoi shumë në formimin tonë profesional prej fillestarësh.

Krejt aktiviteti ishte organizuar në formën e një feste të vogël që nisi më 4 gusht për tu përmbyllur pas dy javësh, më 18 gushtin që lamë pas. Gjatë atyre dy javëve u vendosëm në një lloj internati të ashtuquajtur "La Bago-tierre", në Ifs.

Pas aterimit të avionit në aeroportin Beauvais të Parisit (udhëtimi zgjati për 2 orë e 30 minuta) na priste befasia e radhës: takimi me Bujar Maqellarën, i cili edhe një herë dëshmoi mikpritjen dibrane, duke na gostitur në lokalin e xhaxhait të tij, Munirit. Takimi edhe mes Parisit me bashkëvendësit tanë dibranë, të cilët janë të gatshëm të ndihmojnë gjithëherë, ishte një ndjenjë e posaçme dhe emocion i papërshkruar me fjalë: krenari e ligjshme për atë nga vjen dhe traditën e bukur të mikpritjes karakteristike dibrane.

Të shkosh në Paris dhe të mos shohësh monumentet më të njohura historike, si kullën e Eiffel-it dhe Harkun e Triumfit - Champs Elysees, është njësoj sikur të mos kesh qenë fare, prandaj dhe pikëtakimi ynë i parë me kulturën dhe traditën franceze ishte pikërisht vizita në këto monumente famëmedha. Gjatë kësaj guide turistiko-historiko-kulturore shijam udhëtimin me metronë e njohur të Parisit.

Pasditja kishte cak arritjen tonë në destinacion, për çka edhe në shoqëri të Michael, u nisëm për në Caen, ku u pritëm me shumë entuziazëm nga iniciatorët e projektit dhe moshatarët tanë.

Filloi kështu implementimi i projektit: një larushi aktivitetesh të kombinuara në mënyrë interesante. Jo vetëm pjesa e punëtorisë profesionale ku filloi të ngjizej dhe të gatuhej projekti teatror ishte në funksion të qëllimit të projektit. Gjithçka, madje edhe koha e lirë ishte organizuar në mënyrë të tillë që gjithçka t'i shërbente maksimalisht idesë qendrore dhe bazë të projektit. Qoftë në bisedat e lira që shkëmbeuam me njëri-tjetrin si dhe në aktivitetin disaditor të quajtur "Time on Europe", bashkëmoshatarët tanë francezë shfaqën interesin e tyre rreth rregullimit shtetëror në Maqedoni dhe Shqipëri, rreth specifikave etnike në Maqedoni që e kishin vërejtur në faktin se grupi ynë dibranë, i ardhur nga njëjtë qytet dhe e njëjta shkollë flasinim dy gjuhë të ndryshme. Shkëmbimi i informacioneve bazë çoi në pasurimin e tyre me njohuri shumë-dimensionale, veçmas për historinë, traditën dhe kulturën e popullit tonë, ashtu sikurse të njëjtat



informacione volëm edhe ne për historinë dhe kulturën e tyre.

Gjatë mbrëmjes zhvillim aktivitetet zbavitëse, ku bashkëmoshatarët tanë francezë i njohëm me shumë lojra tradicionale dibrane, këngë të ndryshme nga vendi ynë dhe disa fjalë në gjuhën shqipe dhe maqedonase.

Projekti bazohet te realizimi i shfaqjes teatrorë, për çka edhe në një mënyrë apo në një tjetër, ne në cilësinë e fillestarëve edhe do të trajnoheshim profesionalisht. Është diçka e bukur që një pjesë të ditës t'ja kushtosh artit dhe letërsisë: kjo ishte ajo çka ne bëmë gjatë atyre dy javëve të paharrueshme.

Jo më kot ishte zgjedhur një dramë me motive ballkanike (nga grekët e lashtë) "Mërmëritja e Antigonës", një temë e huazuar nga "Antigona" e Sofokliut, por e paraqitur në një version modern dhe bashkëkohor nga shkrimtari freng Jean Anouilh.

Shumica prej nesh ishim fillestarë, të papërvojë në artin dramatik, prandaj gjatë atyre ditëve fituam përvojë edhe në këtë aspekt të artit, çka mbi të gjitha ndikoi në rritjen e vetëbesimit tonë si të rinj. Gjatë interpretimit

të roleve dhe përmes tyre ne përjetuam forcën e karaktereve të reja, personaliteteve të personazheve që luanim e që ishin të ndryshme nga çka ne bëmë dhe ishim në jetën e përditshme. Kjo ishte një magji më vete. Magjia e artit!

Dibranët i fituan gati të gjithë rolet kryesore, aktorja e re Sara Ajrovska na shfaqet me rolin e vajzës që sakrifikoi më të shtrenjtën gjë, jetën e saj, për të varrosur të vëllain. Rolin e mbretit të atëhershëm të Tebës, e sollti në skenë Taulant Guze që me seriozitetin dhe precizitetin këmbëngulës prej aktori, arriti të sjellë në skenë karakterin e vërtetë të një mbreti mizor, që më në fund sigurisht që e vuan dënimin i vetmuar në pallatin bosh. Dadoja e cila u mundua aq shumë për të mbrojtur Antigonën e saj të vogël dhe që përfundoi duke vlarë veten me helm, erdhi në skenë nën interpretimin e bashkënxënës sonë Anila Telqit. Gjithashtu, rojet dhe kori (që simbolizon popullin) u realizuan nga nxënës dibranë dhe francez, disa prej të cilëve ishin: Bena Kërluku, Jeta Dema, Besim Tomini, Blini Korumi dhe Millan Dimitrievski. Po ashtu, disa role kryesore u interpretuan nga miqtë tanë nga Caen.



Drama është shfaqur për publikun francez dhe pritet të shfaqet edhe në Festivalin e Teatrit në Dibrë këtë vit si dhe në Strugë.

Projekti është në realizim e sipër e që po jetësohet edhe falë bashkëpunimit mes dy komunave të binjakëzuara në vitin 2009, komunës së Dibrës së Madhe dhe asaj së Ifs në Francë, bazohet mbi idenë e cila synon nxitjen dhe krijimin e hapësirave dhe mundësive për të rinjtë, në mënyrë që ata të shfaqin para publikut talentin dhe aftësitë prej aktorësh. Realizimi i projektit është bërë i mundur nga bashkëpunimi i Qendrës për Zhvillim të Qendrueshëm të Komunitetit në Dibrë në partneritet me Teatrin e qytetit Ifs, falë mbështetjes financiare të BE-se - programi Erasmus Plus.

Projekti do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2016. Parashihet që në prill të vitit 2016, "Mërmëritja e Antigonës" do të prezantohet në Festivalin Ballkanik në Caen.

Natyrisht që merita më e madhe për suksesin që arriti drama për mua personalisht, i takon regjisores profesionale franceze Fabienne, e cila arriti të na tërheqë në magjinë e artit dramatik, duke na bërë ta dashurojmë atë. Puna me këtë regjisore profesionale ishte një kënaqësi më vete, ishte nga përvojat më interesante gjatë gjithë projektit. Ishte mbi të gjitha, një fat për ne fillestarët të punonim me një artiste të tillë.

Brenda dy javësh pune intensive, me prova të shumta, drama jo vetëm u ngjiz, por u formësua ngadalë për të marrë trajtën përfundimtare, atë të shfaqjes që më 17.08.2015 u luajt në dhomën e aktrimit në internat para familjarëve të aktorëve francezë. Jo gjithçka u mbyll aty, pasi "Mërmëritja e Antigonës" do të vazhdojë jetën e saj artistike. Në tetor të këtij viti ajo do ta ketë një premierë në Dibrë para publikut artdashës dibranë. Pritet që shfaqja të jetë pjesë e "Festivalit të Dramës" në Dibrë, çka gjithsesi ende nuk është informacion zyrtar. Poashtu, përveç qytetit të Dibrës planifikohet që të luhet edhe në Strugë. Në tetor, kur shfaqja do të prezantohet para publikut dibranë, aktorët francezë me të cilët patëm kënaqësinë të bashkëpunojmë, do të jenë të mirëpritur nga familjet tona, në një periudhë prej pesë ditësh.

Projekti do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2016. Parashihet që në prill të vitit 2016, "Mërmëritja e Antigonës" do të prezantohet në Festivalin Ballkanik në Caen. Këtu merr fund edhe rrugëtimi ynë në këtë projekt që na fali shumë. Ai na mësoi se integrimi me të tjerët bëhet edhe më i lehtë përmes artit. Na mësoi se pavarësisht, përkatësisë etnike apo gjuhës që flasim, gjuha universale e artit na bën të ndjehemi më pranë njëri-tjetrit, na afron me njëri-tjetrin dhe na tregon se ato që na bashkojnë janë më shumë se ato që na ndajnë.

Kjo ishte një nga përvojat më të bukura që unë si e re kam pasur deri më tani, prandaj personalisht, falenderoj organizatorët, komisionin që na përzgjedhi, profesorët që na mbikëqyrën: Arjeta Jani dhe Xhevit Miftarovski si dhe të gjithë ata që kontribuan të realizohet ky projekt.

Jam e bindur që momentet që i përjetuam dhe do të përjetojmë deri në fund të projektit, do të mbesin disa nga kujtimet më të bukura të jetës sonë, sepse ne takuam magjinë e artit teatror. Ne folëm me gjuhën e tij, komunikuam si të barabartë përmes asaj gjuhe.

* Pjesëmarrëse në këtë program.

Ambra Meda, takim mirënjohjeje në Dibër të Madhe.

Ambra Meda, vajza që tashmë është bërë simbol jete, udhëton drejt Dibrës së Madhe për të shprehur mirënjohjen te të gjithë ato shqiptarë në Maqedoni, që pavarësisht së jashtë kufijve politikë, ishin pranë saj në momentin më të vështirë.

Nga **NERILDA MEDA**

Dibra e Madhe - qytet i fjetur? Teksa dëgjova një epitet të tillë në mendje më erdhi tetori i vitit 2013, ku dibranët gjetën formën më të bukur për të qenë pranë vajzës shqiptare që po luftonte me jetën. Këto shqiptarë të Dibrës së „fjetur“ ishin ndër të parët që zgjuan opinionin publik për të ndihmuar një vajze që nuk mund t'ia dilte e vetme në atë betejë. Ambra qëndronte e shtruar në spitalin Schwabing në Mynih, e ndërkohë që gjithë Shqipëria dhe të afërm të saj po bënin të pamundurën për të mbledhur shumën prej 180 mijë eurove, qytetarët e Dibrës së Madhe gjetën një formë ndryshe për t'ju bashkuar kauzës.

Vlera e parë që mbartin këto njerëz është bashkimi, fuqia e tyre për të bërë gjëra të mëdha kur janë të gjithë së bashku. „Një këngë për një jetë“ - kështu ishte titulluar koncerti humanitar që u mbajt në Dibër të Madhe për Ambrën. Shumë këngëtarë e artistë, të disiplinave dhe moshave të ndryshme u organizuan për të ndihmuar 17 vjeçaren që ndodhej në Gjermanisë. Ndërkohë që gazetari sportiv si edhe daja i Ambrës, Defrim Methasani, kishte njoftuar në faqen e tij në facebook për koncertin që po organizonin, shumë artistë nga Kosova, Tirana, Peshkopia dhe Dibra e Madhe ishin nisur për në këtë qytet që „shkriu“, kufijtë. Disa nga artistët ishin Dritan Jashari, Liri Rasha, Hysi Hasani, Fitore Berisha, Evzi Kaja Xiu, Ingrid Jushi, Argjend Marku, Lundrim Paçuku, Daja Do, Klea Çutra, Bena Kërlluku, Bora Tomini dhe shumë të tjerë. Këtë eveniment të një natyre të veçantë do ta udhëhiqte kryetari i komunës, Rruzhdin Lata në bashkëpunim me djalin që udhëheq vlerat Dibrane në Gjermani, Valon Marke, si edhe me dy miq të mirë që u morën me organizimin e çdo detaji të atij eventi special Dritan Lleshi dhe Bajram Kllobçishta.



Nuk mund të harrojmë as Drejtorin e pallatit të Kulturës Artin Spahi, i cili u kujdes që gjithçka të shkonte sipas programit të parashikuar duke dhuruar kënaqësi por ndërkohë duke shpëtuar një jetë. Një natë e mbushur me këngë, qindra qytetarë në pallatin e kulturës, duke kontribuar ndërkohë që shijonin muzikën e përgjedhur të artistëve shqiptarë, një natë që u përfol shumë si në median vizive ashtu edhe në atë të shkruar, sepse ishte një natë e rrallë.

Pyesni veten pse ju ktheva kaq shumë në kohë? Sepse dibranët dhe Ambra është një prej tyre, dinë të jenë mirënjohës dhe këtë mirënjohje duhet t'a shprehte në „shtëpinë“ e tyre, në komunën e Dibrës së Madhe. Me datë 15 Gusht 2015, Ambra së bashku me disa familjarë, të afërm dhe miq udhëtuan nga Tirana drejtë këtij vendi që edhe pse larg në kilometra qëndruan pranë saj në momentet kritike të jetës duke kontribuar në vlerë monetare. Në krahë të saj ishte daja, Defrim Methasani i cili ka qenë

iniciator i sensibilizimit masiv si në rrjetet sociale ashtu edhe në media. Atje na priti i zoti i shtëpisë, kryetari i Komunës Rruzhdin Lata i cili kishte organizuar një takim për të kurorëzuar me çaste lumturie kthimin e Ambrës tashmë e shëruar në Dibër. Në atë takim nuk kishin si të mungonin edhe bashkëpunëtorët e organizimit të koncertit Dritan Lleshi dhe Bajram Kllobçishta. Por edhe familja e mikut të familjes tashmë, Valon Marke.

Dita u mbush me të qeshura dhe rrëfime, përjetime që të gjithë i kujtonin si gjëra të kaluara. Ambra mbajti një fjalim prekës pas fjalimit të ngrohtë të kryetarit, duke bërë pjesëmarrësit të derdhnin lot, por këtë herë, lotë gëzimi. Rrëfimet momentin prekës kur Valon Marke pavarësisht se e vizitonte çdo ditë nuk u mjaftua me vizitat, por „preu flokët“ që të ishte si ajo. Rrëfimet e ndiqte koncertin nga krevati i spitalit dhe thellë brenda vetes premtonte rikthimin. Shprehu krenarinë e të qenit

edhe ajo dibrane por edhe keqardhjen që ishte hera e saj e parë në këtë vend. Nuk harroj të falenderonte Zotin, që i dha mundësinë të ishte pranë njerëzve që u bënë pjesë e shpëtimit të saj. Kryetarit i dha një përfaqim familjarë sikur ta njihite prej vitesh dhe u përlot. Ndërkohë që gjyshi i Ambrës, Rexhep Meda i kujtoi se sapo kishte përmbushur premtimin: Kur të bëhen kumbullat gjysh, do vij t'i mbledh unë, - kishte thënë ajo. Dibranet e mbajnë fjalën tha gjyshi, Ambra erdhi dhe i mbledhi kumbullat këtë vit.

Në fund në shenjë mirënjohjeje për të kurorëzuar atë takim, Ambra dorëzoi disa dhurata simbolike, ku spikaste edhe figura jonë historike, krenaria e çdo shqiptari, Gjergj Kastrioti Skënderbeu së bashku me flamurin kombëtar Shqiptar që ju dorëzua njeriut që përfaqëson të gjithë qytetarët e Dibrës së Madhe, z. Lata.

Gjithçka dukej si një ëndërr e keqe, por që nxori në pah shumë vlera. Historianët dhe gjyshërit tanë mund të qeshin me këtë pohim që sapo bëra. Gjyshi do më thoshte: Po çfarë thua moj mbesë? Dibra e Madhe i ka rrënjët e thella ndër shekuj si në jetën politiko-kulturore por edhe në atë ekonomike dhe renditej ndër rajonet më të rëndësishme të hapësirës shqiptare, dhe ti po na thua që vlerat dolën në pah tani. Këto vlera i kanë mbajtur gjallë dibranët, edhe pse politikat territoriale i ndanë nga shteti shqiptar ata gjithmonë do të gjejnë mënyra për të qenë pranë nesh.

Në këtë vizitë u ndjeva shumë familjare, njerëz shumë të dashur dhe mikpritës, pata fatin të jem në tre shtëpi të ndryshme atë ditë. Fillimisht në shtëpinë e shqipes së Dibrës Valon Marke, më pas në shtëpinë e të gjithë dibranëve, në Komunën e drejtuar me korrektësi dhe për zemërsi nga z. Rruzhdin Lata, dhe së fundmi në një shtëpi të dashur dhe mikpritëse të familjes së Lavdërim Kllobçishta.

Unë që po ju shkruaj, jam një vajzë që isha për herë të parë në Dibër të Madhe pikërisht për këtë aktivitet, për këtë takim mirënjohjeje. Sigurisht kisha dëgjuar për Dibrën „e fjetur“, por doja t'ju tregoja dhe ju që perceptimi im ndryshoi, në fakt kishte ndryshuar që para 2 vitesh. Tani ju vetëm që nuk e mendoj Dibrën të „fjetur“, por mendoj që këto qytetarë duhet të ndihen krenarë për këtë vend të bekuar që ka rritur njerëz me vlera të larta. Gjithashtu, unë pranoj se dua ta rivizitoj e të rishkruaj, të rimarr pjesë në aktivitetet të tilla që tregojnë se shqiptarët, si brenda atyre kufijve ashtu edhe jashtë tyre, mbeten shqiptarë dhe kurdo ku ndjejnë rrezik për njeriun e tyre, janë aty për ta ndihmuar. Kjo është Dibra e shqiptarëve!

Zjarret në pyje, një problem i madh e kompleks

(Vijon nga faqja 4)

e të veshur, si dhe për të kuptuar rëndësinë që ka pylli i familjes për të sotmen e të ardhmen e zonave rurale.

Nëse bëjmë progres në njohjen e pyllit të familjes, do të jetë më e lehtë për të lëvizur përpara në shumë shqetësime tona të përbashkëta: respekti për pronësinë mbi tokën dhe të drejtën e pronësisë private mbi tokën e kullotën, programet adekuate qeveritare në mbështetje të projekteve për të shtuar pyjet e kullotat, e drejta për të tregtuar, apo politika të arsyeshme fiskale e kështu me rradhë, janë një mundësi e mirë për të përfshirë njerëzit për të ruajtur pronën.

Shtabet e emergjencës të të gjitha qyteteve duhet të rrisin fuqinë e tyre për të vepruar kundër zjarreve me mjetet zjarrfikëse, ndërkohë që edhe vullnetarët dhe çdo qytetar duhet gjithmonë janë të gatshëm të marrin pjesë në aksionet anti-zjarr.

- A keni ndonjë informacion se sa hektarë me pyje janë djegur gjatë kësaj vere?

REXHEP NDREU: Akoma nuk ka një shifër të saktë për rënien e zjarreve duke vlerësuar dhe demin ekonomik jo vetëm për Qarkun e Dibrës por dhe për Shqipërinë. Zjarre ka patur në Shesh-Bulgqizë, Ramnagore, Selishtë, Zerqan, Liqenin e Zi (posht liqenin). Zjarri ka përshkruar një sipërfaqe rreth 350 ha, mendohet se në zonat me dushqe demi është i vogël, ndërsa në

rreth 200 ha pyje të larta është ai në Liqenin e Zi (posht liqenin). Mendohet se ka dëmtime të mëdha të pyjeve të lartë të Ahut. Në të gjitha rastet njerëzit, kompanitë, strukturat e Shërbimit Pyjor dhe zjarre-fikse kanë dhënë kontribut në fikjen e zjarrit. Ministria e Mjedisit në bashkëpunim me ministrinë e tjera kanë dërguar avjon për dy ditë rresht për fikjen e zjarrit, por terreni tepër i vështirë dhe koha me temperatura të larta kanë bërë që kjo sipërfaqe të jetë dëmtuar, siç raportohet nga ekspertët në terren.

- A mendoni se shfrytëzimi i pyjeve po vazhdon pa kriter?

REXHEP NDREU: Aktualisht, 25 vjet pas ndarjes nga sistemi centralizuar, privatizimi i tokës është bërë vetëm për tokën bujqësore që ndodhet në fushë, toka e malësorëve në veri e jug, historikisht e qeverisur prej tyre ka mbetur pronë shtetërore. Ajo është kryesisht tokë pyjore dhe administrohet me ligje komuniste. Si rezultat në pjesën më të madhe pyjet e vendit tonë janë prerë, djegur e shkatërruar. Verilindja dhe veriu janë të varfër pasi fshatarëve u është mohuar padrejtësisht privatizimi i tokës së tyre, vetëm se përdorimi aktual i saj, quhet pyll. Në Pukë fshatarëve u është privatizuar 4% e tokës së tyre, ndërsa në Fier 96% e tokës.

Qeveritarët nuk e besojnë p.sh që pylli shqiptar në gjendjen aktuale nuk ka kapacitet të plotësojë nevojat e zonave rurale për dru

zjarri e ndërtim. Kullotat e jugut nuk i plotësojnë nevojat e blegtorisë për kullotje. Si rezultat, për të plotësuar këto nevoja të papranuara zyrtarisht pylli pritet rreth tre herë më tepër se sa rritet dhe vazhdon të degradohet. Kullota mbishfrytëzohet disa herë mbi kapacitetin e saj dhe degradimi i tokës, shtimi i erozionit e përmbytjeve janë në progresion. Në pozicion krejt të kundërt janë banorët e zonave rurale, që e vlerësojnë realisht atë nevojë që ata përpiqen me çdo mjet ta realizojnë duke shfrytëzuar sa pyllin, apo fundin e arës, buzën e përroit ku e siguron drurin për ngrohje me minimumin e transportit. Ky sistem është arritur pas përpjekjeve pothuaj njëqind-vjeçare dhe bazën e suksesit e ka garantuar nga regjistrat korrekt të tokës të realizuar shumë vite më përpara. Janë përlogaritur nevojat për çdo familje dhe sipas traditave e kushteve konkrete, janë vendosur kufijtë midis komuniteteve apo familjeve, si dhe janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e tyre nëpërmjet një kuadri ligjor me përvojë mbi 160 vjeçare.

Qeveritë Shqiptare me mbështetje edhe të ndërkombëtareve kanë marrë ndër vite hapa të guximshëm në fushën e decentralizimit të pyjeve dhe kullotave. Në bashkërendim me reformën Administrative Territoriale, Pyjet dhe Kullotat (përveç zonave të mbrojtura) do të transferohen pranë bashkive të reja. Kjo sjell sfida të mëdha për një decentralizim real të burimeve natyrore në funksion të përmirësimit të gjendjes së tyre

dhe rritjes së cilësisë së jetës të komuniteteve.

Si rezultat i informalitetit të lartë dhe keq qeverisjes në vite sektori pyjor në Shqipëri po përballlet me sfida të mëdha. Normat aktuale të konsumit tejkalojnë nivelet e shfrytëzimit të qëndrueshëm. Sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave në vitin 2012, ne konsumojmë mbi 1.2 - 1.5 milion m3 dru zjarri dhe 300-350 m3 lëndë punimi në vit në vend të 960 mijë m3 që është mundësia e prodhimit të pyjeve tona. Pra e thënë me fjalë të tjera ne presim dy herë më shumë se sa rrisim!!!

Aktualisht lënda drusore e prodhuar shkon vetëm për plotësimin e nevojave të banoreve për ngrohje. Fakti që një pjesë e mirë e popullsisë varet kryesisht tek produktet pyjore, efekti i ndalimit të prerjeve është jo eficient dhe krijon një trysni masive mbi komunitetet rurale. Mbi të gjitha një pjesë e rëndësishme e aktorëve që veprojnë në përputhje me legjislacionin do të shtyhen në veprime të paligjshme. Prandaj lind nevoja e krijimit të një marrëdhënie të re kompromisi dhe detyrimesh midis komuniteteve vendore dhe institucioneve shtetërore. Shumë banorë në zonat kodrinore dhe malore të vendit kanë marrë përgjegjësinë për të mbrojtur pyjet e tyre dhe ndryshimi është i ndjeshëm në krahasim me dy dekadat e kaluara. Ka ardhur koha që ky kontribut i tyre të njihet ligjërisht dhe të bëhet pjesë e procesit të reformës.

Bisedoi: Bujar Karoshi

Anekdota e muajit

Në Dibër, për të rregulluar punët në një sektor të rëndësishëm, por ku puna çalonte shumë, qeveria vendosi të dërgojë një njeri shumë të zotin nga një rreth tjetër. Kjo me qëllim që ai të ishte i lirë ta kryente punën i pandikuar nga lidhjet fafaisnore.

Nëpunësi i ri i shtetit, për këtë vendosi të mos pinte as edhe një kafe nga vartësit e tij, dhe kështu, gjysëm ore pasi punonjësit merrnin detyrat e ditës, dilte te kafja përballë punës dhe pinte një kafe ne banak, as nuk ulej.

Në kafe, çdo ditë rrinte edhe një plak i vjetër, të cilit i kishte bërë shumë përshtypje nëpunësi i shtetit i ardhur nga larg. Zyrtarët e vegjël, sapo hynin në kafe, flisnin për drejtorin e ri, dhe mes të qeshurave dhe harlisjeve, lëshonin edhe romuze ndaj tij, pasi gjasme, ai kishte ardhur për të ndërtuar "shtet" në Dibrën tonë. Plaku, nga bisedat që dëgjonte në kafe, kishte krijuar një respekt për shefin, edhe pse nuk kishte ndërruar as edhe një fjalë me të.

Një ditë, e porosi kamerierin, që kur të vijë drejtori i ri, ti thoshte që e kishte të paguar kafën nga plaku. Dhe ashtu ndodhi. Drejtori piu kafën dhe si çdo ditë, e la 50-shen e thyer mbi banak, por kamerieri ia ktheu, duke i thënë se kafën e kishte të

paguar nga plaku që rrinte në qoshe të lokalit.

- Faleminderit zotëri për kafën, por a bën me e ditë se pse? Mos ke ndonjë hall?

- Jo, o lum majku, asni hall nuk kam, por kujdes k'tu në Dibër, se Dibra ka luftë...

- Si ka luftë? Çfarë ka luftë?

- Një gisht ka luftë, - tha plaku, dhe duke u mbajtur pas një shkopi druri, u ngrit dhe iku.

Drejtori i ri, që e kishin paralajmëruar për të folurin alegorik të Dibrës, mbeti gjithë natën pa gjumë që ta gjente domethënien e fjalëve të plakut, por nuk mundi. Nesër në mëngjes ishte ulur te tavolina e tij dhe po e priste.


Plaku erdhi dhe nëpunësi i shtetit iu drejtuar:

- Jam gjithë natën pa gjumë, nuk e gjeta që nuk e gjeta kuptimin e këshillës tënde. A ma tregon pak?

Plaku i tha:

- Ah, mor lum majku! Dibra ka luftë ni gisht. Ka pas zakon çet gisht - dhe i luan para syve gishtin sikur tregon shkrepjen e pushkës, - ndërsa tahaj ka luftë ni gisht dhe ka kaluar ke ki qetri, - dhe i tregon gishtin e mesit...

(Rishkruar sipas një versioni të treguar nga Zaim Elezi)



Ku është Rruga?
Fillojmë në Shtator, fillojmë në Prill? Kur do fillojmë???

E morën Kinezet se morën Kinezet!
Tani e kanë marrë apo jo?!

A do të fillojnë punën apo jo?

Z. Kryeministër Rama! Thuaj e ke bërë rrugën kur të vish me makinë në Dibër të Madhe të bësh selfi, atëherë socialistët mund ta kenë besën e dibranit. Deri tani na rrofshin ato 25 Km labirinte të ndërtuara nga Saliu.

Nuk jam as socialist as demokrat, por jam dibran, jam shqiptar! Formula përçka dhe sundo për mua nuk funksionon. Ktheni kokën dhe zemrën tek dibranët! Mjaft kemi vuajtur... Kur vjen puna për sakrifice çdo herë të parë i vendosin dibranët. Kur vjen puna për ne sofër, dibrani i fundit merr lugën.

Krejt çfarë kërkojmë është 1 rrugë.
Rrugën që na premtove 2 vite më parë!

Më shumë komente ndiq në linkun:
<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=1690099697878209&set=a.1375453732676142.1073741827.100006345842081&type=1&theater>

Ç'kemi asaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Iku vapa me Gushtin, por hallet e Dibrës aty mbeten. Ç'halle do thash? Lloj-lloj hallesh... Halle me "ll" dhe halle pa "ll"...

Vapa këtë vit prishi shumë pune: qindra hektarë pyje me pisha e ahe u dogjën rreth kurorës së Liqenit të Zi, ndërsa në bëjmë vetëm statistika dhe projekte se si ti mbrojmë. Bëjmë edhe ndonjë protestë, siç pati në Bulqizë, por kush nuk e ndalon sharrën në duart e trafikantëve të drurit, që diku shfaqen me licencë e diku me shkrepse në dorë të mbulojnë krimin... Ndërsa pyjet zhduken ditë për ditë, sepse nuk kanë gojë të flasin dhe nuk kanë zë të bërtasin... Ama, mushkëritë tona e dinë çfarë thonë...

Në Selishte dy minatorë humbën jetën në një galeri që askush nuk e dinte të ishte e hapur. Madje nuk kishte as rrugë për të shkuar ambulanca. Qeveria u justifikua se punëtorët punonin në të zezë dhe ishin pa leje pune. Ndërsa opozita nuk e di nëse i ngushëlloi të mjerët. Kanë kaluar dy vite dhe qeveria dhe opozita kanë hyrë plotësisht në rolet e tyre: njëri bën sikur punon, tjetri sikur ankohet. Ndërsa minatorët vdesin...

Ministri i Financave i mbledhi mbledhësit e kromit dhe i kërcënoi se me 1 shtator do të kenë punë me ligjin: tatimet dhe doganat. Ata nuk janë trembur gjithë këto vite, edhe kur vdekja ka mbuluar galerinë, jo të tremben tani me 1 shtatorin, që kujtojnë se është akoma dita e parë e shkollës...

Ministri i Transporteve ka zënë mend: nuk jep më afate për rrugën e Arbrit. Megjithatë, në shtator thotë se presin ofertën dhe tre muaj u duhet për të negociuar. Bën-ç'bën ministri dhe kërkon t'i çojë afatet siç ka thënë kohë më parë. Por duhet t'i thotë dikush atij se ikën dy vjet...

Emigrantët edhe këtë verë, për të shkuar në Dibër zgjedhin Prishtinën dhe Shkupin. Nga Tirana i vjedhin taksat e larta dhe i lodhën rruga e gjatë...

Si gjithmonë, gushtin mund ta quajmë edhe muaj dasmash, ose më mirë muajin që ditën flemë e natën rrimë zgjuar: se s'të lë daullja poshtë pallatit dhe zëri i çjerrë i këngëtarëve live, që bëjnë sikur këndojnë muzikë popullore shqiptare me melodi greke a serbe...

Ke dëgjuar për pazarin e Peshkopisë! Jo nga i vjetri, por nga ky i riu... Që kur pashë ca foto në rrjetet sociale po më shkon mendja të mos ha më mish kurrë. Jo se nuk është cilësor mishi i Dibrës, por se e therin mes pisllekut pa asnjë standart pastërtie...

Gjithmonë kam reklamuar ushqimet bio të Dibrës. Aq të shijshme janë, sa nuk gjen shije të njëjtë në

Lajm këtë muaj ishte edhe vizita e Gruevskit në Dibër dhe Rekë. Verifikoi investimet në infrastrukturë dhe u takua gju me gju me popullin, ndërsa nuk u mësua nëse qeveria do ti vazhdojë projektet për të rrëmbyer Radikën apo jo. Thonë se tha se po pret Bankën Botërore...

Kam dëgjuar se nafta në Dibër të Madhe është më lirë? A është e vërtetë? Po shkove andej ma mbush një bidon edhe mua...

Fjalë arabe që qarkullojnë në të folurën e Dibrës

Nga **SULEJMAN TOMÇINI**

Ashu si në mbarë gjuhën shqipe, edhe në të folurën e Dibrës përdoren shumë fjalë arabe, që kanë hyrë nëpërmjet turqishtes. Disa prej tyre ruajnë kuptimin dhe domethënien e tyre origjinale, ndërsa disa të tjera janë transformuar. Këte transformim mund ta kete bere gjuha turke, nga e cila erdhën tek ne, ose edhe vete gjuha shqipe gjate viteve. Unë nuk e njoh gjuhën turke, që të mund të japë ndonjë mendim të specializuar për përdorimin dhe kuptimin e këtyre fjalëve në këtë gjuhë. Por po mjaftohem duke i rënditur një pjesë të madhe të tyre, se mund të ketë edhe të tjera, duke dhënë kuptimin e tyre në gjuhën arabe. Ndërkohë mund të ketë edhe ndonjë fjalë shqipe që rastësisht ngjason me atë arabe, gjë që mund të sqarohet nga studime te mëtejshme nga specialistët e fushës.

Them se disa prej këtyre fjaleve mund të ishin zëvendësuar me kohë me fjalë të shqipes, disa të tjera tashmë janë rrenjosur dhe janë bërë pjesë e fondit të saj leksikor. Megjithate, me pakë përpjekje, shumica e tyre mund te zëvendësohen me fjalë shqipe.

(Vijon nga numri i kaluar)

- Taksirat** – 1. pakujdesi, neglizhencë; kalim i diçkaje për pakujdesi; 3. bërje e diçkaje në mënyrë të pakujdesshme, shkel e shko; mosangazhim sa duhet në kryerjen e punëve;
- Talim** – arsimim, trajnim, të mësuarit
- Tama** – shih **Tahma**
- Tamam** – i plote, i mbaruar, i sosur
- Taraf** – anë, palë
- Tas** – pajisje për pirje
- Teferic** – hapje, zbulim
- Teklif** – 1. ceremoni; pa terklif - pa ceremonira; 2. angazhim
- Telef** – i vdekur; i kalbur a i prishur
- Tellall** – ankandist
- Temena** – urim, dëshirë
- Temerut** – mosbindje, kryengritje
- Terbijet** – edukim
- Terxhuman** – përkthyes
- Terzi** - rrobaqepës
- Teslim** - dorëzim
- Tespjje** - rruzare
- Themel** - mbetje, fund
- Tirxh** - mbulojë
- Tufan** - ujë ose rrjedhë rrëmbyese, rrëke
- Tuxhar** - tregtar
- Tybe** - pendim
- Ukubet** - ndeshkim
- Ulema** - diejtarë, shkencëtarë i madh; njohes i fesë
- Usull** - rregull a mënyrë
- Vaki** - ndodhi
- Vakt** - kohë
- Vatan** - atëdhe
- Vesves** - cytës, yshtës (për Djallin)
- Vuxhud** - ekzistencë, qenie
- Xhade** - rrugë, bulevard
- Xhahil** - injorant, i pakulturë
- Xhahis** - i lejuar, i mundshëm
- Xhahus** - syzgurdulluar
- Xhambaz** - gjimnastikë. Në të folmen e Dibrës kjo fjalë ka hyrë me kuptimin e njeriut që din të bëjë tregëti, me një nuancë negative
- Xhami** - faltore e muslimanëve
- Xhehmem** - ferr
- Xhelat** - ai që godet me fishkull, të pret me shpatë apo të torturon në përgjithësi
- Xhelis** - i ulur
- Xhemat** - grup, grumbull njerezish
- Xhenaze** - procesimi i te vdekurit, i vdekuri
- Xhenet** - kopsht; parajsë
- Xhep** - xhep
- Xherah** - kirurg
- Xherime** - krim, faj. Shkoi xherime - shkoi viktimë
- Xhevahir** - gur i çmuar
- Xhevap** - përgjigje. **Hazër xhevap**- gati përgjigjen
- Xhibla** - i pështyrë, antipatik
- Xhihad** - luftë, betejë, përpjekje, zell
- Xhinde** - në fenë islame: një nga krijesat e Zotit, që thuhet se qëndron midis njerëzve dhe shpirtërave e që nuk duket
- Xhins** - lloj, specie, gjini. Xhins i keq- lloj i keq
- Xhuma** - dita e premtë
- Xhumhuriet** - republikë
- Xhybe** - rrobë e gjerë që vishet sipër, pelerinë
- Ylefe** - ushqim, tagji
- Ymër** - moshë
- Zabit** - officer
- Zabun** - klient
- Zahire** - rezervë
- Zahmet** - ngushtësi, trafik
- Zaif** - i sëmurë, dobët, i pafuqishëm
- Zaman** - kohë, epokë
- Zambak** - zambak
- Zamkë** - rreshirë, lëndë ngjitëse
- Zap** - fikson, kap, shtërngon
- Zarar** - dëm
- Zarf** - zarf. (Fletë letre e palosur në katër cepa dhe e ngjitur, që shërben për të futur në të një shkresë a një letër drejtuar dikuj. (Fjalori i Gjuhës Shqipe)
- Zebenija** - lake, kleysh, agjenturë
- Zemzem** - Zemzem - emri i burimit te Mekës.
- Zeqat** - Në fenë islame: ajo që jepet nga i pasuri për të pastruar shpirtin
- Zift** - serë, bitum
- Zijafet** - mikpritje, qerasje.
- Zijaret** - vizite. Kam vizaret - kam vizitë
- Zimbil** - shportë, kanistër
- Zinzane** - qeli burgu
- Ziqër** - kujtim, përmendje
- Zullum** - padrejtësi. Prej ketu zullumqar- keqbërës.

Dikur në këtë fshat duheshin shumë përpjekje për ta nxjerrë kafshatën e gojës, por sot rruga duket sikur ka filluar të ngjallë më shumë shpresë për banorët.

Rruga 6 km e gjatë dhe 8 metra e gjerë po ndërtohet me shpejtësi. Rritet vlera e pronës dhe shpresat për punësimin e banorëve. Filozofia e Knauf: bashkëpunim me komunitetin. "Fuqia jonë buron nga toka", është njëri nga sloganet e kompanisë, kështu që ekologjia dhe ekonomia janë për Knauf të pandara. Zhvillimi i kompanisë lidhet me lëndën e parë, gjipsin. Kjo lidhje me tokën forcon ndërgjegjen e kompanisë për ekologjinë dhe ekonominë.



Vranjti, fshati që po mirëpret Knauf-in,

Nga MIRAN TAFI
BUJAR KAROSHI

Në rrugën që lidh fshatrat Vranjt dhe Limjan me qytetin e Peshkopisë, në muajin qershor u dukën të punonin fadromat dhe makineritë e rënda, të cilat rifilluan rrugën e lënë përgjysmë tre vjet më parë. Rruga, jo vetëm që do t'i shërbejë shfrytëzimit të gjipseve në masivin malor të Vranjt, por do të jetë edhe një shërbim i madh ndaj komunitetit të këtyre anëve.

Dikur në këtë fshat duheshin shumë përpjekje për ta nxjerrë kafshatën e gojës, por sot rruga duket sikur ka filluar të ngjallë më shumë shpresë për banorët. Dikur, për të treguar ashpërsinë e vendit, njerëzit thoshin: "Nuk jetohet në gjipsa të Vranjt". Një fshat jo shumë larg qytetit, i varfër, jo për faj të banorëve, por sepse ashtu është gatuar të jetë. Relievi i tij është tepër malor, aq sa po të ngjitesh deri lart në fshat të duket sikur gjendesh në tribunën e kurorës së Dibrës. Kjo lartësi ka bërë që lëvizja të jetë e vështirë, sidomos në dimër i cili vjen herët dhe ikën vonë. Tokat të jenë të varfëra e të pamjaf-tueshme për të mundësuar një jetë normale në një familje fshatare. Bujqësia nuk mund të jetë sektori primar i ekonomisë së zonës, për shkak se mbjelljet fillojnë gati dy javë më vonë se në fshatrat e tjerë të Dibrës, gjë

e cila bën që mbirja e tyre të rrezikohet nga thatësira. Dimri po ashtu shpejton të vijë dhe jo rrallë të mbjellat mbeten të pavjela.

VRANJTI, FSHATI QË JETON ME PASURITË E NATYRËS

Fshati Vranjt gjendet në pjesën më lindore të luginës së Dibrës, midis dy përrrenjve të famshëm, atij të Gjalagoshtit dhe të Gramës. Mbi kokë, në lindje i qëndron mali i Gjipsit, i cili shkëlqen si pasqyrë dhe pas të cilit nuk ka më vendbanime. Në jugperëndim kufizohet me fshatin Bahute, në perëndim me fshatin Sohodoll (4 km) dhe në veriperëndim me fshatin Limjan.

Fshati gjendet 1100 metra mbi nivelin e detit. Dimri është i gjatë dhe i ashpër, ndërsa vera e freskët për shkak të lartësisë, por reshjet janë të pakta. Në stinën e dimrit reshjet e borës janë të pranishme me gjatë se në fshatrat e tjerë të zonës, dhe deri më sot, e rruga për në qytet mbetet e bllokuar. Janë të freskëta në memorien e njerëzve rastet kur të sëmuret i kanë sjellë me barela të sajuara duke lidhur dy drurë me batanije. Por solidariteti shoqëror është tipari që i karakterizon këto banorë. I gjithë fshati mobilizohet, i ri e i vjetër. Me radhë ndërrohen kur lodhen dhe deri në fshatin më të afërt, Sohodoll, nga i cili transporti për në spital mund të vazhdohej

me automjete. Tani që banorët po shohin që rruga po ndërtohet me standarde të larta, 8 metra e gjerë, ndërtimi i rrugës për ta është edhe një shpresë sepse të paktën firma që do shfrytëzojë gjipsin nuk do lejojë bllokimin e rrugës gjatë dimrit.

Në fshat jetojnë një popullsi prej 600 banorësh, të cilët njihen si njerëzit më punëtor të zonës. Nuk është e vështirë për ta kuptuar: kushtet e vështira natyrore kanë bërë që këto njerëz të kenë shpirt punëtor e madje e luftarak. Vera vjen më vonë në këtë fshat, megjithatë gjithmonë medalja ka dy anë. Njerëzit e këtushëm dinë t'i shfrytëzojnë mirë begatitë që ofron mali. Madhështinë që ka mali e përdorin në favorin e tyre. Me shkrirjen e borës të gjithë nxitojnë të fillojnë aktivitetin e tyre ekonomik të përvitshëm. Disa rindërtojnë stanet për bagëtitë e tyre të dëmtuara nga dimri, i cili hahet dhëmbë për dhëmbë e sy për sy me ta. Dihet, si gjithmonë, ata në pranverë e mundin dimrin e deri në vjeshtë rimëkëmben për tu bërë gati në betejën e ardhshme, e cila nuk vonon shumë. Gjatë pushimeve shkollore, fëmijët, të gjithë pa përjashtim mbledhin bimë mjekësore për t'i shitur. Më paratë e fituara blejnë librat, mjetet shkollore dhe vishen e mbathen për fillimin e shkollës në shtator. Vitet e fundit fitimet nga emigracioni kanë rënë dhe shumë të rinj kanë mbetur pa punë, duke humbur shpresat.

GJIPSET, MUNDËSI PËR TË RRRITUR EKONOMINË LOCALE

Banorët e Vranjt janë krenuar qysh herët me pasuritë natyrore që është më cilësori në rajon, por asnjëherë nuk kanë përfituar nga kjo pasuri. Që në vitin 1978 janë bërë përpjekje për shfrytëzimin e tij, por për shkak të mungesës së rrugës, thuhet se ish kryeministri i asaj kohe, vendosi që në vend të gjipsit të Vranjt të shfrytëzohej ai i Sarandës, meqë kostoja e transportit ishte shumë më e ulët. Por që dolën në konkluzionin se gjipsi i Vranjt është më i mirë për t'u punuar pasi është më i butë, shfrytëzohet nga lart poshtë, pa firo. Megjithatë kjo pasuri mbeti e fjetur për shumë kohë. Cilësia e gjipsit të Vranjt është më e mirë në vend dhe rajon. Madje në atë kohë, kampione për analiza të këtij gjipsi dhe raportoheshin sikur ishin të Sarandës.

Në vitin 1998 shfaqet për herë të parë një investitor i huaj me emrin "Ozvaldo", thonë banorët. Ata për 6 muaj u përpoqën të zhvillonin aktivitetin, por lufta në Kosovë dhe mungesa e sigurisë në vend bëri që ata të largoheshin. Në atë kohe banorëve iu premtua shumë: rrugë për fshatin, një transformator elektrik - sepse furnizimi me elektricitet ishte problem, rindërtimin e shkollës dhe ujë vaditës e të pijshëm. Premtimi i fundit por jo më pak i rëndësishëm ishte punësimi i banorëve.

Në vitin 2012 një kompani gjermane filloi punimet për ndërtimin e rrugës me qëllim shfrytëzimin e gjipsit, por u la përgjysmë.

Në qershor të këtij viti kanë rifilluar punimet për përfundimin e rrugës. Sipas tabelës vendosur në fillim të rrugës, thuhet se Komuna Kastriot me datë 6 maj 2015 ka dhënë lejen e zhvillimit për ndërtimin e rrugës së re. Knauf Tirana sh.p.k. do të investojë mbi 94 milionë lekë për ndërtimin e kësaj rruge, ndërsa realizimin e saj do ta bëjë shoqëria ndërtuese "Selami" sh.p.k. Rruga mendohet të jetë e gjatë mbi 6 km deri në karrierën e gjipsit.

Banorët e fshatit Vranjt të cilët janë të lidhur ngushtë me këtë investim, megjithatë janë të ndarë në dy grupe përsa i përket përfitimeve, njëllon sikur të ishin me dy parti kundërshtarë.



Fotot e përdorura për ilustrimin e këtij reportazhi janë realizuar nga © Miran Tafa



gjigantit e ekonomisë botërore

Një pjesë e banorëve mendojnë se ndërtimi i rrugës u ka rritur vlerën pronës së tyre. Para ndërtimit të rrugës një m² tokë kushtonte 100 lekë, ndërsa tani çmimi është dyfishuar. Një pjesë e pronarëve ku kalon rruga e kanë marrë kompensimin, ndërsa një pjesë tjetër po presin akoma për të plotësuar dokumentacionin.

Por edhe kushtet kanë ndryshuar në fshat. Transformatori është vendosur, uji i pijshëm po ashtu. Shkolla 9-vjeçare po rikonstruhet totalisht. Mbetet për tu realizuar vetëm asfaltimi rrugës, e cila do të përfundojë së shpejti, si dhe ndërtimi i infrastrukturës për ujin vaditës. Ndërsa shpresojnë se edhe punësimi do të rritet, me ardhjen e gjigantit të madh të ekonomisë botërore, Knauf.

Disa banorë të tjerë nuk e shohin me optimizëm këtë gjë. Ata mendojnë se fshatarët nuk do të përfitojnë nga ky investim, përkundrazi do të kenë pengesa për shtegtimin e bagëtive në bjeshkë. Disa prej tyre nuk po arrijnë të marrin shpërblimin për tokën ku kalon rruga, madje thonë se kushton më shumë të bëjnë dokumentacionin se sa paratë që marrin nga shpërblimi. Janë të shqetësuar se mos nga punimet do të ketë shembje masive dhe shtëpitë e tyre janë të rrezikuara. Por, për të gjithë këto pyetje, ata nuk preferojnë të flasin individualisht, duke menduar se nuk ka përgjigje për pyetjet e tyre, dhe se për këto çështje duhet të merren institucionet.

Urim Murati, menaxheri rajonal për Shqipërinë dhe Kosovën i gjigantit të madh botëror Knauf, tha për gazetën "Rruga e Arbërit" se investimi i Knauf Tirana në Vranjt është një shenjë e mirë për të gjithë rajonin, pasi kjo do të sjellë edhe investime të reja jo vetëm në infrastrukturën lokale e rajonale, por edhe më gjerë.

Lidhur me shqetësimet e banorëve, Murati nuk dëshiron t'u përgjigjet drejtpërdrejtë. "Ne së shpejti do të fillojmë punimet për shfrytëzimin e gjipsit, thotë Murati, dhe unë do të jap për gazetën tuaj një informacion të detajuar për gjithçka rreth këtij investimi, por ajo që dëshiroj të theksoj është se Knauf bashkëpunon me komunitetin. Ndaj nuk ka nevojë për asnjë shqetësim. Të gjitha problemet që dalin do të gjejnë zgjidhje bazuar në ligjet e vendit dhe bashkëpunimin mes komunitetit dhe kompanisë".



Legjenda

Abdi Shehi tregon se për gjipsin ka edhe legjenda, çudira, të cilat kanë të bëjnë me ardhjen e serbit në fshat. Rruga e ardhjes së tyre ishte nga bjeshka, në Derzë dhe në fund hynte në fshat. Atij ia kanë thënë të parët se kur ka ardhur ushtria serbe, komandantit i është ulur kali në gjunjë dhe nuk i është bindur për të vazhduar përpara. Para u kanë dalë Shehlerët dhe Fishtet, të cilët i kanë nxjerrë tabakanë me filxhanë të kafesë. Serbët janë gjendur në situatë të vështirë se po të merrnin kafënë do të nënkuptohej se duhet bërë paqe, kështu që ata nuk e morën kafënë. Por as fshatin nuk e dogjën, dogjën vetëm kashtë thekre për të lënë të kuptohet se fshati u dogj. Kur kanë ardhur për herë të dytë, prapë kali është ulur në gjunjë, por këtë herë si komandant ishte dikush tjetër i cili nuk besonte, prandaj ka urdhëruar ushtarët të plaçkisnin deri edhe bagëtitë. Por ushtarët janë larguar të tmerruar nga sulmi që pësuan nga bletët e trazuara. Sipas banorëve, kjo lidhet me besimin në fenë islame dhe në drejtësinë e saj. Edhe sot imamët e shumicës së fshatrave të tjerë janë nga Vranjt dhe Limjani.



KNAUF

Kush është KNAUF?

Knauf sot është një kompani ndërkombëtare që operon në mbi 80 shtete të botës.

Kompania është themeluar në vitin 1932 në Komunën Perl të Saarland an der Mosel nga vëllezërit Dr. Alfons Knauf und Karl Knauf, Gebr. Knauf Rheinische Gipsindustrie, ishte bërthama e kompanisë së sotme ndërkombëtare Knauf.

Tashmë Knauf është një grup sipërmarrjesh botërore si furnitor për materiale ndërtimi. Knauf-i karakterizohet nga guximi për vizion, inovacionet e investimet si edhe nga procesi i thjeshtë i vendimmarrjes dhe pasuria e ideve e të gjithë punonjësve të saj.

E krijuar nga veprimtaria tradicionale e gjipsit sot kompania prodhon materiale për ndërtimin e thatë, pllaka Knauf, pllaka akustike fibër minerale, pllakë fibër gjipsi, suva e brendshme me bazë gjipsi dhe suva e jashtme me bazë çimentoje si dhe materiale termo-izoluese me bazë të leshit gurit dhe të xhamit.

Këto sisteme ndërtimi lehtësojnë projektimin dhe ndërtimin, ofrojnë zgjidhje të plota me sukses dhe kursejnë kështu kohë.

"Fuqia jonë buron nga toka", është njëri nga sloganet e kompanisë, kështu që ekologjia dhe ekonomia janë për Knauf të pandara. Zhvillimi i kompanisë lidhet me lëndën e parë, gjipsin. Kjo lidhje me tokën forcon ndërgjegjen e kompanisë për ekologjinë dhe ekonominë.

Teknikat moderne të prodhimit janë karakteristikë e fabrikave të Knauf. Është kënaqësi të punosh tek fabrikat e tyre. Ato janë racionale dhe të vetëdijshme ndaj burimeve natyrore dhe mjedisit.

Afërsia me klientin, krijimi i lidhjeve të veçanta dhe shumëvjeçare me të nëpërmjet këshillimit të klasit parë dhe shërbimit të nevojshëm profesional të produkteve dhe sistemeve të cilësisë së lartë, janë mënyrat e funksionimit të Knauf-it në treg. Kjo arrihet me anë të teknologjisë moderne, e cila është në zhvillim të vazhdueshëm. E ardhmja është në duart e punonjësve të talentuar dhe të motivuar.

Një aspekt i rëndësishëm është "kultura familjare", që mbizotëron në kompani: të mësosh nga njëri-tjetri, të qëndrosh i bashkuar, të japësh dijet, të marrësh rolin e këshilluesit, të gesh rrugë të reja dhe të drejtpërdrejta dhe të ofrosh diçka të veçantë. Kudo në botë, ku kompania Knauf krijohet, ajo ka si kriter kryesor: ekonomizimin e ndërtimit.

INVA KUHN: Do të më pëlqente më shumë të kisha lidhje më të forta me Dibrën, por për arsye kohe nuk e shoh të realizuar këtë dëshirë. Se, edhe unë jetoj në një shoqëri me një treg ekonomik që i do njerëzit fleksibël, të disiplinuar deri në dhëmbë ose të mbikualifikuar. Kjo do të thotë, që e gjithë jeta është punë ose kualifikime pune, dhe pak kohë mbetet për gjërat e bukura në jetë.

Së shpejti në Shqipëri një tur kundër racizmit dhe diskriminimit

Inva Halili – Kuhn ka lindur në Peshkopi dhe pas studimeve në Kolegjin Turk në Tiranë, ka studiuar për Shkenca Politike në Vjenë dhe Berlin dhe prej vitësh është aktiviste në lëvizjen e të majtës jashtëparlamentare dhe antikapitaliste, sidomos në fushat kundër neonazizmit dhe racizmit. Aktualisht jeton në Berlin dhe punon si referente pedagogjike në një projekt mbi ndërhyrjen kundër antisemitizmit. Projekti titullohet “Të mendosh ndryshe...” dhe është një projekt që zhvillon materiale pedagogjike për edukimin politik jashtëshkollor për të rinj dhe nxënës. Tema kryesore gjatë studimeve për të cilën edhe është specializuar është “Teoritë dhe ideologjitë politike”. Boton herë pas here në revista shkencore mbi funksionet ideologjike të racizmit ose tema që merren me neoliberalizmin, si “Living way ideology”. Në shkurt të këtij viti botoi në gjermanisht librin “Antimuslimischer Rassismus - Auf Kreuzzug für das Abendland” “Racizmi antimusliman – një kryqëzatë për Perëndimin” nga shtëpia botuese PapyRossa, libër i cili së shpejti do të vijë edhe në gjuhën shqipe.

Redaktori i gazetës sonë bisedoi me të lidhur me çështjet që trajton libri, si dhe një perspektivë e ballafaqimit të këtyre problemeve në Shqipëri.

Inva Halili – Kuhn gjatë një veprimtarie



Bisedoi: HYSEN UKA

- Në disa vende perëndimore, armiku i vjetër, “komunizmi”, duket se është zëvendësuar me një armik të ri, që është “Islami”. A mos është kjo ajo çfarë thoshte Hantingtoni në veprën e tij, premisë për përplasje midis Lindjes dhe Perëndimit? Sa i gjeni të vërtetura apo të rrëzuara hipotezat e Hantingtonit në këtë “armiçësi të re” midis Lindjes dhe Perëndimit?

INVA KUHN: Historia me Hantington fillon – për ta thënë më saktë - me Francis Fukuyama, i cili pas rënies së “Murit të Hekurt” deklaroi fundin e historisë, d.m.th. fundin e Luftës së Ftohtë, pasi edhe në ish-vendet komuniste, kapitalizmi në formë ose variante të neoliberalizmit, e përthithi tregun ekonomik. Hantingtoni u përgjigj me veprën e tij “Clash of civilizations”, që historia nuk mbaroi këtu, d.m.th. me sipërmarrjen e ideologjise neoliberale, e cila, meqë jemi te tema, nuk preku vetem tregun ekonomik, por çdo por i jetës shoqërore iu nënshtrua kësaj ideologjie: kultura, sporti, edukimi shkollor, literatura etj. Kjo ndodhi edhe në Shqipëri. Hantington deklaroi në këtë pikë që historia do të vazhdojë më tej me një armiçësi të re, sepse sistemeve kapitaliste u nevojitet një armik për ta luftuar, si justifikim për sundimin dhe sipërmarrjen e tregjeve ndërkombëtare. Nënkupton atë proces që njohim si “globalizimi i tregjeve ndërkombëtare”.

Nga ana logjike, pas fundit të deklaruar të historisë, të gjithë vendet e Lindjes dhe Perëndimit duhet të ishin ç’armatosur, si pasojë e mbarimit të Luftës së Ftohtë. Por, e kundërta ndodhi: debatet në Europën Perëndimore dhe në Shtetet e Bashkuara u zhvilluan në formë përhapje frike dhe tmerri nga një armik i ri, i quajtur “islami”. Një sociolog francez, i cili është marrë shumë me teoritë post-koloniale, gjeti fjalët e duhura në këto kohë të bërta. Etienne Balibar parashikoi që “Muri i Hekurt” i ardhshëm do të shtyhej nga Lindja në drejtim të Europës juglindore, në Mesdhe. Me këtë prognozë, Balibari pati të drejtë, fatkeqësisht. Historia e Mureve nuk mbaroi me rënien e sistemeve realsocialiste të lindjes. Ajo vazhdoi me ngritjen e mureve të reja, të cilat ndanë, përsërisht, “armiqtë e ri” të konstatuar të Perëndimit. Në këtë kontekst, thotë Balibar, u

evolua një armik i ri, i ilustruar si një ansambël ekonomik, fetar, kulturor dhe politik, gjendet poshtë Europës jugore, i cili, i përballat kanunit europian të vlerave ose enklavave europiane në Lindjen e Mesme, i quajtur “nacioni arab”. Në këtë kontekst, u konsolidua figura e “re” armike në politikën ndërkombëtare.

Edhe në Gjermani propozohet që gjatë këtij zhvillimi u miratuan shumë masa anti-terroriste ose ligje në fushën e emigracionit, të cilat kishin si synim shtrëngimin e ligjeve kundër emigrantëve, sidomos atyre që vinin nga zonat të ashtuquajtura arabe. Për sa i përket politikës ndërkombëtare, u formuan strategji legjitimimi, të cilat justifikuan ideologjikisht zgjerimin gjeopolitik dhe luftërat e vendeve të NATO-s. Prandaj theksova në fillim rolin e sistemit kapitalist, për të treguar që atij i nevojiten armiqtë për të mbijetuar. Si pasojë, armiku i ri, “islami”, është vetëm një mjet për të zbatuar interesat gjeopolitike. Prandaj, unë do të thosha, që hipotezat e Hantingtonit – edhe pse janë shumë konservative, pjesërisht shumë eurocentrike dhe patën si pasojë justifikimin e luftërave të Perëndimit kundër botës “islame”, kanë bazë në shpjegimin e zhvillimit të kësaj armiçësie të re.

- Pse “racizmi antimusliman”? Pse ky titull? A ka diçka që shkon përtej kuptimit të fjalës “racizëm”, me të cilën rëndom nënkuptojmë kundërvënien midis racave, etnive, jo kundërvënien midis feve... A mund të ishte shprehur kjo në mënyrë më likuide, apo kemi të bëjmë me një dije/kuptimësi të re mbi termin?

INVA KUHN: Hulumtimi i këtij fenomeni varet nga disiplinat shkencore, të cilat shpesh – jo gjithmonë - mendojnë të njëjtin fenomen, por kanë definime të ndryshme. Shkencat politike dhe islame flasin mbi “armiçësinë kundër Islamit”. Sociologët dhe statistikienët flasin shpesh mbi islamofobinë. Disiplinat që merren me zhvillimin historik të kolonializmit i referohen hulumtimit kritik mbi racizmin dhe teoritë postkoloniale dhe flasin kështu mbi “racizmin antimusliman”. I vetmi terren i përbashkët është fakti që “Islami”, sidomos pas rënies së “Bllokut Lindor”, është bërë shumë virulent. Shohim situatën ndërkombëtare, gjejmë edhe aty diferencat termeologjike. Unë, personalisht, vendosa të flas mbi “racizmin kundër

Instinkti për të luftuar për diçka që në sytë e mi duket i drejtë, do të më lidhë gjithmonë me Shqipërinë. Aktualisht, po mendoj për organizimin e një udhëtimi në Shqipëri me kolegë dhe shoqëri nga Berlino. Ngaqë Shqipëria ka qenë nga vendet e pakta gjatë Luftës së Dytë Botërore që u ka rezistuar diktaturave fashiste, në çdo drejtim, mendova të bëj një udhëtim antifashist në Shqipëri, për të treguar se rezistenca ka traditë te ne.

myslimanëve”, sepse termat e islamofobisë ose të armiçësisë nga perspektiva analiste nuk mund të përshkruajnë fenomenin mbi të cilin flasim. Konceptet e fobisë i referohen fenomenit të frikës, të cilën e kanë mbartësit e kësaj fobie. Kjo frikë nuk ka pasojë të mysllimanët. Nxënësve ua shpjegoj me këtë shembull: unë mund të kem frikë nga një merimangë. Por kjo frikë nuk ka pasojë te merimanga. Si shpjegohet atëherë diskriminimi i njerëzve që konsiderohen si mysllimanë në sektorët e ndryshëm të jetës publike? Nëse frika nuk ka pasojë, atëherë nuk do të kishte edhe diskriminim. Koncepti i armiçësisë, i cili përmendet sidomos në disiplinën e shkencave islame ose politike, ka si bazë traditën armiçësore historike europiane kundër vendeve orientale. Kjo është një teori më vete, e cila ka si autorizim evoluimin e historisë të konceptit ideologjik mbi funksionin dhe rolin e “armiçeve”. Edhe kjo qasje ka një legjitimitet ekzistence, e cila gjithashtu nuk mund të shpjegojë dualizmin aktual të konstatuar ndërmjet “gjermanëve” ose “mysllimanëve” dhe pasojat që varen nga kjo diferencë.

Teoritë që merren me historinë e racizmit kanë një bazë tjetër: ato ekzaminojnë kontinuitetin dhe funksionet ideologjike që racizmi luan në shoqëri. Ky term shpjegon më saktë se si funksionon diskriminimi i mysllimanëve ose

personave që konsiderohen si mysllimanë në shoqërinë gjermane. Pse?

Pas Luftës së Dytë Botërore dhe pas eksperiencave çnjerëzore që bota bëri me sistemet diktatoriale fashiste, të cilat ndër të tjera patën si pasojë gjenocidë etnike të miliona njerëzve, OKB-ja nënshkroi në vitin 1948 një marrëveshje, që mbron përfundimisht në nivel të lartë politik ekzistencën e racave njerëzore. Pasi racizmi ka si bazë ekzistencën e “racave” ose të etnive, konsekuenca logjike e kësaj marrëveshje do të ishte, që nuk ka më racizëm në botë. Njëkohësisht, të flasësh me emigrantë në të gjithë botën, asnjëri nuk do të mohojë faktin e të qenit të paktën disa herë i diskriminuar nga zyrtarë, nga pronarë, nga mësuesi ose i diskriminuar në bar, në stadiume dhe futbollit ose në metro. Ky fakt hap një qasje të re analitike të racizmit, e cila është më e ndërlukuar sesa ajo klasikja që e njohim ne. Tani, meqë nuk lejohet të flitet më mbi “racat” njerëzore, mund ta përkthejmë racizmin me veçori kulturore, fetare ose gjeografike. E njëjta gjë ndodh edhe me fenomenin e racizmit antimusliman. Lind, ose më saktë, rilind imazhi negativ historik i mysllimanëve, që është trashëguar prej shekujsh në Europë, fillimi i të cilit gjendet në kryqëzatat e para të kishës romake si ideologji pushtimi të Orientit. Ky imazh ka mbijetuar për shekuj dhe ka pasur konjunkturën e veta gjatë historisë. Me kolonializmin, kjo figurë negative e Islamit u forcua më shumë dhe ky reliktdominon akoma vetëdijën europiane perëndimore.

Mysllimanët paraqiten si një grup njerëzish që janë të prapambetur, me pamje jo moderne dhe që duhet të qytetërohen ose civilizohen. Imazhi negativ i mysllimanëve paraqitet në ekuivalentin e perceptimit të vetvetes, që tregohet si një film negativ i vetë imazhit. Ky është operacioni tipik i racizmit: flitet keq për të tjerët, për ta paraqitur veten si të kundërtën e të tjerëve. E njëjta analizë gjendet edhe në teoritë post-koloniale, të cilat hedhin një perspektivë kritike antiracizmi. Ky proces ka ndikime të shumta dhe njëkohësisht funksionon për shoqërinë gjermane. Ndërkohë, janë miratuar ligje që kanë efekt represiv te jeta e shumë personave që konsiderohen si mysllimanë. Mund të themi që jeta publike është e “rezervuar” vetëm për jo mysllimanët, në të gjithë sektorët e jetës. Pasoja e kësaj intolerance e kanë burimin te

Racizmi antimusliman - një kryqëzatë për Perëndimin

"Racizmi anti-musliman nuk është thjesht armiqësi, diskriminim dhe frike ndaj Islamit e ndaj muslimaneve si njerëz me të tilla perceptim edhe ndaj institucioneve islamike. Ashtu edhe debati mbi "Perplasjen e Qyteterimeve" tregoi që konflikti është thellesisht i ndikuar nga interesa hegemonike gjithashtu. Pas perfundimit të Luftës së Ftohtë dhe me shume pas ngjarjes së "9/11", ceshtjet ideologjike dhe menyrat e interpretimit të "Islamit" kanë luajtur rol thellesor në sigurinë dhe legjitimitetin e politikës perendimore. Brenda vendit racizmi anti-islam është ushqyer edhe për të reduktuar të drejtat sociale, nderkohe që kontradiktat sociale janë lene në hije nga ndarjet raciste. Për me shume, paragjykimet tradicionale janë perdorur specifiku për zbatimin e politikave shtypese. Për këte shkojnë gjithnjë e me shume forca ushtarake në vendet e ashtuquajtura islamike. Inva Kuhn hulumton teorinë dhe praktiken e racizmit anti-islam dhe kërkon përgjigjet e pyetjeve të saj në fushën e politikave anti-raciste.

Funksionet ideologjike që racizmi luan në kohët e krizave financiare, instrumentalizohen nga shteti për të justifikuar reformat neoliberalë, që kanë si pasojë rritjen e papunësisë ose uljen e rrogave ose të ndihmës sociale.

Koncepti i armiqësisë, i cili përmendet sidomos në disiplinat e shkencave islame ose politike, ka si bazë traditën armiqësore historike europiane kundër vendeve orientale. Kjo është një teori më vete, e cila ka si autorizim evoluimin e historisë të konceptit ideologjik mbi funksionin dhe rolin e "armiqve". Edhe kjo qasje ka një legjitim ekzistence, e cila gjithashtu nuk mund të shpjegojë dualizmin aktual të konstatuar ndërmjet "gjermanëve" ose "myslimanëve" dhe pasojat që varen nga kjo diferencë.

racizmi. Për këtë arsye flas në mënyrë eksplicite për racizmin.

- Rreth kuptimisë së termit "islamofobi" ka diskutime edhe në nivelet e larta politike, pasi kuptohet në mënyra të ndryshme në nivele të ndryshme. Kryeministri francez Manuel Valls deklaroi: "Unë preferoj të flas për akte anti islam dhe jo për islamofobi. Fjala islamofobi ka një koncept kryesisht fundamentalist. Të quash dikë islamofob nuk është kritik, kjo fjalë nënkupton damkosje dhe racizëm". Në hulumtimin tuaj, keni ndonjë risi apo qasje të re rreth këtij termi, keni bërë ju përpjekje për një ripërkufizim të termit islamofobi ?


INVA KUHN: Që nga nivelet e larta politike nuk është në modë të flitet për racizmin, ka arsye të pandershme, që krijojnë lidhje dhe mund të zbulojnë sistemin racist të politikës. Pse fenomene të tilla nuk mund të jenë vetëm anti islamike e tregon ky shembull: nga racizmi antimusliman janë të konfrontuar edhe njerëz, të cilët nuk e shohin veten e tyre si muslimanë, të cilët thjesht nga pamja e jashtme, si ngjyra e flokëve, e lëkurës ose accenti, perceptohen si muslimanë. Shumica e muslimanëve ose personave që konsiderohen si të tillë kanë lindur në Gjermani ose kanë ndërkaq nënshtrësinë gjermane. Arsyeja pse duhet të flasim mbi racizmin dhe jo mbi islam si fe, janë pikërisht këto veçori specifike, këto karakteristika fenotipike, të cilat prodhojnë racizmin "klasik", si pasojë e diferencës së trupave, ngjyrës së lëkurës, së flokëve ose mënyrës së jetesës.

Për këtë arsye, insistoj për përdorimin e termit të racizmit edhe në nivelin politik. Që në Francë kryeministri nuk i pëlqen të flasë mbi racizmin, ka të bëjë me faktin që Franca akoma hesht mbi gjenocidet e bëra gjatë kolonializmit në Afrikën Veriore. Në Gjermani ekziston një marrëveshje e ngjashme për sa i përket trajtimit të racizmit në nivelin kombëtar. Racizmi është fenomen që lidhet ose me nazistët e kohës së fashizmit gjerman, ose me grupet neonaziste aktuale. Fakti që sektori i tregut ose i edukimit shkollor po plas nga dispozita raciste, fakti që pothuajse në akte të rregullta digjen xhamitë, fakti që nga bashkimi i dy shteteve gjermane në vitin 1989 ka mbi 200 jetë të shuara për arsye raciste, tregon nonsensin ndërmjet narrativit zyrtar dhe atij real mbi racizmin. Pastaj funksionet ideologjike që racizmi luan në kohët e krizave financiare, instrumentalizohen nga shteti për të justifikuar reformat neoliberalë, që kanë si pasojë rritjen e papunësisë ose uljen e rrogave ose të ndihmës sociale. Kjo moto ka si qëllim individualizimin e probleme shoqërore dhe ia kalon fajin e politikës jo-sociale shtetërore, individëve ose grupeve

shoqërore (myslimanëve). Pasojat i mbajnë viktimat, jo shteti. Prandaj është komode nga ana e tij, të relativojë racizmin dhe të flas mbi akte anti islame.

- Ju jeni marrë me hulumtime rreth shfaqjes së islamofobisë në arealin social-kulturor e institucional gjerman. A mund të përmendni rendisni disa tipare dhe veçori që e karakterizojnë islamofobinë në këto mjedise, në ndryshim me manifestimin e islamofobisë në vende tjera të Evropës Perëndimore, p.sh., me atë në Francë, Britaninë e Madhe, Austri etj. ?

INVA KUHN: Sidomos pas "9/11" pati një rritje të madhe të akteve raciste kundër muslimanëve ose njerëzve që konsiderohen si të tillë. Përveç damkosjes në të gjithë sferën e jetës shoqërore, shteti bëri të tijën dhe institucionalizoi një sërë ligjesh, të cilat përkrahin stereotipet dhe stigmat që ekzistojnë mbi muslimanët. Në vitin 2003, në landin Baden-Württemberg, qeveria miratoi një katalog pyetjesh të veçanta për muslimanët, nëse këto aplikonin për të marrë nënshtrësinë gjermane. Këto pyetje u orientoheshin vlerave demokratike. Që do të thotë, që shteti gjerman, mendon se muslimanët janë nga natyra më budallenj, kundër demokracisë ose jo liridashës. Ky ligj ishte një shkelle e dinjitetit njerëzor, sepse njerëzit, për arsye feje, trajtohen ndryshe. Edhe debati për të drejtat e grave funksionon me një skemë të njëjtë: Vetëvendosjes dhe autonomisë së gruas perëndimore (është e diskutueshme, nëse është fakt i vërtetë) i vihet pasiviteti dhe nënshtrypja e gruas muslimane, si viktimë e imazhit të burrit agresiv musliman dhe dominues. Sepse propozohet që të gjithë muslimanët janë nga natyra agresiv dhe jo modern. Njëkohësisht, perëndimi paraqitet si i emancipuar, tolerant dhe me vlera të larta, për sa i përket imazhit femëror. Që gratë në perëndim akoma fitojnë një të tretën më pak se burrat, ky nuk është fakt për tu përmendur. Ose tema e synetllëkut u diskutua deri në gjyqin e lartë, i cili u dha të drejtë muslimanëve dhe hebrenjve. Në këtë debat, feja dhe "kultura" u diskutuan në bazë të vlerave të idesë binare: "qytetërimi perëndimor" vendoset si standard dhe hebrenjtë ose muslimanët etiketohen si të prapambetur, si njerëz që duhet të misionohen nga Perëndimi. E njëjta gjë tek debatet mbi ndërtimin e xhamive, që patën si pasojë demonstrata të mëdha raciste. Kushtetuta gjermane barazon të gjithë fetë para ligjit, që nënkupton legjitimitin e ushtrimit të një feje. "Kush ndërton, mbetet këtu" ishte tenori i racistëve, që në shumë qytete atakuan komunitetet fetare. "Islami", si jo pjesë e shoqërisë, përcaktohet si kundrapeshë ndaj identitetit perëndimor të krishterë dhe



iluminues. Lista nuk mbaron akoma. Edhe një shembull të fundit: si të prapambetur dhe të pacivilizuar paraqiten muslimanët në lidhje anti-semitizmit, sepse supozohet që muslimanët janë të prirur për anti-semitizmin. Kjo i shërben shtetit gjerman për të rehabilituar fytyrën dhe imazhin historisë gjenocide, që vrau më tepër se 6 milionë hebrenj. Fakti që ky pretendim nuk është i saktë e tregojnë shqiptarët muslimanë, të cilët gjatë Luftës së Dytë Botërore, si të vetmit kur bota u mbylli dyert emigrantëve hebrenj, shpëtuan jetën e mijëra hebrenjve që ishin në arrati.

- Po shqiptarët muslimanë në Gjermani, përfshihen apo veçohen, d.m.th janë objekt i ndjenjave dhe qëndrimeve islamofobike ndaj tyre?

INVA KUHN: Kryesisht përfshihen nga kjo stigmë dy grupe të mëdha personash, që janë prej vitesh pjesë integrale e historisë së emigracionit gjerman. Diskursi i emigracionit (në ish Gjermaninë Perëndimore) është perceptuar gjithmonë vështirë, sepse nuk ka pasur një definicion të përgjithshëm. Ndërkohë që në vende të tjera europiane, migracioni ishte pjesë e shoqërisë, në Gjermani ky hap – d.m.th. njohja zyrtare e emigracionit, si një realitet komunal - ndodhi në vitin 2005. Ky nuk është vetëm një turp i madh për një shoqëri me një të shkuar më se të tmerrshme, kjo tregon edhe trajtimin zyrtar të shtetit gjerman me historinë e tij të hidhur dhe kontinuitetin e racizmit.

Deri në vitin 1980 ka pasur një migracion të kontrolluar në Gjermani. Flitet për të ashtuquajturit "punëtorë mysafirë" nga Turqia, Ballkani, Lindja e Mesme dhe Irani, të cilët u ftuan nga shteti gjerman për të punuar, që nuk do të thotë asgjë tjetër se sa ishte një migracion i nevojitur për Gjermaninë. Nuk po flas për kushtet e punës çnjerëzore dhe shpërbllimin qesharak, që mjaftonte vetëm për të mbijetuar. Nga mesi i viteve 1980 puna ra, këto punëtorë mysafirë nuk nevojiteshin më, por ngaqë kishin marrë familjet e tyre, nuk mund të ktheheshin në vendet e tyre, sepse ekzistenca e jetës gjendej në Gjermani.

Papritmas, nuk u fol më me "punëtorët mysafirë", por për "turqit" ose "arabët". Shumë shpejt, pas rënies së Murit të Berlinit, ata u bënë vetëm "myslimanë". Pa marrë parasysh prejardhjen, nuk flitej me për libanez ose turkun, por për muslimanët. Ndodhi tamam ajo që nënkuptojmë poshtë racizmit: përgjithësimi i veçorive kulturore, fetare ose gjeografike, në një grup të vetëm. Ç'dua të them, është që në radhë të parë përfshihen nga ky racizëm turqit dhe persona që konsiderohen si arabë. Për një urrejtje të tillë kundrejt shqiptarëve, si muslimanë, nuk kam dëgjuar, por kjo nuk varet nga shqiptarët, por ka të bëjë me faktin që shqiptarët nuk kanë qenë pjesë e historisë së emigracionit gjerman. Prandaj edhe e sqarova më gjerë këtë pyetje.

- Në një intervistë për një gazetë shqiptare ju keni pohuar ateizmin tuaj. Duke pasur parasysh faktin unikal se Shqipëria ka qenë i vetmi vend në botë që e ka pasur të sanksionuar në ligjin themelore/Kushtetutë, ateizmin, si e gjykoni ju këtë fakt në perspektivën e zhvillimit të shoqërisë njerëzore, si një fakt që do të vlerësohet apo që na damkos para botës së iluminuar ?

INVA KUHN: Personalisht nuk mendoj që

Të flasësh me emigrantë në të gjithë botën, asnjëri nuk do të mohojë faktin e të qenit të paktën disa herë i diskriminuar nga zyrtar, nga pronari, nga mësuesi ose i diskriminuar në bar, në stadiumet e futbollit ose në metro. Ky fakt hap një qasje të re analitike të racizmit, e cila është më e ndërlikuar sesa ajo klasikja që e njohim ne. Tani, meqë nuk lejohet të flitet më mbi "racat" njerëzore, mund ta përkthejmë racizmin me veçori kulturore, fetare ose gjeografike. E njëjta gjë ndodh edhe me fenomenin e racizmit antimusliman.

ky fakt na damkos para botës së iluminuar. Për ta thënë më saktë, nuk e kuptoj pse fakti që feja, si pjesë konstituale e shtetit, konsiderohet si diçka iluminate. Një shoqëri ose një shtet mund të paraqiten si iluminate, nëse ato janë në gjendje të barazojnë të gjitha fetë para ligjit, pa favorizuar një nga këto. Edhe pse kjo barazi gjendet në Kushtetutën e Shtetit Federal Gjerman, ne nuk mund të flasim për një barazim real, nëse p.sh., në klasa shkolle gjermane gjenden kryqet e Krishtit, por nuk u lejohet mësuesve me shami në kokë të japin mësim.

Unë favorizoj ndarjen totale ndërmjet shtetit dhe fesë. Feja është fe, politika politike. Nëse duam një rol të fortë të fesë si në kohët e Mesjetës, ku institucioni i kishës katolike ishte organi ligjberës, ligjvënës dhe ekzekutiv, atëherë, nuk mund të flasim më për një botë iluminuese. Tentimi i ndarjes së Kishës nga Shteti ka qenë një nga arritjet më të mëdha të revolucionit francez. Që kjo ndarje akoma nuk është përfunduar, e tregon fakti se si trajtohen fetë e tjera monoiste në vendet perëndimore. Dhe ky aspekt më motivon më tepër, për një mbështetje kushtetive laiciste, që nuk do të thotë sanksionim i të gjitha feve, por një ndarje absolute të feve nga shteti. Nga kjo perspektivë nuk do të thosha që ky fakt na jep një hije të keqe. I hidhur ka qenë fati i shumë besimtarëve shqiptarë në këtë kohë, që nuk mund ta jetonin fenë siç donin, por jo që shteti ishte ateist.

- Ju keni lindur në Shqipëri, më saktë në Dibër. Çfarë gjeni te vetja një të vërtetë, një fakt, prej të cilit nuk mund të "çiroheni" gjithë jetën dhe që do të ju mbajë përjetësisht të lidhur me Shqipërinë?

INVA KUHN: Nuk e di, po mendoj se instinkti për të luftuar për diçka që në sytë e mi duket i drejtë, do të më lidhë gjithmonë me Shqipërinë. Aktualisht, po mendoj për organizimin e një udhëtimi në Shqipëri me kolegë dhe shoqëri nga Berlina. Ngaqë Shqipëria ka qenë nga vendet e pakta gjatë Luftës së Dytë Botërore që u ka rezistuar diktaturave fashiste, në çdo drejtim, mendova të bëj një udhëtim antifashist në Shqipëri, për të treguar se rezistenca ka traditë te ne. Gjithashtu, do të na ofrohej të njihnim edhe dëshmitarë okularë, që gjithashtu kanë rezistuar duke shpëtuar jetën e mijëra hebrenjve gjatë kësaj kohe të hidhur të historisë botërore.

- A i keni të gjalla lidhjet me vendlindjen, me Dibërën, dhe si e realizoni këtë, kur dihet se ju keni një ritëm të punës dhe jetesës, të ndryshëm nga ritmi dhe mënyra e jetesës në Shqipëri. A keni ndonjë përvojë që mund ta sugjeroni për ata që kanë një mënyrë jetese si e juaja, por që duan të ruajnë lidhjet me atdheun?

INVA KUHN: Do të më pëlqente më shumë të kisha lidhje më të forta me Dibërën, por për arsye kohe nuk e shoh të realizuar këtë dëshirë. Se, edhe unë jetoj në një shoqëri me një treg ekonomik që i do njerëzit fleksibël, të disiplinuar deri në dhembë ose të mbikualifikuar. Kjo do të thotë, që e gjithë jeta është punë ose kualifikime pune, dhe pak kohë mbetet për gjërat e bukura në jetë. Po të kisha kohë më tepër, do të takoja më shpesh shoqërinë, fqinjët dhe natyrisht familjen, e cila gjendet akoma në Shqipëri.



BALADA E DRINIT

Tre histori nga Luginë e Drinit të Zi

Nga DIONIS XHAFJA

Në kohën që po e jetojmë, atë të globalizmit, brenda këtij moderniteti, si Republikë brenda Republikave, është edhe Shqipëria.

E, brenda shtetit tonë, duket se "koha e globalizmit" ngjan e shpërndarë në një farë mënyre, nga qendra drejt periferisë.

Tirana, si kryeqytet ngjan si e prekura e parë prej dukurisë së teknologjisë, ku bëhet "selfie" nëpër lokale, e ku flitet në "Skype" me të dashurit e zemrës.

E, sa më larg kryeqytetit, duket se aq më e largët është mundësia e qytetarëve, për të patur mjete teknologjike, me qëllim që të jenë në një hap me shumicën e njerëzve në kryeqytet dhe me atë që konsiderohet si "epokë globale".

HISTORI 1: "LIRI" E SHPIRTIT TË VUAJTUR!...

E, një rast tipik me u ndal, është në vendlindjen time, në Dibër.

Tipike e varfërisë së shekullit të ri ishte një familje, që jetonte e veçuar thajse krejt nga pjesa tjetër e fshatit, tashmë fshat me elementë "qytetarë", me lokale, restorante, hotele, qendra interneti etj.

Kjo familje, e varfëruar sa nuk bëhej, që në një dhomë dhe në një sallon jetonin bashkë të gjithë anëtarët e saj, që kushtet ishin skandaloz, e është tragjike dhe e dhimbshme po të flasësh për teknologji, kompjutera apo I-Phone, që për familjen që po flas ishin ëndërr.

E mbyllur në vetvete, ndoshta edhe prej frikës se nuk ngjan me tjerë apo edhe diskriminimi, si të turpëruar të thuash prej varfërisë së vet, e që mezi mbanin frymën gjallë me punë të rëndomta, ku munden me gjet', kjo familje ishte shëmbëlltjërë e mjerimit dhe në shekullin e përparimeve të mëdha, që po e jetojmë.

Familja kishte dy djem më të mëdhenj, që sakrifikonin thajse gjithçka për ata pjesëtarë të asaj vatre, që e kishin humbur edhe fëmijërinë për të ndihmuar anëtarët e familjes që të jetojnë pak më mirë se mizerja.

Ata mblidhnin kanaçe, punonin ku të mundnin, ndershmërisht në varfërinë e vet.

Varfëria, në ata djem e kishte "ngrënë" fëmijërinë, gëzimin, harenë, lumturinë dhe iu falte veç gangrenë e dhimbje, për tu pajtuar me atë status të mjerë.

E, kur ndonjëherë vëllai i madh kishte aq lekë sa të blinte bukë tek furra e komunës, i ngazellenin sytë nga gëzimi dhe familjarëve gjithashtu. E, atë bukë, ata familjarë edhe ashtu siç ishte, të thatë, e hanin duke lëpirë gishtërinjtë.

Ajo bukë dukej sikur e gjallonte atë familje, atë barrakë të veçuar, që ishte bërë një mjerim e skamjen, ku hynte pislleku, në tavane kishte rrjeta merimangash e kërrkund s'kishte pllaka, por vetëm plastmas të shtruar për llaçi të thërrmuar.

E, si mos të ishin të ftohur, të sëmure e kushedi me sa sëmundje ata fëmijë të asaj shtëpie, kur në dimër, bora që binte mbi një metër hynte brenda, kur era e fortë depëronte përtej mureve të çarë. Mjerim të gjallë mundeshe me pa!

Më i madhi djalë i familjes, si me thanë, dukesh prej së largu se vuante, pasi që kishte ngelur kockë e lëkurë, e kur hiqte bluzën, kur punonte në vapë, i dukeshin bash edhe brirët e barkut.

Mjerimi shihej tek ai djalë, tek ata sy të zgurdulluem, tek heshtja e madhe tek ai person, e sa duket më tepër se puna e rëndë, atë djalë e vriste dallimi prej të tjerëve, pamundësia për të patur vetë dhe sidomos pjesëtarët e familjes, atë që e kishte shumica.

...Kaluan kohë dhe tek ai djalë e tek ajo familje e mjerë e njëjta gjendje.

Një ditë, si duket djali i madh kishte vendos me e thy' atë monotoninë që e "vriste" përditë dalëngadalë.

Ai bëhet bashkë me shokë, që më në fund ishin bërë zemërgjërë, hipën në një makinë dhe për të shkuar në qytet, si të rinj, për të eksploruar, për të shpërthyer në vrull rinor.

E, bash duke përjetuar atë vrull, atë klimë, atë fllad rinie, rrugës makina pëson defekt dhe

të gjithë djemtë që ishin nisur me atë makinë pësojnë aksident.

Makina bie nga 30 metra lartësi drejt e në humnerë.

Shumica e atyre që ishin përfshirë në aksident kishin shpëtuar. Veç, djali i familjes së mjerë dhe një tjetër djalë po i një familjeje të varfër, kishin ndërëruar jetë.

Atje poshtë! Në humnerë. U shuan dy jetë rinore, që kishin vuajtur aq shumë.

Kaq ironikisht "moderniteti" ia mori jetën mjerimit, i cili ngjan kaq i shpërfillur prej kohës që e jetojmë.

E, këtë djalë që e përshkrova ndoshta s'duhet ta vajojmë kaq shumë. Kaq "mrekullisht" atë e mori Zoti, që ndoshta mos vuante më në këtë tokë, e që ta mbante pranë vetes.

Mjerimi në tokë nuk ishte i denjë për të, e ndoshta, atje, në qiellin e paanë, shpirt i tij do të jetë i qetë dhe i lirë.

E, kur mundesh me pa në qiell, ata yje që shndërrisin më shumë, mund të jetë shpirt i këtij djali apo atyre djemve, që kishin të njëjtin fat sikundër djali i historisë sonë.

Shpirt që vuante kaq shumë në tokë, i heshtur, i vvarë, i dërmuar, ndoshta gjeti prehje të përhershme në atje lart.

Zot e qiell i lartësuar, ndoshta e deshën atje, në mesin e tyre, për tia plotësuar lirinë dhe qetësinë e shpirtit!

HISTORI 2: ARRATISJE DREJT FATIT TË JETËS

Shqiptarët, ndër të tjera janë një komb në shumicë emigruar dhe e kanë njohur këtë plagë të rëndë shoqërore. Kur është puna për emigrimin, fenomenin është plagë për të gjithë shoqërinë shqiptare.

E, ndër të tjera, në vendin që u rrita, në Dibër ku kushtet linin për të dëshiruar, që të mund të shpejtoje në mirëqenie ekonomike, rrugë e vetme ndonjëherë ishte emigrimi.

Mbaj mend që në pallatet që jam rritur, nga vegjelia deri në klasë të shtatë, luanim futboll tërë ditën, nuk përtonim dhe thajse nuk ndjenim asnjë lloj peshe a përgjegjësie.

Luanim mes lagjeve. Zhvillonim edhe "kampionate" lokale. Mbaj mend që aq me pasion e kishim këtë sport, sa që edhe në pikun e vapës, në mes të drekës, ngriheshim nga gjumi fshehurazi prindërve për të luajtur tek fusha prapa shkollës, në atë fushë ku "lundronte" pluhuri.

Kjo periudhë lumturie e gazi zgjati për disa vite, pasi mbi supe asgjë nuk ndjenim.

Kaluan vite. Shtati rritej dhe kërkesat po ashtu. Në klasë të shtatë ende luanim, por se disa shokë filluan të shpëputen nga loja.

I pari ishte Genti. Ai ishte djali i madh i një familje me pesë anëtarë, me babain emigrant në Greqi.

Ne të tjerët po ashtu kishim probleme familjare apo ekonomike, por jo kaq të ngutshme sa për mendjen për të ikur. E, kështu disa prej nesh vijonim të luanim.

Disa ditë luajtëm edhe pa Gentin. Teksa bënte të binte nata, kur mezi dukej edhe topi që e gjuanim, në rrugën kryesore teksa hyje për në pallatet 3-katësh ku jetonim, na shfaqet pikërisht Genti.

Nga larg vumë re se mezi ecte. Iu afroam dhe na tregoi se duke kaluar kufirin shqiptarogrek, një roje kufitare i kishte gjuajtur me automatik, jo me fishek, por ashtu, në mënyrë fizike, me armë, drejt e në gjunjë të këmbës.

Filluam ta shohim njëri-tjetrin në sy. Një si atmosferë solidariteti ndaj shokut tonë ekzistonte mes nesh.

Ndoshta edhe ne e kuptuam më mirë ç'do të thoshte "i rritur", "përgjegjësi", "probleme", "jetë".

Gentin e morëm për krahu dy shokë dhe e dërguam tek shtëpia e tij, në katin e tretë.

Sapo kishim nisur të shpëputeshim nga fëmijëria dhe një fazë e re po na priste në jetë.

Në këtë kohë shumë prej shokëve ikën sa në Tiranë, Durrës e kush munda edhe jashtë shtetit.



Topit të futbollit i kishte kaluar moshë. Sot të rritur na gjen nëpër atdhe apo larg tij, jashtë futbollit të lagjes, që na bënte dikur bashkë.

Është thënë se në këtë botë askush nuk ka kohë të tepër dhe se ashtu qenkerka vërtetë.

Koha të rremben me hovin e saj e nuk pyet as për kujtime dhe as për asgjë. Atë duhet vetëm ta ndjekësh.

Ne u rritëm dhe Genti i kësaj historie po ashtu. Ai sot punon në Greqi, bashkë me babanë dhe me vëllanë, ndërsa edhe me familjen thonë është mirë.

E, koha të lë të kuptosh se guximi të bën të sakrifikosh, por se sakrificat një ditë të shpërblehet.

Njëlluj sikurse Genti, edhe ne, bashkë-moshatarë të tij, në atë qytezë që quhej Maqellarë, kemi kaluar peripeci, dikush rrugë qorre, jetë të mbushur përplos sfida e rreziqe, kemi kaluar male e dete, e ndoksu mundet edhe kontinente.

Rrugëtimi ynë nisi ashtu, si një brez që buzëqeshi në fëmijëri, buzëqeshje kjo që me kohën nisi të ngrijë nga sfidat e rënda që të shtronka jeta.

Atje, në rrugët e lagjeve të komunës, kanë mbetur kujtimet, nostalgjitë, marrëzija e një moshe që luante kur nuk luhej, që s'njihte përgjegjësi.

E, me siguri do të bjerë ndërmend sesa lehtë e kishim marrë jetë, por sa e rëndë qenka.

HISTORIA 3: LAMTUMIRË, MIK I SINQERTË

Maqellara nuk është dhe aq e madhe dhe aty thajse çdokush e njihje çdokënd. E, në këtë vend gjeje njerëz të ndryshëm, të mirë e të këqinj, të pasur e të varfër, të kamur e të lënë në mëshirë të fatit, fundja si çdo vend tjetër i kësaj bote.

Një nga ata njerëz që mbaj mend, me zemër të bardhë, i sinqertë dhe i dashur me të gjithë, ishte Fazliu.

E kush s'e njihje Fazliun. Ai endesh kudo nëpër qytezë, e thajse të gjithë e donin dhe e respektonin.

Paçka se kishte moshën më të bukur e më delikate në jetë, atë të adoleshencës, ku vështirë të ruheshin ekuilibrat, ai dinte ti ruante ato.

Fazliu binte në sy të të gjithëve për shkak të natyrës së tij të qeshur, të shkathhtësisë, respektit që impononte, thjeshtësisë e sinqeritetit.

Kisha ikur nga Maqellara për në Tiranë prej një viti dhe ishte e para herë që kthehesha, e pikërisht këtu marr vesh se Fazliu nuk ishte më, një sëmundje e rëndë dëgjova se ia kishte pamundësuar jetën.

Ai që rrinte mes nesh, që e shihje kudo, kur mua, teksa më shihje se nuk e duroja erën e duhanit të lokalit ku ishim ulur më thoshte që kjo është shenjë e mirë që mos ta pi asnjëherë atë helm...ai...nuk ishte më.

Edhe pse isha shkëputur nga Maqellara prej një viti, e mbaja mend mirë Fazliun.

Një atmosferë e zyrtë mbizotëronte atë natë në komunë. Në një shtyllë diku në qendër të komunës, tek vendi i quajtur "Lapidari" lexoj njoftimin për varrimin e tij.

Unë s'e kisha patur shok të ngushtë Fazliun dhe as shok, por për të ndaja respekt për atë se shihja tek ai person shpirtin e një njeriu bujar e të sinqertë.

Sapo pashë njoftimin, një dëshpërim i thellë më pushtoi, një ndjesi aq e tmerrshme, sa atë natë që kam fjetur në shtëpinë time të braktisur tanimë, më doli në ëndërr pikërisht Fazliu.

Më shfaqej fytyra, buzëqeshja e tij, ndonjë rast kur kishim luajtur futboll apo kishim biseduar, ndonjë këshillë apo diçka e tillë.

Më dukej kaq e pabesueshme ajo që kishte ndodhur. Nesër bëhej varrimi diku në një rrugë pranë Majtarës dhe së bashku me shokë nisem për atje.

Në një cep rruge, ku kalonin makinat, në një vend të pushtuar nga qetësia, aty do të prehej edhe 14-vjeçari Fazli.

Kishte patur moshën më të bukur, ku njeriu fluturon në hapësira të pafunda ëndërrimesh, por se si një sëpatë që bie në një pemë që sa bën të ngrejë krye të rritet, ashtu i ishte prerë jeta Fazliut.

Mes shokësh marr vesh se varrimi po vionohej, për shkak se nëna e tij nuk donte ta lëshonte birin e tij të prehej për në varreza.

Por, se herët apo vonë, kjo në varësi të fatit, të gjithë do të mbulohej nga dheu një ditë.

Dhe, ja ku vjen momenti i varrimit. Shokë, miq e familjarë të Fazliut ishin aty. Pas lutjeve, Fazliu përcillet për në banesën e fundit.

Ndoshta krejt i panjohur në atë ceremoni mortore, e hodha një lopatë dhe në nderim të mikut të sinqertë.

Në atë moment, hodha sytë lart në qiell dhe mendova se vërtetë Zoti njerz të këtille mund ti dojë pranë vetes.

Dheu mbuloi fizikisht një trup, por se askush nuk mund ti tresë kujtimet nga ai djalë. Fazliu me siguri do të mbahet mend si djali që iu falte të gjithëve nga pak nga sinqeriteti i tij.

E, kohë më vonë, shumë më vonë, në Tiranë, rastësisht në stacionin e furgonave të Dibrës, shoh babanë e Fazliut, që kishte qenë dhe sa dukej ende ishte shofer i linjës.

E, ndërmend më shkoi fakti se sido të jetë jeta, ajo vazhdon.


Të gjithë në jetë kemi fate të trishta dhe se një ditë do të jemi pluhur e hi. Jetojmë në këtë botë përkohësisht. Dikush më pak e dikush më shumë.

Fazliu ndoshta jetoi më pak, por la shumë tek njerëzit.

Ai la dhembshurinë, ndershmërinë, respektin dhe sinqeritetin.

Me rëndësi është që për sa kohë jemi në këtë jetë, të jetojmë me zemër të pastër dhe të lëmë të vepra të mira.

Vdekja fizike nuk është asgjë. As ajo e Fazliut. Ai nuk është më, por buzëqeshja dhe janë mes nesh veprat e tij të mira, hareja dhe buzëqeshja.



Kujtimet per Peshkopine

Disidencë dibrane

Nga EDMOND HASANI

Që të mos gënjej fjalën disidencë e kam mësuar, vonë fare, andej nga mesi i viteve 80, pas vdekjes së Enver Hoxhës! Po ndiqnim me tim at një emision politik tek tv Shkup për Titon dhe meqenëse e kuptoja gjuhën maqedonisht [në fakt nuk është gjuhë] më bënte përshtypje fjala e pakuptimtë "disidencija" e babai im ma shpjegoi! Tani që shkruaj turbullt për arsye kohore por qartë për arsye personale në mendje me ravijëzohen disa njerëz që vërtet ishin ndryshe të tjerëve në ato kohë ku për një fjalë të fluturonte koka bashkë me familje, shokë e komshinj! Njeriu i parë që kam dëgjuar të ironizonte Enverin, kuptohet fshehurazi ishte im atë! Gjithmonë thoshte "është aktor i madh" por unë nuk kuptoja pse edhe sepse isha adoleshent! Një kushuriri i parë gjyshe time dajo Hodo, një plak fisnik tregtar i shpronësuar e i burgosur nga komunizmi kur vinte çdo vit për llixha tek ne puna e parë që bënte ishte dëgjimi i radiostacioneve italiane, lajmet apo emisione politike! Po ashtu im atë me kultivoi edukimin muzikor duke ndjekur San Remon emrat e protagonistëve të të cilit i shkruaja në blloqe e fletore! Në klasë kam patur Edmond Ramizin i cili ishte fans i gjithçkaje të ndaluar, sidomos muzikës dhe gjenim gjuhën e përbashkët! Të kuptohemi, ato vite të kuqe të diktaturës vërtet armiqtë politike të shtetit ishin vradë apo burgosur e internuar, vërtet populli ishte indoktrinuar dhe besonte përgjithësisht "parajsën socialiste" por kishte edhe guximtare që mendonin ndryshe! Isha rreth 12 vjeç kur një herë ulur në gardhët e ulet e të bukur të lulishtes përballë gjimnazit aty ku sot janë ndërtuar klube e lokale pashë një djalë, bukursh, flokëgjatë, me një vajzë ulur në prehër e me cigare në dore! Ishte Shkëlqim Hoxha, futbollist i të rinjve të Korabit, një azgan djalë me shoqen e tij, vajza e një prej njerëzve më të fortë të regjimit! Ato kohë një pamje e tillë të habiste sepse ishte e pazakontë! Kofshët e shëndosha e të bardha të vajzës, këmishën e zbërthyer sipër pantallonave të Shkëlqimit dhe mospërfilljen e tij ekstreme e kam parasysh edhe tani si dikur! Ishin të dy nga ata të rinj të pakët që shijonin rininë e tyre pa frikë edhe si pasojë e një karakteri rebel e perëndimor! Me kujtohet edhe Liman Koleci ish boksiere elegant, qytetar i kulturuar, fans i madh i muzikës italiane e angleze që gjithmonë vërshtëllente "Love Story" dhe më fliste për VIP-at e muzikës italiane! Vëllezërit Vani gjithmonë kanë qenë antikomuniste dhe pro-perëndimore! Njihnin për mrekulli letërsinë dhe muzikën botërore si rrallë kush! Flisnin italisht të katërt e kjo ishte krim në ato kohë! Spartak Topollaj një perëndimor safi dukej që në fjalën e parë që shqiptonte se ishte i tillë! Një nga familjet ku unë tmerrohesha në lidhje me urrejtjen kundër Enver Hoxhës ishte familja e nderuar Shahinaj! Me një humor fin aty komunizmi bëhej leckë fare! I veçantë në antikongformizmin e tij ishte Edip Shehu njohës i mirë i muzikës dhe kinemasë italiane i cili gjithë jetën deri sa vdiq me përshëndeste "Çkemi e përditshmja Le Mond? "Në shtëpinë tonë meqë kam patur shumë herët televizor vinin si shumë të tjerë për të ndjekur ndeshjet e futbollit apo boksit vëllezërit fisnike Agolli për të cilët im atë dhe ime më gjithmonë thonin se janë njerëz të shkëlqyer por me "njolla" në biografi, sipas regjimit! Një nga gocat më të bukura të qytetit ishte mikja ime Xhoxha për të cilën çunat linin kokën por "ah ajo njolla në biografi!"

Shumë nga vajzat më të bukura të qytetit ishin nga familje që shteti komunist i shikonte shtrembër apo me urrejtje! Mbase jeta ime, jeta jote mund të kishte qenë ndryshe nëse këto "njollat" biografike nuk do ekzistonin! Një tjetër familje antikomuniste ku konsumohej urrejtje për të ishte familja e Miftar Dedes! Vila ku jetonin Dedajt gjithmonë më dukej si qendër konspiracioni e komplotes! Kultura e familjes së doktor Gjiks ishte komplet frymë perëndimore! Kujtoj xhaketat moderne që vishte Bujar Gjapi që i kishim zili të gjithë, madje edhe sigurimsat! Nga intelektualët antikongformistë pa dyshim dalloheshin, natyrisht fshehurazi piktori Bajram Mata, doktorët Ahmet Alliu, Ali Sula, Basri Neziri e sidomos radiologu nacionalist Hamit Xhaferi! Gjestet antikongformizmi gjeje plot tek muzikantët dibrane ku spikaste mbi të gjithë Fatmir Toska, kitarist dhe Arben Deda e Mirush Laci [Luk] baterist! Ndërkohë shumë miq të mi si Agim Islami, Bajram Deda, Abaz Hoxha, Hasan e Fatos Stojku, Ergen Zuna, Adrian e Sazan Skuka, vëllezërit Dritan e Bajken Bardulla apo vëllezërit Miftari, pa harruar mikun time të vjetër Luljeta Reka, vëllezërit Agushi bashkë me Shpëtim Shehun e disa të tjerë ndikuan shumë në rritjen e rebelizmit tim i cili kish filluar që kur më 1973 gjyshe më kish sjellë një palë xhinse blu kauboj të cilat ishin të ndaluara për kohën! Im vëlla Artani them plot siguri se nuk e ka dashur kurrë komunizmin! Kur unë bashkë me plot të tjerë lotonim duke parë në tv, në shtëpinë time varrimin e Enverit ai bashkë me mikun e tij Golen po pinin konjak gallatatisht ,ulur në trotualet pranë konviktit të gocave tek mjekësia sipër!Pas kaq vjetësh ndryshime në mentalitet dhe realitet nuk e kuptoj akoma mirë përse kishte kaq pak disidencë ose përse nuk kishte fare disidencë pas viteve 60 në Shqipëri! Kujtoj me qindra kërcime rock që kam bërë nëpër sheshe e oborre dasmash, apo mbrëmje rinore! Kujtoj verën e vitit 1987 kur i veshur me një kostum të kuq sportiv dhuratë nga violinisti dibran Arben Spahiu kërcëja rock çdo natë tek pista Iliria e pastaj i dehur hidhesha në det bashkë me shokët nga mesi i natës! Kujtoj recitimet fantastike të shoferit të njohur Gëzim Shehu i cili pa frikë në dalldinë e pasionit për të bukurën recitonte Lorken, Pushkinin apo Çajupin e ndaluar erotik! Kujtoj bukurinë tronditëse të zysh Irenës, një bukuri perëndimore në kundërmim e aparençë! Kujtoj familjen e nderuar të zysh Naferides e profesor Bexhetit ku ironia ndaj sistemit ishte gjithmonë prezente! Kujtoj vallëzimet e paharrueshme në pistën e lulishtes së turizmit apo gjetke të çifteve qytetare Mimoza e Neki Shehu, Anastasi e Ahmet Alliu, Jolanda e Rahim Gjika, Fatbardha e Gjyzel Hasani apo Vangjel Bitri me zonjën e tij! Kujtoj tingujt brilante të trompës së Jani Tases, orkestralet super të saksofonistit Hiqmet Hoxha, intelektualizmin e çiftit Antoneta dhe Tef Kroqi, kulturën brilante të bibliotekarit Ulvi Shehu, qytetarin e Seranajve, edukatën e familjes Kodra kujtoj manifestimet e tifozerisë dibrane lidhur me evente sportive që ishin të ndaluara me ligj, kujtoj meloditë e bukura, të huaja që dëshpërimisht vërshtëllnim poshtë dritareve apo ballkoneve ku jetonin "ato", kujtoj pantallonat, të pakta moderne, bluza e këmisha të ngushta, këpucë me taka, minifunde, gjokse dekolte, vithe të lezetshme e këmbë të zbuluara që së bashku me ngjarje, emra e virtyte të tjera të familjeve të nderuara qytetare përbënin zërin ndryshe atë lloj antikongformizmi që shpërtheu në dhjetor '90 !!!

Peshkopia. Më shumë komente mbi foton shih linkun më poshtë: <https://www.facebook.com/PeshkopiDiberAlbania/photos/pb.291486150930395.-2207520000.1441378558./882931908452480/?type=3&theater>

Ese

Kam dy Atdhe!

Nga SEFULLA KATA

Unë kam dy Atdhe të dashur miqtë e mi. Po, po, dy. Madje edhe ju dy keni po ndofta nuk e keni vënë re, ose e keni vënë re por ju duket e pamundur. Kurse mua, më duket shumë e mundur dhe prej shumë vitesh po jetoj i ndarë më dysh, bashkë me familjen time të vogël, madje edhe me familjen e madhe të prindërve, motrave dhe vëllezërve.

Dikur jetonim të gjithë në një Atdhe që e donim por që ai vetë në fakt, për shkak se kishte rënë në dorë të keqe nuk na donte fare. Ndërkohë që bënte deklarata shumë të forta se na donte e na çmonte si gjënë më të shtrenjtë, si sajësën dhe krijesën e tij më të gjetur e më të përkryer (emrin e kishim të gjithë njëloj: njeriu i ri socialist), na urrente për vdekje pasi shumë nga ne nuk e besonim atë që thoshte. Kësisoj na dendte burgjeve e internimeve, na torturonte e na vriste, na shkatërronte e dërmonte deri në atë që kishim më të shtrenjtë, dashurinë për njëri-tjetrin. Sidoqoftë, i mirë apo i keq, Atdheu ishte vetëm një.

Tani gjërat kanë ndryshuar. Ndryshe nga koha e Atdheut të parë i cili qeverisej gjithmonë nga e njëjta klasë politike, nga e njëjta qeveri, nga i njëjti udhëheqës, Atdheu i ri qeveriset nga qeveritë të ndryshme, nga udhëheqës të ndryshëm të cilët e kanë ndarë më dysh atë, duke krijuar secili Atdheun e vet. Në të parin banojnë ata që nderojnë me dy gishtat lart, që betohen e stërbetohen se vetëm ata mund ta nxjerrin vendin në dritë, duke i dhënë pronarit atë që i kishte humbur prej një gjysëm shekulli, duke bërë pronar edhe atë që s'kishte pasur kurrë një të tillë, duke shkolluar ata që s'kishin pasur kurrë mundësi të shkolloheshin madje edhe duke ua shkurtuar ciklin e shkollimit, nga gjashtë muaj më i gjati, deri në disa ditë më i shkurtëri. Koha nuk pret për ta. Na duhen sa më shumë njerëz të shkolluar, madje të gjithë me diploma e nëse kanë ambicje, edhe me mastera e doktoratura.

E doja shumë Atdheun e tyre se mendoja si idealist. Pasi isha gënjyer për më shumë se tridhjetë vjet, nuk më bënte kurrfarë përshtypje të gënjeshtësia edhe për ca vite të tjera. Për dy gjëra e ndjej veten keq që nuk munda t'i realizoja kur isha me banim në atë Atdhe : nuk mora dot një pronë pa pronar e pa asnjë kokërr leku, dhe nuk u dhashë të paktën diplomën e shkollës së lartë dy prindërve të mi tetëdhjetëvjeçarë të cilët sakrifikuat jetën e tyre që unë të shkollohesha bashkë me vëllezërit e motrat. Më vjen vërtet turp, sidomos për këtë të dytën se ka qenë fare e mundur, maftonim vetëm pak lekë e donjë mik. Ndjej shumë keqardhje edhe për faktin se nuk munda të bëhem «i madh», të kisha disa llogari bankare, disa apartamente me qera, të shkolloja fëmijët jashtë shtetit, të kisha të paktën tre makina të miat dhe një të shtetit sepse disa miq të mitë i kanë dhe këtë nuk ia fal vetes. Po nejshe. Një gjë e kam fituar dhe e përdor si ngushëllim për «mëkatin» që kam bërë. Me gjithë moshën që kam, gjumin në përgjithësi e bëj të qetë ndryshe prej disa miqve të mi të cilëve gjumi u ka ikur në drejtim të paditur.

Aktualisht banoj në Atdheun tjetër. Ata që e kanë hipotekuar tashmë, ndryshe nga hipotekuesit e të parit, nderojnë me grusht. E kanë si symbol bashkimi. Disa thonë se është e trashëguar nga koha e luftës. Unë besoj se është kjo e dyta. Janë të bashkuar për të rezistuar sa të mundin që të mos ua dorëzojnë Atdheun e tyre kundërshtarëve të tyre politikë se pasojat dihen. Dhe ata kanë eksperiencë në këtë fushë. U rrëshqiti nga duart?! Ec e kape pastaj për nja tetë vjetë të mira. Tetë vjet pa punë, pa lekë, pa njerëz rreth e rrotull që të luten tu gjesh punë, pa makina, me këmbët që të dhëmbin nga qëndrimi i gjatë nëpër mitingje, protesta, greva urie, me gojë që të është tharë nga të sharët e kundërshtarit me libër shtëpie, me gishtat e duarve që të dhëmbin nga statuset e panumërta të shkruara në facebook. Pra, duhet rezistencë, duhen bashkuar forcat, duhet ruajtur simboli, grushti.

Për shumë vite tashmë lufta mes përfaqësuesve të dy Atdheve është zhvilluar mjaft e ashpër, dhëmbë për dhëmbë, si në kohët e lashta. Ndryshojnë vetëm armët të cilat tani janë më të sofistikuara. Nuk ka më shpata dhe heshta. Tani ka C4 dhe gjykatë. E para të mbaron punë shpejt dhe nuk le gjurmë, e dyta të zvarrit të paktën për nja dhjetë vjet.

Kur pushtetin e ka njëra palë, jo vetëm që përfaqësuesit e saj janë të lumtur por edhe pala tjetër imagjinohet e lumtur : me mundësi të mëdha punësimi, me supermundësi shkollimi, me rend publik më të sigurt, më afër Evropës, më afër Amerikës, më afër parajsës....Çudia është se sapa pushtetin e marrin njerëzit e Atdheut tjetër, brenda disa ditësh, i njëjti Atdhe i lumtur, imagjinohet si më fatkeq, më i pashpres, më i keqpërdoruri, më i varfëri i rajonit, turpi i Evropës, turpi i botës.

Dhe ne, banorët e të dy Atdheve bëjmë çudi. Si është e mundur? Po vetë a e besojnë atë që thonë? Mos na marrin gjë për budallenj thjesht nga që jemi të varfërr?! Po miqtë tanë ndërkombëtarë a e besojnë vallë? Apo dhe ata na tallin si të tjerët?! Hall i madh na ka gjetur. Nuk dimë kujt t'i besojmë. Po halli më i madh është se nuk dimë ku të banojmë, në Atdheun e parë apo në të dytin?!

Historia e këngës së Jovan Nokës: Si u rregjistrua kënga? Kush e krijoi dhe kush e këndoi pa vijë melodike? Çfarë tregonte kënga? Kush ishte Jovan Noka dhe pse kënga u rregjistrua në kolanën e këngëve për Skënderbeun? Si u përcoll kënga nga Haziz Daci të Ali Krrashi dhe si Aliu e këndoi disa herë para mbledhësve të folklorit në dy vite të ndryshme. Një histori dhe analizë e shkruar nga Dhimitër Shuteriqi në vitin më 1976.

Jovan Noka në kohën e sulltan Mehmetit, paska udhëhequr çidhnakët kundër një sulmi të egër turk. Kënga jepej si një krijim i lidhur me ngjarjet e vitit 1466, kur, i thyer keq në muret e Krujës, Mehmeti II terrorizoi vendin dhe, gjatë tërheqjes, shkatërroi e shfarosi mizorisht Çidhnën. Barleti ka shkruar për këtë ngjarje në Librin III të "Historisë së Skënderbeut".

Nga DHIMITËR S. SHUTERIQI

Viti 1967, vigjilja e 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, ka qenë i begatë edhe për folkloristikën shqiptare. Ai vuri në lëvizje kërkimet mbi traditat e lidhura me emrin e tij gjatë shekujve. Dolën kështu materiale pak e aspak të njohura, të vjetra dhe të reja. Edhe shpresat për të zbuluar ndonjë këngë mbi Skënderbeun nuk vajtën kot. Këngë të reja, të krijuara që nga Rilindja Kombëtare e këtej, po sidomos pas Luftës Nacionalçlirimtare, u mblodhën. Zana popullore nuk e ka ndier veten ngushtë kurrë për heroin e madh të kombit.

Ndër krijimet që tërhoqën më shumë vëmendjen që një këngë e mblodhur në Çidhën të Peshkopisë dhe e botuar të gazeta "Mësuesi" më 31 mars 1967, me titullin: "Një këngë popullore e panjohur e ciklit të Skënderbeut"¹). Kënga nuk fliste për Skënderbeun vetë, po për një Jovan Nokë, i cili, në kohën e sulltan Mehmetit, paska udhëhequr çidhnakët kundër një sulmi të egër turk. Kënga jepej si një krijim i lidhur me ngjarjet e vitit 1466, kur, i thyer keq në muret e Krujës, Mehmeti II terrorizoi vendin dhe, gjatë tërheqjes, shkatërroi e shfarosi mizorisht Çidhnën. Barleti ka shkruar për këtë ngjarje në Librin III të "Historisë së Skënderbeut".

Dihet se, që nga mesi i shek. XIX, me gjithë kërkimet që janë bërë për të gjetur ndonjë këngë të lashtë mbi Skënderbeun dhe kohën e tij, fare pak gjë ka dalë në dritë²). Të zbulohet një këngë e lashtë mbi një ngjarje aq të rëndësishme si ajo e prishjes së Çidhnës më 1466, ishte një e papritur e gëzuar për folkloristikën.

Meqë kënga, në veshjen e saj, paraqitej relativisht e re, diskutime lindën. Duhej një hetim në vend. Në vitet '60, një udhëtim në Çidhën ia vlenë në vetvete nga më se një anë. Atje ishte çelur ai kanali i famshëm i Setës, i cili, përmes tunelesh e sifonësh, pasi njomte Çidhnën, kalonte nga jugu në Sinë e nga veriu në zonën e Reçit, zbriste e kalonte edhe Drinin dhe njomte Kastriotin mbarë me fshatrat kodrinore përreth. Viset e Gjon Kastriotit këto, të cilin kronika e Gjon Muzakës i përmend si pronë të parë Sinën vetë e Gardhin. Në ato vise paska bërë emër edhe një Jovan Nokë.

Këngën e Jovan Nokës e çka mund të thoshte legjenda për këtë trim të Çidhnës së hershme, e mblodhëm në vend dy herë, brenda dy ditësh në tetor 1969, prej gojës së 80-vjeçarit Ali Isuf Krrashi, i cili nuk e thoshte me ndonjë melodi, po vetëm e recitonte. E mblodhëm për së treti edhe në gusht 1976. Ali Krrashi na tregoi se e kishte mësuar prej çidhnakut Haziz Daci, vdekur "at vit ç'i ka hi Italia", pra më 1939, mbi njëqind vjeç. Edhe Hazizi këngën vetëm e recitonte. Ai e kishte mësuar "nga pleqtë e vjetër" të vendit, kurse, në kohën e tij, tjetër kush nuk i mbante mend vargjet e saj, përveç Haziz Dacit vetë.

Për Jovan Nokën, të cilin gjithashtu legjendën, me sa kujtohej Ali Krrashi, ia mbante mend vetëm Haziz Daci, në Çidhën Aliu na tregoi se ka qenë një "luftarak i fortë", që "kundërshtoi Turqinë" e Çidhna "iu mblodh", i vajti pas e tëra. Në Çidhën e në Gryknokë, ngjitur me të, Jovani bëhej 14 shtëpi, 7 në secilin katund. Vendi, sipas Aliut, gjer vonë, kishte qenë i përzier, katolik e ortodoks. Babai i tij i mbante mend të krishterët në Çidhën.

Mbi këngën e Jovan Nokës



Kepi i Xhitetit. Foto: © Haki Përnezha

Aliu nuk e dinte se cilës kohë i përkiste Jovan Noka dhe as Haziz Daci nuk e kishte ditur. "Ai ka marue, - thosh Aliu, - pasi vdiq Skënderbeu". Pra, Jovan Noka duhej t'i përkiste një kohe fill pas Skënderbeut. Ne pamë, në të hyrë të Çidhnës, nga lindja, fill nën fshat, një varr të madh e të moçëm, të ndërtuar me mur e qereç, me një kryq guri përsipër, anës xhadesë së re që të çonte në Lurë. E quanin "Vorri i Jovanit"³). Ali Krrashi aty mbante mend edhe varret të tjera dhe një kishë, së cilës muret i qëndronin në këmbë përpara se të çlirohej vendi nga Turqia, po që çati e gjë më s'kishte. Aliu na tha se Jovan Noka kishte qenë ortodoks. Nokajt kishin qenë fis që "dante gjyqin", "fis plak".

Këto janë të gjitha me interes për të gjurmuar mbi vjetërsinë e Këngës së Jovan Nokës dhe të ngjarjeve që përmenden në të⁴).

Fakti vetë, që, me sa dinte Ali Krrashi, gjatë tre çerekë shekulli këngën dhe legjendën mbi Jovan Nokën i mbante mend vetëm një njeri në Çidhën, Haziz Daci, prej të cilit ai i mësoi fjalët, këto të çojnë të supozosh se kënga është e pakta një shekull më parë, meqë dhe Hazizi e kishte nga pleqtë. Fakti që teksti i saj nuk përcillej me ndonjë melodi, prej Ali Krrashit na u shpjegua kështu: në Çidhën nuk e kanë pasur shumë zakon të këndojnë, por u binin kavalleve; Haziz Daci vetë nuk këndonte. Ai ka qenë një burrë i çmuar në Çidhën për urti, po, me sa duket, njeri përgjithësisht i mbyllur në vetvete.

Elementet artistike të këngës, veçanërisht mënyra e të rimuarit dhe stili i saj, që e lidh, por jo dhe fort, me stilin e rapsodive tona të vjetra, ashtu si dëgjohen ato në perëndim e në jug të Drinit – p.sh. Kënga e Aga Ymerit, ajo e murimit në kala ose në urë, ajo e Brahim Ketës së ri dhe pak të tjera – ato elemente nuk janë të shumta, që të flasin për ndonjë kohë shumë të largët të krijimit të këngës, sikundër nuk flasin as për ndonjë krejt të re. Kënga mund t'i përkasë fare mirë një kohe më të këtejme se fillimi i shek. XVIII, meqë është e rimuar. Shkurt, mund të supozonim, për të ndjekur fillin e argumentimit, një kohë midis shek. XVIII-XIX, aty nga mesi i shekullit të fundit e lart.

Ndonjë element krejt i ri në këngët, si përmendja e telefonit⁵), duhet të ketë hyrë në të fare së voni dhe ndoshta e ka futur Ali Krrashi.

Pasiguria që ka treguar Ali Krrashi në dhënien e disa vargjeve, në të dyja variantet që mblodhëm ne më 1969 dhe 1976 prej tij, si dhe në variantin e botuar dhe të mblodhur po prej gojës së tij më 1967, ajo pasiguri shpjegohet me vështirësitë e posaçme të recitimit, të mbajtjes mend të tekstit pa ndihmën e një

melodie dhe pa ndihmën e shkrimit (Aliu ishte bujk analfabet). Po duhet thënë se të tria herët që ne e mblodhëm këngën, recituesi nuk bëri këmbime të rëndësishme, ndonëse ishte mjaft i shkuar në moshë. Kujtesën e ai e kishte vërtet të mirë, recitimin të shkathët, shqiptimin të saktë. Edhe sikur ta përcillte tekstin Aliu me ndonjë melodi, zor se do të mund ta përsëriste më mirë gjatë katër herëve dhe brenda nëntë vjetëve. Por elemente të reja është e pamundur të mos hyjnë në poezinë popullore dhe këmbime koha sjell, sado të vogla, në mos dhe të mëdha.

Elemente të tilla, si përmendja e vergjisë, që nuk ia paguante pushtuesit Jovan Noka, dhe kërcënimi i sulltanit për ta syrgjynosur këtë "me cull e grue", në Jemen, pushka që bëhet gjatë ndeshjes me turqit dhe mospërmendja e armëve të qëmotit (shpata, mazdrake, shigjeta), të gjitha këto nuk mjaftojnë për ta vendosur këngën në një kohë të përcaktuar mirë. Po fakti që Jovan Noka nuk jepte asqer dhe kërkesa e tij që sulltani t'i jepte "tokë në Shqipëri"? Kjo kërkese e fundit nuk del e qartë, kurse emri Shqipëri mund t'i përkasë kohës së Rilindjes Kombëtare.

Mund të mendohet që Jovan Nokës t'i kishin qenë konfiskuar pasuritë në viset e Çidhnës dhe që ai t'ia ketë hyrë për këtë luftës me Turqinë, kurse populli e ka ndjekur, sepse edhe taksat ishin të rënda dhe nuk donte të shkonte asqer. Dhe ndoshta këtu kemi një element që tërheq më shumë vëmendjen: mund të na shkojë mendja, me të drejtë, se ato janë pikërisht shkaqet që i bënë malësitë shqiptare në Veri dhe në Jug, të ngrejshëm shpesh krye, p.sh. kundër Tanzimatit, në vitet '40 të shekullit të kaluar. E mund të supozojmë kështu se kënga u krijua në ato vjet, në atmosferën e ngjarjeve që tronditën edhe krahinat e Dibrës. Le të kujtojmë këngën e njohur të Hajredin pashës, i cili "vjen Radikës" në krye të një ekspedite të madhe turke, që pëson disfatë.

Po përse në kohën e Tanzimatit të krijohej, përveç këngëve që flasin për ngjarjet e ditës, edhe një këngë mbi kujtime të lashta popullore, ku flitet për sulltan Mehmetin e për një ndeshje të madhe shqiptaro-turke në Çidhën, ndeshje që, në kohën e Tanzimatit e këtej, nuk dimë të jetë drejtuar nga ndonjë Jovan Nokë? Do supozuar atëherë se legjenda e një Jovan Noka të së lashtit, që theu turqit, ishte e gjallë në popull, ndërsa populli krijon herë pas here këngë të reja mbi ngjarjet e paharruara të së kaluarës, kur ngjarjet aktuale janë të tilla që edhe ta kërkojnë. Ngjarjet e reja rreth Tanzimatit, që u bënë shkak për pasurimin e epikës popullore me krijime poetike, bënë të evokoheshin edhe ngjarjet e vjetra kundër të

njëtit pushtues të urryer, të thyer dje, të thyer edhe sot, po që mbetet akoma për t'u shporrur prej tokave shqiptare.

Gjatë ndeshjeve të reja me turqit, si ndeshja e krahinave të Dibrës me ekspeditën e Hajredin Pashës, ka qenë e natyrshme që në Çidhën, ku, për fat të keq, nuk i dimë lëvizjet konkrete të kohës, t'i thurej kënga një Jovan Noka, që përmendej për qëndresën e tij dhe të gjithë krahinës, së silos ai i printe, për fitoren e tyre kundër turqve motit, një Jovan Noka, të cilit i ruhej edhe varri e i nderohej akoma në Çidhën.

Kënga flet për një sulltan, për të cilin Ali Krrashi na tha se nuk ishte "Mehmeti i kohës së Hyrjetit" (sulltan Mehmet Reshati), po "sulltan Mehmeti i hershëm". As sulltan Mehmeti II, as i ati, Murati II, të dy kundërshtarët e Skënderbeut dhe që u thyen në kaq luftëra prej tij, nuk kanë dalë prej kujtesës së popullit të Shqipërisë. Kujtimi i vetë Skënderbeut, që u ndesh me ta gjatë një çerek shekulli, bëri që edhe ata të mos harrohen bashkë me gjëmat që sollën e me urretjen e turpin që morën me vete. Masakra e Çidhnës e vjeshtës 1466 zor se mund të harrohej në popull. Po, së fundi, vjen një kohë kur edhe ngjarjet të tilla dalin prej kujtesës. Legjenda popullore, me aq sa është mblodhur gjer më sot, nuk e kujton masakrën e hershme të Çidhnës. Porse populli di që Skënderbeu ka luftuar në viset e Çidhnës dhe ka fituar⁶). Nga ana e tij, Barleti, për masakrën e Çidhnës ka shkruar: "... sulltan Mehmeti, siç thonë, mblodhi plaçkat e u largua nga rrethimi i Krujës natën, duke marrë me të shpejtë rrugën për në Kostandinopojë. Në udhë e sipër, ai joshi me zotime të shumta – se me armë s'i pushtonte dot – disa popullsi të Kaonisë dhe vise të Skënderbeut, që quheshin Kidna, dhe i bëri që t'i binin në dorë e t'i merrte në besë, të cilën, siç e kish zakon, nuk e mbajti kurrë. Prej këtyre, tetë mijë burra, veç grave dhe fëmijëve, i shkoi tirani në thikë dhe derdhi në këtë mënyrë çnjerëzore gjak të pafajshëm, meqë nuk mundi të shfrynte dot egërsinë e vet kundër Skënderbeut"⁷).

Populli nuk kujtohet më për diçka të tillë. Por as Kënga e Jovan Nokës nuk flet për ngjarje si këto. Aty s'bëhet fjalë për ndonjë masakër e pabesi. Kënga dhe legjenda flasin për një qëndresë heroike të popullit të Çidhnës kundër sulltan Mehmetit e hordhive turke, që erdhën për të bërë zap vendin e për të ndëshkuar Jovan Nokën, por u thyen e ikën me turp. Lufta që gjëmëtare, - "plot me xhak u mushka Seta" - malet mbi Çidhën, Batafi e Xharxhishti, gjëmuan si deti; armiku mundi të depëronte thellë, porse prapë u thyu.

Në këngën e Jovan Nokës, edhe pse flitet

Teksti i kësaj kënge nuk është vepër e ndonjë njeriu të patalentuar, përkundrazi. Jo i zgjatur, ai qëndron më pranë këngëve të trimave dhe është i kursyer si teksti i këngëve legjendare të zonave të Dibrës e të Matit. Në këngë paraqiten shkurt të dy palë kundërshtarët që mbledhin “mexhelizin”: sulltani për të sulmuar me hordhitë e tij, Jovani për t’i bërë ballë në Çidhnën e rrethuar. Vargjet e fundit janë të një bukurie të vërtetë.

Kanga e Jovan Nokës

Tu ra dilli n’at shpat mali.
n’at Fush Ban na u baka nami ¹⁴⁾
Jovan Noka ni burr zakoni –
njer në Shehër ka vot haberi ¹⁵⁾
Jovan Noka s’jep asqeri;
s’jep asqeri, s’jep vergji,
kërkon mretit tok n’Shqipni, ¹⁶⁾
mushi Lugun e Shkalls me ushtri ¹⁷⁾
N’at Stamoll po knon masbata ¹⁸⁾
knon masbata ne fermani,
n’vesh i ka hi atij sulltani.
Sulltan Mehmeti n’kam u çue,
mexhelisit ni selam ka lshue:
- Traj ordi me m’i hazrue,
se për Dibër du me i çue,
se kjo Dibra m’ka tradhtue,
tok Shqipnin m’ka kërkue;
Jovan Nokën me dorzue,
me xhith cull e me xhit grue,
se për Jemen du me i çue,
pesmdhet vjet i robnue –
Traj ordit na jan hazrue
e për Dibër kan shkue
e ç’at Çidhnën e kan rrethekue.
Ene Çidhna po ban mexhlis:
- Çfar t’i bajm ksaj ushtris?
Jovan Noka ni burr i xhan.
Jovan Noka asht çuo në kam
Ene ksaj Çidhnës i ka ba selam:
- Cull e gra n’She t’That t’i shtajm ¹⁹⁾
e për traj vjet buk t’u çojm,
ksaj ushtrie pushkën t’ia fillojm. –
Krisi pushka e merr xham deti,
merr xham deti e u shemka kepi,
plot me xhak e mushka Seta.
Krisi pushka e merr xham deti,
merr xham deti ene Batafi ²⁰⁾
traj ordit Çidhna i pihati. ²¹⁾

për një sulltan Mehmet të hershëm, ky nuk është domosdo Mehmeti II, se nuk duket të flitet për ngjarjet e vitit 1466, po për ngjarje të tjera, që duhet të jenë më të vona. Vetë legjenda, siç e tregon Ali Krrashi, e vendos Jovan Nokën pas vdekjes së Skënderbeut. Që kujtimin e Jovan Nokës populli ta lidhi me një varr të ruajtur në Çidhnën, kjo ndoshta jep mundësi të përcaktohet edhe koha kur ai jetoi dhe hetimet arkeologjike mund të bëhen konkluduese. Po sot për sot duhet të kënaqemi me legjendën dhe me këngën.

Jovan Noka i përket një kohe kur vendi nuk ishte kthyer mysliman. Ali Krrashi besonte se kthimi i Çidhnës mysliman kishte ngjarë vonë, meqë, sipas tij, aty paska pasur të krishterë – katolikë e ortodoksë – gjer nga pjesa e dytë e shekullit të kaluar. Në të vërtetë, aty ka pasur edhe prozelitizëm të vonë, që kur, gjer në ditët tona, në zonën e Lurës gjendeshin familje, ku, nga dy vëllezër, njëri ishte mysliman e tjetri katolik. Po ky fenomen nuk ishte i zakonshëm në krahinën e Çidhnës, e cila përmbledh një numër të mirë fshatrash nga të dyja anët e Drinit 8). Myslimanizmi i kësaj krahine në masë duhet të ketë ngjarë aty nga pjesa e dytë e shek. XVII, si në tërë Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut, ku dominonte më parë katolicizmi. Gjer aty nga mesi i shek. XVII, Çidhna nuk na del e myslimanizuar 9).

Pikërisht atë shekull, në dekadat e para, llogaritet Ndoka – nga emri Andon – e hasim në dokumentet e njohura. Në dy akte pronësie, që ka formuar një famullitar mirditor i Vigut, Stefan Gazullori, më 1.IV.1615 dhe më 24.II.117, përmendin në Domën një Gegë Ndoka e pastaj një Pjetër Ndoka, të dy katolikë, me sa kuptohet 10). Llagapi Ndoka – sot Noka – nuk u përkiste, pra, domosdo ortodoksëve.

Emri i fisit Ndoka që mban sot fshati Gryknokë, i cili, në të vërtetë, është një si lagje e Çidhnës, ai emër mbahet edhe sot nga familje të ndryshme në ato dy fshatra. Duke e hasur që në shek. XVII, ishte e natyrshme të hetoheshin edhe dokumentet e kohës për një Jovan që të ishte pak a shumë i njohur. Dhe kështu, në Kuvendin e Matit, të shkurtit 1602, që u mbajt në fshatin Dukagjin, pranë Macukullit, e ku morën pjesë rreth dy mijë vetë nga një shumicë vendesh të Shqipërisë së Mesme e të Veriut, me parinë e tyre në krye, paria e Dibrës përfaqësohej nga 4 “pleq”, midis të cilëve një Zuane Xhidna. Citojmë dokumentin: “... e altri Capi Josef Castrioti, Rev(erend) o p(a) dre Lazaro Cossi, Martin Manessi, Zuane Chidna, vecchi capi principali della provincia di Dibra” 11). Sigurohemi kështu se një Joan Çidhna, në fillim të shek. XVII, ishte ndër krerët më kryesorë të Dibrës dhe merrte pjesë në lëvizjen kryengritëse

Fakti vetë, që, me sa dinte Ali Krrashi, gjatë tre çerekë shekulli këngën dhe legjendën mbi Jovan Nokën i mbante mend vetëm një njeri në Çidhnën, Haziz Daci, prej të cilit ai i mësoi fjalët, këto të çojnë të supozosh se kënga është e pakta një shekull më parë, meqë dhe Hazizi e kishte nga pleqtë. Fakti që teksti i saj nuk përcillet me ndonjë melodi, prej Ali Krrashit na u shpjegua kështu: në Çidhnën nuk e kanë pasur shumë zakon të këndojnë, por u binin kavallevë; Haziz Daci vetë nuk këndonte. Ai ka qenë një burrë i çmuar në Çidhnën për urti, po, me sa duket, njeri përgjithësisht i mbyllur në vetvete.

shqiptare për t’u çliruar nga Turqia 12). Dhe kemi arsye që Joan Çidhnën e vitit 1602, të paktën gjersa nuk kemi dokumente të tjera, ta marrim për Jovan Nokën, të cilit i ruhet legjenda dhe kënga në Çidhnën, ku i ruhet edhe varri.

Janë të njohura kryengritjet e mëdha shqiptare të shek. XVI-XVII, që vunë në lëvizje mbarë vendin. Ato erdhën sidomos pas betejës së Lepantos (1571), ku flota turke u shkatërrua prej spanjollëve, dhe vazhduan të ashpra përreth tre çerekë shekulli, me përpjekje të njëpasnjëshme për organizimin e gjithë vendit dhe për bashkëpunim edhe me fqinjët, me kërkesa të vazhdueshme ndaj fuqive të mëdha të kohës, si Vatikani, Spanja e Venediku që në të vërtetë ose nuk i ndihmuan, ose i tradhtuan. Joan Çidhna i përket kohës kur Nikollë Mjekashi dhe Pjetër Budi ishin vënë edhe ata në krye të qëndresës shqiptare dhe të përpjekjeve për çlirim ¹³⁾.

Mos legjenda dhe kënga mbi Jovan Nokën kujton ngjarje të shek. XVI-XVII? Sot për sot, kjo do pranuar. Ngjarjet për të cilat flitet legjenda dhe kënga, i përkasin luftës kundër një ekspedite turke, e cila u thyje në malësitë e Çidhnës, pasi vendi u la në gjak. Trimëri dhe fitore të tilla kalojnë zakonisht në gojëdhënë, pastaj koha bën të sajën, ato vjen një ditë që vihen edhe në këngë, në mos janë vënë qëkur, ose dhe harrohen. Ngjarjet e reja i bëjnë njerëzit të kujtojnë të vjetrat dhe t’u ngrenë këngën këtyre dhe atyre bashkë, ndonjëherë edhe duke përzier kohët, personazhet e ngjarjet vetë.

Po sulltan Mehmeti ç’kërkon atëherë në Këngën e Jovan Nokës, që do t’u përkiste ngjarjeve të shek. XVI-XVII? Në vitet 1595-1602 ka jetuar sulltan Mehmeti III. Por edhe në qoftë fjala për të dytin, kujtesa popullore e Çidhnës e ka pasur të pamundur të harrojë atë që pati shfarosur vendin në kohën e Skënderbeut dhe ia ka lidhur emrin edhe me ngjarje më të këtejme, të kohës së kryengritjeve të mëdha shqiptare të shek. XVI-XVII, kur jetoi Mehmeti III, kur u dallua edhe një prej krerëve të vendit, Joan Çidhna – Jovan Noka – i cili i priu popullit e i theu turqit. Sidoqoftë, një sulltan me emrin Mehmet është lidhur me të dy palë ngjarjet.

Këto janë konkluzionet tona për Këngën e Jovan Nokës, posa nuk kemi të dhëna dhe dokumente të tjera. Është një këngë e rrallë historike e Çidhnës, që ka qenë mbajtur mend, si tekst, gjer tani së voni dhe që ka filluar edhe të këndohet në një fshat aty pranë, në Selishtë. Kënga flet për ngjarje të kohës së Mehmetit III, porse duhet të jetë krijuar pas shek. XVII dhe, me sa duket, shumë më këtej, ndoshta në kohën e përlëshjeve të reja dhe të mëdha me turqit, si qenë ato të mesit të shek. XIX rreth Tanzimatit. Ndonjë këngëtar i zoti i atyre viteve kujtoi të kaluarën dhe i vuri në vargje bëmat e Çidhnës së drejtuar nga një Jovan Nokë i shek. XVI-XVII, që s’ishte harruar dhe të cilit i ruhej e i nderohej varri në vend. Që Haziz Daci të mos e përcillte më tekstin me ndonjë melodi, kjo tregon se ai vetë nuk këndonte dhe një tekst, që nuk përcillet me melodi, e ka shumë vështirë, në mos të pamundur, të përhapet. Ka mundësi, dhe kështu duhet të ketë ngjarë, që kënga të mos ketë arritur të këndohet e të përhapet shumë në Çidhnën, pra, dhe u harrua shpejt. Po ka mundësi që ajo të jetë krijuar prej ndonjë personi si Haziz Daci, që nuk e kishte zakon të këndonte fort, në mos e krijoi Hazizi vetë, teze që duhet pasur gjithashtu parasysht dhe që këngën na e bën edhe më të re. Hazizi, njeri i zgjuar dhe që njihete legjendën, krijoi kështu edhe një tekst të vjershëruar dhe këtë ia mësoi Ali Krrashit e pak të tjerëve, që të mbahej mend edhe më mirë kështu legjenda mbi Jovan Nokën, që ai kishte dëgjuar nga pleqtë. Po jemi të detyruar t’i besojmë Aliut, i cili, për këngën, na tha se Haziz Daci e kishte mësuar nga “pleqtë e vjetër”. Kërkime të tjera duhen bërë.

Teksti i kësaj kënge nuk është vepër e ndonjë njeriu të patalentuar, përkundrazi. Jo i zgjatur, ai qëndron më pranë këngëve të trimave dhe është i kursyer si teksti i këngëve legjendare të zonave të Dibrës e të Matit. Në këngë paraqiten shkurt të dy palë kundërshtarët që mbledhin “mexhelizin”: sulltani për të sulmuar me hordhitë e tij, Jovani për t’i bërë ballë në Çidhnën e rrethuar. Vargjet e fundit janë të një bukurie të vërtetë.

Le ta japim këngën ashtu si e mblodhëm, në të dyja variantet e mblledhura më 1969, të dytën në shënimet.

1976

(Marrë nga libri “Mbi Barletin dhe shkrime të tjera”, SHB “Naim Frashëri”, Tiranë, 1979.)

REFERENCAT

1. E mblodhi dhe e botoi me një koment H. Sadiku.
2. V. Shkrimin tonë: *Këngë popullore mbi Skënderbeun* (“Literatura jonë”, Tiranë 1949, nr. 5), ku ribotohen këngët e fragmentet e këngëve mbi heroin, që ishin mblodhur gjer atëherë në Shqipëri.
3. V. edhe: *Tregime dhe këngë popullore për Skënderbeun*, Tiranë 1967, f. 65: “N’Xhitet, nërmjet Arrase dhe Çidhnës Poshtër asht Vorri i Jovanit. (Jovani nuk dihet se ç’ka qanë)”. Dëshmi e mblodhur në Sinjë më 1953 dhe që tregon se legjenda e Jovan Nokës njihej pak e aspak.
4. Po japim tekstualisht çka na tregoi Ali Krrashi mbi legjendën dhe këngën e Jovan Nokës, mbi Haziz Dacin etj. “Këtë kangë e kam ngjue herët vakt prej ni burri t’vjetër, po ai s’e knonte, Haziz Daci nga Çidhna. Ka vdek at vit ç’ka hi Italja, ma tepër se niqin vjeç. Ky nuk e knote, po e thoshte me fjal, e diftote. Kshtu ma ka than. E kishte msue nga pleq e vjetër, nuk di prej kush. Hazizi nuk e kish zakon të knote. Ktu koshin pak; kavallve u kan pas ra. Për Jovan Nokën thoshte se ishte luftarak i fort. Jovani e kundërshtoi Turqin, po fuqin e kishte të paktë. Po ktij iu mblodh Çidhna. Burr i ashpër. Shtat shpaj ktu në Çidhnën e shtat shpaj në Gryknokë. Jovani ishte gryknokës. At’her n’at koh ishin të përzie katolik e ortodoks, von jan kthee mysliman. Na njer më 1912 i kemi pas qishat në katun. Qisha ishte e paprishme, po të kërshten un s’maj men. Baba jem i mate men të kërshtenët në Çidhnën e në Gryknok. Nuk di sa breza ka jetu Jovan Noka. Po, masi vdiq Skënderbeu, u maru ki ktu. Ishte në koh të sulltan Mehmetit të hershëm e jo në koh të sulltan Mehmetit të Hyrjetit. Nokajt nuk majn men gja për Jovanin. Vorri i Jovanit qi asht në Çidhnën asht vorri i Jovan Nokës. Jovani u vra në luftë me Turqin. Ke vorri i Jovanit ka dhe 2-3 vorre të tjera. Ene qisha ka qen aty. I thoshin Qisha e Jovanit. Baba tregon se dera ishte prej hekri e, kur mshilte njeri derën, dëgjohej atje n’maj malit në Xharxhisht. At qish unë s’e maj men, po veç me mure, po pa çati. Ishte ma e vogël se kjo od (oda, rreth 6x6 m. – Dh. Sh.). I ka ra hadja për mjedis. Noka ishte ortodoks ene shqip fliste. Populli linte nga ni shej, nga ni pe, te vorri i Jovanit. Haziz Dacin ktu në venin ton e qukshin të zgjut, si të meçëm, se folte rrafsh. Nuk ishte pari veni. Nuk di a ishte i gjezdis. Ktu, n;katunin ton, pa folun ai s’merrej asni venim, po ishte si zor ta bajsh me fol, se s’folte. E kam njoft mir. E mësova kangën prej tij, duke ngjue kur ia thoshte pleqe tjerë. “Allaalla, bre Haziz – i thoshin, - ç’ma men!” Vet Hazizi nuk e kishte njofto Jovanin. Historinë e Jovanit vetëm Hazizi e dëftonte në katun. Tani e kënon kangën Tefik Manuka në Selisht. Fisi i Nokajve ka qenë “plak”, qi “dante gjyqin”.
5. V.Sh. 21, variantin e dytë të këngës, vargun: “Telifoni n’at Stamoll ka hi”, varg që Ali Krrashi nuk na e tha, kur na e recitoi këngën një natë më parë. Kjo qe ndoshta një shtesë që ai bëri aty për aty të nesërmen, kur na e recitoi për së dyti herë këngën.
6. *Tregime dhe këngë pop. për Sk.*, f. 97: “Skënderbegu ka luftue me Turkinë në Çidhnën”. Dëshmi e mblodhur në Fushë-Muhur të Peshkopisë më 1953. V. dhe më poshtë, po në atë faqe. V. dhe f. 59-64.
7. M. Barleti, *Historia e Skënderbeut*, përkth. S. Prifti, Tiranë 1964, f. 469.
8. Sipas Ali Krrashit, Çidhna, si krahinë, përshinte fshatrat: Gryknokë, Mustafa, Fushali, Çidhnë, Bllaç, Rrenxë, Laçe, Kastriot, Arras, Sinë, Kishavec, Kodër, Brest i Poshtër, - “1900 shtëpi”.
9. I. Zamputi, *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shek. XVII*, Tiranë 1965, vëll. II, f. 249, 335, 379 (flitet për malet e Lurës, Çidhnës etj., ku ka popullsi shumë dhe që janë shumë të rrebtë, - 1649), 395.
10. *Studime e tekste*, Tiranë 1944, f. 383, 388.
11. *Studi Albanesi*, Roma 1933-34, f. 22. H. Sadiku dinte për dokumentin. Po kështu dhe mësuesi Mynir Shehu në Burrel.
12. Për këto kryengritje, v. *Historia e Shqipërisë* e USHT, Tiranë 1959, vëll. I, f. 351-71.
13. V. po aty.
14. Vend në Çidhnën e Poshtër.
15. Shehër – qyteti i Dibrës.
16. Në variantin e botuar te “Mësuesi” vargu është: “I kërkon mretit Shqipni”, gjë që u përgjigjet kërkesave të kryengritjeve të shek. XVI-XVII për çlirimin e vendit. Fjala Shqipëri është e re në këngët. Në variantin tonë të dytë, ka dy vargje të tilla: “çish t’ia bajm ksaj ushtris./ ç’ka shkel tokn e Shqipnis”. Të gjitha këto janë elemente që e afrojnë këngën me Rilindjen Kombëtare, pra që duhet të kenë hyrë vonë, ose që të bëjnë të mendosh se mos kënga vetë u krijua gjatë Rilindjes e këtej.
17. Vend në Çidhnën.
18. Urdhri.
19. Vend i thellë në Çidhnën, ku gjendet edhe një kështjellë e fshehtë e Skënderbeut.
20. Vend pyll e i ashpër në katundin Bihaç, pranë Sheut të Thatë.
21. I dërrmoi. Me “ordi” kuptohet një formacion i madh ushtarak prej disa mijëra vetësh. Po japim variantin e dytë të Këngës së Jovan Nokës, mblodhur më 24.X.1969; i pari u mblodh më 23.X. “Tu ra dilli shpatit t’malit./ - Jovan Noka ni burr zakoni, -/ n’at Fush Ban na u baka nami./ Der në Shehër na vot haberi./ se Jovan Noka s’ep asqer e s’ep vergji./ i kërkon mretit tok n’Shqipni, n’at Shkallmaxh ka shte fuçi./ Telifoni n’at Stamoll ka hi./ Knon masbata dhe fermani, n’vesh i ka hi atij sulltani./ Sulltan Mehmeti n’kam asht çue, mexhelisit ni selam u ka lshue./ - Traj ordi me m’i hazrue, / se për Dibër du me i lshue, / se kjo Dibra m’ka tradhtue, / tok n’Shqipni m’ka kërkue./ Jovan Nokën me ma dorzue/ me xhith cull e me xhith grue, / për Jemen du me i robnue. - / Traj ordit për Dibër paskan shkue/ e kët Çidhnën kan rrethekue/ edhe kjo Çidhna po ban mexhelis: / Çish t’i bajm ksaj ushtris, / ç’ka shkel tokn e Shqipnis? - / Jovan Noka ni burr i xhan./ Jovan Noka u çue n’kam/ e ksaj Çidhnës i ban selam: / - Cull e gra n’She t’Thatë t’i shtajm, / për tre vjet buk t’u çojm, / ksaj ushtrie pushkën t’ia fillojm. - / Krisi pushka e merr xham deti, / merr xham deti e u shemka kepi, / plot me xhak na u mushka Seta. / Krisi pushka e merr xham deti, / merr xham deti edhe Batafi, / traj ordi n’Çidhnën pihati”. Më 1976, Ali Krrashi e vijoi këngën, duke i shtuar një tjetër që s’na e kishte thënë më 1969. Ajo flet për Austrinë, i përket fundit të shek. XIX ose fillimit të shek. XX, po s’ka gjë të përbashkët me të parën. Edhe atë, Aliu e kishte nga Haziz Daci dhe të dyja këngët, që i kishte mësuar bashkë, nuk duket t’i lidhte veçse rastësisht. Kënga ishte shumë e dobët dhe jo prej të njëjtit mjeshër që krijoi të parën. Më 1969, këngën e mblodhëm edhe nga Tefik Manuka në Selishtë; ai e këndonte i shoqëruar vetë me fizarmonikë dhe pretendonte se e kishte mësuar nga shtypit, po në të vërtetë e përziente në fund me këngën e dytë, po aq në mënyrë të palidhur. Përdorte një melodi të vendit.

Bisedë me Eva Zaimin, themeluesen e fondacionit Down Syndrome Albania.

sociale

“Edhe unë kam një ëndërr”

Bisedoi: SASHENKA NDREKA

- Një kormozom më shumë në ngjizjen e djalit dhe jeta ndryshoi katërcipërisht. Si është tani një ditë e zakonshme e juaja?

EVA ZAIMI: Jeta ime me ardhjen e Arbit, si fillim, ndryshoi si për çdo femër që bëhet nënë. Parë në një këndvështrim më të gjerë, është e vërtetë që jeta më ka ndryshuar shumë. Këtë e ndjej më tepër në karrierën time, tani që ka marrë një drejtim komplet tjetër nga ç'kisha planifikuar. Por, besomë është vërtetë një karrierë e bukur, gjithësesi. Në fakt, nuk e kisha menduar që do të jem drejtuese (CEO) në të 30-tat e mia. Falë Arbit sot jam :).

Ndërsa në një pamje më të ngushtë, pra në jetën e përditshme, jeta ime është si e çdo nëne tjetër me dy fëmijë dhe një punë që kërkon angazhim të përditshëm. Ndryshimi i vetëm është që nëse një prind e çon fëmijën disa herë në javë në ndonjë kurs, ne e çojmë Arbin disa herë në javë në Qendrën e Arritjeve dhe Zhvillimit të Fondacionit që drejtojmë, Down Syndrome Albania, ku ai merr mbështetjen e nevojshme për të zhvilluar kapacitetin e tij maksimal. Shumëkush mendon që unë e kam ditën shumë ndryshe, por në fakt e kam si çdo kush.

- Ju jeni themeluese e Fondacionit Down Syndrome Albania. Çfarë eksperiencë që ju ka mbetur në mendje gjatë punës suaj do të ndani me lexuesit e gazetës sonë?

EVA ZAIMI: Fillimet janë ato që më kujtohen shpesh. Koncerti madhështor i Saimir Pirgut, që u bë “tulla” e themeleve të DSA, interesi i medias për kauzën, gatishmëria e çdo kujt për tu bashkuar në ndihmë të kauzës dhe padyshim dita e parë kur në qendër nisëm të ofronim shërbimet tona, dita kur ëndrra ime u bë realitet.

- Së fundmi keni postuar një foto në Facebook, të Irmës, vajzës së vogël bulqizake, e cila shiti një nga pikurat e saj të para, duke u bërë kështu ndihmësja juaj në ngritjen e buxhetit të DSA. Po donatorët a janë të lehtë të afrohen? A është shoqëria shqiptare e sensibilizuar në çështje kaq delikate?

EVA ZAIMI: Irma është një frymëzim për ne, nënat në DSA. Ajo është një vajzë “shembull”, si për familjen e saj, si për komunitetin tonë. Prindërit e Irmës kanë bërë një punë fantastike me të. Sigurisht, unë jam shumë më tepër krenare duke qenë se dhe unë i them vetes bulqizake, dibrane dhe pse kjo, është origjina ime nga mama, me saktë zerqanase :). Irma ka shumë premisa për të qenë një vetëadvokuese e kauzës së personave me sindromën Down në Shqipëri, dhe ne po mundohemi të krijojmë të gjitha mundësitë që ajo të bëhet e tillë. Pikërisht për këtë arsye, Irma në gusht do të marrë pjesë në Kongresin Botëror të Sindromës Down, organizuar nga Down Syndrome International, i cili këtë vit mbahet në Chennai të Indisë. Mezi presim të percjellim Irmën në aeroport dhe më pas ta presim për të na rrëfyer eksperiencën e saj. Në një program 5 ditor Irma do të trajnohet dhe orientohet për “self advocacy” (vetëadvokuese).

Donatorët nuk janë kurrë të lehtë, por ne kemi bërë një punë të mirë me DSA. Jemi treguar gjithnjë korrekt dhe transparentë dhe kemi ditur t'i falënderojmë publikisht për kontributin e tyre. Unë jam diplomuar në marrëdhëniet me publikun dhe reklamën, dhe para DSA kam pasur një eksperiencë prej vitesh në fushën e komunikimit. Ky fakt më ka ndihmuar shumë në lidhje me sigurimin e fondeve dhe në marrëdhëniet me donatorët. Përsa i përket sensibilizimit të shoqërisë, mendoj që si DSA kemi bërë shumë për kaq pak kohë, por duhet vazhduar ende, deri sa çdo kush të kuptojë, qoftë nevojat, qoftë dhe të drejtat e personave me sindromën Down, për të pasur një jetë si çdo anëtar tjetër i shoqërisë tone.

- Rreth 90% e njerëzve e quajnë Sindromën Down sëmundje dhe kanë shumë pak informacion për të. Shumica e çifteve që e mësojnë gjatë shtatëzënisë se fëmija i tyre zotëron një

Dyqani i luleve DSA, një nga projektet fituese që do të ndihmojë në të ardhmen fondacionin në ndihmë të fëmijëve që vuajnë nga Sindromi Down.

Bulqiza mund të bëjë jo vetëm veten e vet Zvicër, por të gjithë Shqipërinë. Herën e fundit që isha pata mundësinë të shëtis mbi një makine me rimorkio liqenet e Dhoksit. Kam qarë si fëmijë, kur kam parë ç'masakër ishte bërë me prerjen e pemëve. Është shumë e trishtë të përballësh me atë pamje, kur për shumë vite ke ruajtur në kujtimet e tua “një parajsë”. Me trishton po ashtu fshati im, Zerqani. S'ka më atje rini. Kërkoj me sy shokët e shoqet e fëmijërisë, kushërinjtë... pres që në ato oborre të atyre shtëpive të shoh fëmijët e tyre, por në fakt aty s'ka më zhurme, siç bënim ne njëherë e një kohë. Janë të gjithë në emigrim...

kromozom më tepër, vendosin të abortojnë. Pse është kaq e keqinformuar shoqëria shqiptare?

EVA ZAIMI: Nuk jam e sigurtë për përqindjet që jep ti, por është e vërtetë që shumëkush, përfshirë dhe mjekë, shpeshherë sindromën e quajnë sëmundje. Keqinformimi mendoj se vjen nga fakti që në vendin tonë, për shumë kohe, personat me aftësi të kufizuar intelektuale, janë parë si persona që kanë nevojë për një përkujdesje shëndetësore dhe si “të paafët” për të pasur aftësi. Nga ana tjetër, mungesa e shërbimeve të nevojshme të siguruar nga shteti për zhvillimin e kapacitetit të tyre maksimal, mungesë kjo dhe tani që flasim në vendin tonë, ka bërë që të mos përjetohej, të mos dëshmohej, aftësitë e shumta të personave me nevojë të veçanta për të jetuar një jetë të pavarur dhe gjithëpërfshirëse. Heshtja dhe mos vëmendja paskësh qenë shumë e madhe. Unë e kam ndjerë këtë që në momentin kur dola dhe tregova historinë time. Media ishte e etur për të ditur më shumë, sepse kishte munguar ky informacion, ky ndërjegjësim për personat me sindromën Down. Sa i përket shifrave të abortit, kjo është një çështje shumë e kompleksë, e cila nuk lidhet vetëm me mungesën e informacionit, por dhe me karakterin dhe besimin e atyre prindërve që vendosin të abortojnë. Unë mendoj që prindërit që abortojnë, as nuk marrin mundimin të informohen, bëjnë një zgjedhje “të thjeshtë”, dhe për mendimin tim, një zgjedhje të gabuar, pa dashur t'i paragjykojmë. Ndoshta dhe unë do të kisha bërë një zgjedhje të gabuar, por jam e lumtur që pata fat të mos ta dija që Arbi kishte sindromën Down në shtatëzani. Sigurisht, që vendi ynë nuk është një vend që të ofron kushtet ideale për të mirërritur një fëmijë me nevojë të veçanta, por mjafton një përkushtim dhe dashuri prindërore për të bërë gjithçka të mundur. Irma, p.sh., nuk ka marrë kurrë terapi. Prindërit e Irmës, kur ka lindur Irma, s'kanë pasur informacionin që kemi ne, nënat e reja sot, por përsëri Irma është një shembull për të gjithë ne, sepse mbi të gjitha, ajo është trajtuar si çdo fëmijë tjetër në familje, me dashurinë dhe përkushtimin e duhur. Të paktën, për rritjen e fëmijëve me sindromën Down, ky është çelësi, trajtim i barabartë si çdo anëtar tjetër i familjes, por duke respektuar nevojat e veçanta dhe duke i pranuar ato.

- A keni menduar ta zgjeroni organizatën tuaj edhe në rrethet tjera të Shqipërisë, duke qenë se jo çdo kush ka mundësi ta sjellë fëmijën deri në Tiranë?

EVA ZAIMI: Organizata jonë është kombëtare, pra ne si Fondacioni punën e bëjmë për të gjithë Shqipërinë. Ne llobojmë për çdo individ me SD në territorin e Shqipërisë. Besoj, ju e keni fjalën për qendrën tonë të shërbimeve. Po, do të ishte shumë mirë që shumë fëmijë dhe prindër që na vijjnë nga rrethet të mund

t'i merrnin këto shërbime në qytetin, fshatin ku banojnë, por ne si DSA këtë e kemi të pamundur për momentin. Të ofrosh shërbime për fëmijët me nevojë të veçanta është një kosto shumë e madhe, sidomos kur këto shërbime i ofron pa pagese, siç i ofrojmë ne aktualisht. Këto shërbime duhet të ofrohen nga vetë shteti, ose ai duhet të mbështesë financiarisht organizatat si e jona. Aktualisht qeveria po punon për reformën e shërbimeve sociale. Pritet që në zbatim të kësaj reforme, rimbursimi i shërbimeve si këto që ofrojmë ne të bëhet nga shteti. Nëse kjo do të ndodhë, patjetër që do të mendojmë për çeljen e qendrave në disa qytete të tjera ku ka numër të konsiderueshëm të fëmijëve me sindromën Down, siç janë Elbasani, Durrësi dhe Shkodra.

- Kohët e fundit në të gjitha daljet tuaja publike, vëmendja është drejtuar nga Arbi, duke eklipsuar paksa figurën tuaj. Le të kthehemi pak tek Emanuela. Nisur nga fëmijëria e sotme, si do ta përkufizoni fëmijërinë tuaj? Çfarë mbani mend nga Bulqiza?

EVA ZAIMI: Po sigurisht, Arbi është VIP-i :). Fëmijëria ime besoj ka qenë një fëmijëri e lumtur, të paktën unë kështu e kujtoj. Me ka rritur gjyshja në Bulqizë, deri kur unë u bëra 13 vjeç kemi banuar me të aty, me pas jemi shpërngulur në Laç, ku unë kisha prindërit. Mbjaj mend çdo gjë, që nga lojërat në oborr, pastrimin e tij të dielën me të gjithë komshinjtë. Dyert gjithnjë të hapura të komshinjeve, rehatinë nën shoqërinë e njëri-tjetrit dhe sa të gjindëshëm ishin. Mbjaj mend plakat nga fshatrat përreth që shisnin poshtë ballkonit tim mana, fiq, kumbulla jeshile, domate, etj. Mbjaj mend dimrin e ftohtë, ujin që të mpinte dhembët, një mini liqen pas shkollës ku rreshkisnim pa frikë fare se akulli mund të thyhej. Mbjaj mend arratisjet në liqenet e Dhoksit me shokët e shoqet, ndërkohë që gjithë Bulqiza na kërkonte :). Mbjaj mend mësuën e historisë që dhe sot kur e kujtoj dridhem, bilardon pas shkollës që e përdornim për festa dhe mësuën na etiketonin si “prototipat” e shkollës. Mbjaj mend kur u ndërtua xhamia dhe se si u bëmë për pak kohë besimtarë të devotshëm. Më me mall kujtoj verën, kur unë nisja turin e pushimeve në fshatrat e Fushë Bulqizës dhe në Zerqan. Mbjaj mend se si nuk kisha një vend të caktuar, por çdo javë flija në një shtrep, ku më e preferuara ishte ajo e kushëririt që kishte 12 fëmijë. Mbjaj mend dhe kujtoj me shumë mall ngjitjet në qershi, në manin e zi, në pemën e arrës së pabërë, që do mi bënte duart e zeza e do rrinin ashtu deri në shtator. Mbjaj mend të shkuarën me lopë, kthimin përgjatë rrugës me këmbë në vijën e ujit. Mbjaj mend se si mundohesha dhe unë të punoja me bel tokën, por përfundoja me qepje në këmbë :). Mbjaj mend shume gjëra, për të cilat shpesh qaj nga malli. Do të doja shumë që fëmijët e mi të jetojnë një fëmijëri si e imja, por kemi një problem të madh, s'kanë ku të rrinë



në fshat. Besomë, që po të gjej dikë që mi mban tre muaj, siç më mbanin dhe mua njëherë e një kohë, i çoj atje për gjithë verën :)

- A ktheheni shpesh? Po Arbi dhe Dea a e kanë vizituar Dibrën?

EVA ZAIMI: Fatkeqësisht nuk kthehem shpesh, kjo për faktin se kur kthehem me kap trishtimi...të gjithë ata me të cilët kam kujtime nuk janë më atje. Me i trishtueshëm është fakti që dhe pse ai qytet aq i pasur, zhvatet përditë dhe i lë fëmijët pa prindër dhe pa bukë. Jam tmerrësisht e irrituar me faktin se si menaxhohen minierat e Bulqizës, dhe në duart e kujt kanë rënë. Bulqiza mund të bëjë jo vetëm veten e vet Zvicër, por të gjithë Shqipërinë. Herën e fundit që isha pata mundësinë të shëtis mbi një makine me rimorkio liqenet e Dhoksit. Kam qarë si fëmijë, kur kam parë ç'masakër ishte bërë me prerjen e pemëve. Kam mallkuar me plot gojë! Është shumë e trishtë të përballësh me atë pamje, kur për shumë vite ke ruajtur në kujtimet e tua “një parajsë”. E bëra atë shëtitje për t'i treguar liqenet e bukura bashkëshortit tim që e vizitonte për herë të parë vendlindjen time, dhe u ndjeva gënjeshtarë, kur ai nuk pa ato bukuri për të cilat unë i kisha treguar. Me trishton po ashtu fshati im, Zerqani. S'ka më atje rini. Kërkoj me sy shokët e shoqet e fëmijërisë, kushërinjtë... pres që në ato oborre të atyre shtëpive të shoh fëmijët e tyre, por në fakt aty s'ka më zhurme, siç bënim ne njëherë e një kohë. Janë të gjithë në emigrim... Thonë që në Gusht kthehen ndaj këtë herë kam vendosur ta vizitoj në Gusht dhe bashke me mua do të jetë dhe Arbi dhe Dea për herë të parë në vendlindjen e mamit. Unë kam shumë emocion që do t'i shkel ato rrugë me ta, që ata do të ecin mbi guralecat e fshatit të fëmijërisë time.

Cilat janë planet afatshkurtra që do t'i ndanit me lexuesin?

EVA ZAIMI: Më i rëndësishëm është plani që Fondacioni Down Syndrome Albania ka, që deri në fund të vitit të ketë çelur biznesin e tij social “Dyqani i luleve DSA”. Unë jam një prej fitueseve të projektit të kryeministrit “Edhe unë kam një ëndërr”, dhe falë financimit që pritet nëpërmjet këtij projekti, do të kemi këtë dyqan, i cili do të punësojë dhe të rinj me sindromën Down, por dhe do të ndihmojë në qëndrueshmërinë financiare të organizatës tonë, pasi të gjithë të ardhurat nga ky biznes do të përdoren për ofrimin e shërbimeve terapeutike për fëmijët e qendrës tonë. Ky është një projekt me shumë rëndësi për ne. Ju ftoj që për më shumë të na ndiqni në faqen tonë në Facebook, Down Syndrome Albania.

Për më shumë ose për të dhënë kontributin tuaj, mund të vizitoni faqen në FB në linkun e mëposhtëm: <https://www.facebook.com/DownSyndromeAlbania?fref=ts>

kulturë

“Testamenti i Pylltarit”, libri më i ri i Selman Mëziut

Selman Mëziu prezantoi më 17 gusht në mjediset e Akademisë së Shkencave librin e tij të dytë brenda dy vitesh me temën e pyjeve dhe mbrojtjes së tyre.

Mëziu prej më shumë se një viti ka inicuar një peticion online që u drejtohet krerëve të shtetit shqiptar për të tërhequr vëmendjen e tyre në lidhje me masakrën që po vazhdon mbi pyjet shqiptare. Disa nga këto shkrime, peticione, kërkesa, analiza e komente janë të përfshira në këtë botim, i cili u vlerësua nga miqtë dhe kolegët e tij.

“Testamenti i Pylltarit” është një vepër publicistike e shkencore që trajton me kurajo e përgjegjësi qytetare problemet që lidhen me gjendjen katastrofale të pyjeve sot. Si vazhdim i librit të prezantuar një vit më parë, “Revolucioni i gjelbër”, “Testamenti i pylltarit” bën apel për një mobilizim mbarëshoqëror për t’i nxjerrë pyjet shqiptare nga lëngata në të cilën ato gjenden.

Moderimin e kësaj veprimtarie e organizoi gazetari Defrim Methasani, ndërsa për librin folën Ing. Abdulla Diku në emër të Shoqatës së Specialistëve të Pyjeve dhe ing. Kleanthi Mandi në emër të shoqatës mjedisore “Çajupi”. Ing.



Munir Hoxha - ish drejtor i Shërbimit Pyjor Dibër e vlerësoi autorin Mëziu për produktivitetin dhe cilësinë e punimeve shkencore, por dhe gjendjen e rëndë të mjedisit e pyjeve në vendin tonë.

Në këtë optikë folën edhe Prof. Mihallaq Kotro, poeti e shkrimtari Mevlud Buci, studiuesit Faik Xhani e Ali Hoxha dhe gazetaria Eglantina Alia etj. Më të këndshme e bëri këtë takim prezantues interpretimi i monologut “Tri dëshirat e pyllit” nga fëmijët e autorit, Mikele e Alesi Mëziu.

E veçanta e këtij promovimi ishte, jo vetëm evidentimi i mendimit shkencor të Dr. Selman Mëziut, publicistika dhe krijimtaria e tij letrare, por dhe i vendlindjes së tij, Muhurrit.

Për lexuesin po sjellim parathënien e librit shkruar nga Prof. Dr. Vezir Muharremi, ndërsa librin mund ta gjeni në disa nga libraritë kryesore në Tiranë dhe Peshkopë.

“Testamenti i Pylltarit”, një libër me vlera njohëse, edukative e ndërgjegjësuese

Nga Prof. Dr. VEZIR MUHARREMAJ

Titulli i librit “Testamenti i Pylltarit” i Dr. Selman Mëziu mund të ngjallë kërshëri por edhe një farë stepje para një fundi të paparashikuar. Në fakt, është “Testament” jo në kuptimin e një veprë që është ndër krijimtaritë e fundit, por si krijim i një veprimtari shoqëror aktiv si Dr. Mëziu, ku analizon dhe pasqyron pikëpamjet e tij dhe të kolegëve për fushën e pyjeve, që me siguri do të pasohet edhe nga kontribute të tjera të vlefshme në të ardhmen nga autori.

Testamenti zakonisht është i paqtë, por ky i Selmanit zien nga dëshpërimi për gjendjen e rëndë ku i kanë katandisur pyjet e njëkohësisht bën thirrje për të dalë në mbrojtje të kësaj pasurie dhe jep shpresa se me përvojën që kemi dhe me forca të bashkuara mund të arrijmë të frenojmë valën shkatërruese dhe të punojmë për ruajtjen, shtimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të pyjeve shqiptare.

Ndërkaq, për nga përmbajtja, libri fare mirë mund të titullohej edhe “Klithmë për shpëtimin e pyjeve të Shqipërisë”. Ky libër vjen vetëm një vit pas dhe mund të themi se është vazhdim i “Revolucionit të gjelbër” të këtij autori. Të dy librat janë pamflete të fuqishme që i thërrasin ndërgjegjes së pylltarëve, pushtetarëve, gazetarëve dhe gjithë publikut të kuptojnë rëndësinë dhe funksionet e pasurisë së paçmuar – pyjeve – vlerat ekonomike, ekologjike, mjedisore e shoqërore, të kuptojnë dëmet e pallogaritshme që i kanosen vendit dhe shoqërisë shqiptare nga shkatërrimi i kësaj pasurie që po vazhdon prej vitesh dhe të shpëtojmë atë çka mbetur për brezat e sotëm dhe ata të ardhshëm.

Në “Testament”, si dhe në librin paraardhës, Selmani ka mishëruar përvojën e tij shkencore e praktike të disa studimeve që ka kryer për pyjet, për prerjet kulturore, vëzhgimin ekologjik të pyjeve të pambërritshëm dhe parqeve të rinj në Shqipëri, për hartimin e planeve të mbarështrimit të disa ekonomive pyjore, si specialist në Shtabin Qendror të Inventarizimit Kombëtar të Pyjeve etj.; përvojën e marrë gjatë disa specializimeve jashtë shtetit; përvojën në botimet e mëparshme, si dhe të dhënat e literaturës në fushën e pyjeve.

Meritë e autorit është nxitja dhe përfshirja në debat, si dhe pasqyrimi në tekst i opinioneve profesionale të mjaft specialistëve të pyjeve, por edhe të fushave të tjera, të cilët preokupohen për fatin e pyjeve dhe të vetë shoqërisë dhe dialogojnë sidomos nëpërmjet rrjetit social të Facebook. Me tã, autori diskuton dhe polemizon për gjendjen e pyjeve, mbledh të dhëna e fakte konkrete, i dokumenton me shifra e fotografi, denoncon me forcë shkatërrimin e



pyjeve dhe të strukturave të shërbimit pyjor nga pushtetarët dhe specialistët e papërgjegjshëm, shkeljet ligjore, korrupsionin, padrejtësitë, vlerën kontributin dhe përpjekjet e kolegëve pylltarë e gëzohet për arritjet e tyre, si dhe propozon masa konkrete për përmirësimet e mundshme, ndonëse shpesh me forcë dhe me terma të ashpër.

Në libër, autori gërsheton aspekte nga më të ndryshmet, ato shkencore dhe teknike, përvojën e vendit dhe atë të huaj, mangësitë dhe arritjet e sektorit gjatë viteve. Hera herës mediton, shprehet me pathos dhe ndjenja lirike për pyllin e natyrën shqiptare. Mbi të gjitha, mbizotëron protesta ndaj shkatërrimit të pyjeve dhe thirrja për mbrojtjen dhe zhvillimin e këtij sektori, duke vënë në vendin e vet specialistët dhe rolin e pazëvendësueshëm të pyjeve.

Libri “Testamenti i Pylltarit” i Dr. Selman Mëziu ka vlera njohëse e përshkruese, edukative e ndërgjegjësuese dhe u shërben një mase të madhe lexonjësisë, specialistëve, pushtetarëve, nxënësve e studentëve, studiuesve dhe publikut të gjerë.

Uroj që lexuesit të gjejnë kënaqësi duke lexuar këtë libër me njohuri e aspekte të veçanta; por sidomos të ndërgjegjësohen dhe aktivizohen në mbështetje të ruajtjes dhe zhvillimit të pyjeve. Ndërsa autorit i uroj suksese të mëtejshme në përpjekjet e tij fisnike si pylltar i devotshëm.

Shpirti i trazuar në faqet e një libri

Nga ILMI DERVISHI


Botimi i çdo libri është një mirëseardhje për lexuesit, por libri “Ekstremume” të Hamdi Skejës ka risitë e tij në një poezi bashkëkohore me ndjenjat e shqetësimit e kohës në të cilën jetojmë. Poeti e mbush poezinë e tij me ndjenjën e dashurisë së pastër ndaj çdo gjëje të bukur në jetë, por edhe me rreze dite dhe shpresë drejt paqes e mirësisë për shpirtin e trazuar në këtë tranzicion që ky brez po e mban peshë në jetën e përditshme.

Në ciklin për dashurinë, një dashuri që siç thotë poeti: “Det e mal kaluar” për një “ringjallje dashurie” në përqafimin e përqafimit vjen me ndjeshmërinë aq dhe e shkruar bukur e në një “përgjërje” që siç thotë autori “të kalojnë kufijtë e zjarrmisë”.

Një cikël mjaft interesant është “Rrugë kotësie”. Në poezitë si të “Mjegullim”, “Zhgënjim”, “Pesha e natës” janë poezi që bartin brenda tyre shpirtin sa rebel aq të trazuar të autorit. Herë-herë bardhë e zi, në të shumtën një gji i tejdukshme me një ndriçim shkrepimë në qiell të ngarkuar me re. E tillw është poezia e tij. “Pas çdo humbje ka një fitore” shkruan redaktori i tij Dritan Thomaraj, dhe më i plotë si krijues vjen në dy ciklet “Mbi jetova” dhe “Rrënjët e mia”.

Në poezinë e tij ka elemente të “Biografisë” së tij të bashkëjetuar me jetën e përditshme, në momentet dhe rrethanat ku jeton shoqëria e sotme. E ndjeva veten si fëmijë kur shkruan për babanë, për nënën:

*Të drejtë i jap Babës (u prehtë në paqe)
Mirë e kishite njohur njerëzimin - ujk...
unë qëndrova gjithnjë i njëjtë,
dhe pse jeta me mua s’ka qenë e butë!*
Është nostalgjik në “Molla e Kurtit”, në vendlindjen e lidhur me shpirt. I dhimbzen fotografitë e vjetra që kanë filluar të zverdenen por që thonë shumë. I boshatiset shpirti



kur vlerat nuk vlerësohen si te poezia. Kur dhimbja na pushton por shpesh humb gjumin, qetësinë përballë “Panoramë e trishtë” apo të ngre krye dhe shpërthen në poezi të shkruara bukur.

Me shpirt poetik, me dhimbjen dhe krenarinë e të qenit baba në disa poezi për djalin, ndonëse shkruar në vetë të parë, poezia ka magjinë e saj që poeti e thotë në vargje “Ti ëndrra, qënia, shpirti im, falë teje, jetës ja vënë emrin gëzim!

Lexuesi, te libri “Ekstremume” nga Hamdi Skeja do gjeni veten në shumë poezi falë tematikës së gjerë, këndvështrimit sa në original dhe në nivel artistik.

Poezi nga Hamdi Skeja

DËSHIRË

Ndizet dëshira me mall,
sonte pranë të të kem.
Të shuaj zjarrin
siç shuhet magma në det.

Njëmijë puthje t’m’i dhurosh,
dhjetëfishin do ta kthej unë.
Frymën mbi trup t’ma lëshosh,
të dy t’rrëmbehemi në tonin lumë...

Buza mbi buzë të ndizet prush,
si dikur edhe sonte dëshiroj,
Natën ta bëjmë njëmijë...
Çasti ëmbëltues t’mos mbarojë!

RENDA...!

Renda skaj më skaj,
për të gjetur pak qetësi,
mbeta fajtor i pafaj,
mbështjellë me vetmi!

Ç’dreq bote është krijuar,
me kështjella padrejtësie?!
kurrë në jetë s’jam gëzuar.
Unë, i zoti i kësaj shtëpie!

MALL MËRGIMTARI!

i vetmuar në dhë të huaj,
si një zog pa të ngrohtën fole.
mërgimi më ka drobitur,
as gjumi i natës s’më zë.

Malli për familjen më ka kapluar.
Lot i kripur më rrjedh në sy...



Mërgimi shpirtin më ka copëtuar.
Asnjë çast nuk gjej qetësi...

Pritmë, nënë e dashur, se po vij.
Me mall, fort t’ju përqafoj...
Mëngjeset më gjejnë me lotë në sy.
Pa ju, në dhë të huaj, si mund të jetoj?!

MBI DJEPIN E DJALIT

Tek përkund tim bir në djepin e kuq,
përhumb në buzëqeshjen e tij të dliër...
ai s’do të flejë e shfaq ndonjë huq,
gajasem me të madhen dëshirë...

I këndoju: - fli, bir! Gjumë të qetë!
Sytë e përgjumur ia sodis me kërshëri
djepin vazhdoj ta lëkund lehtë-lehtë,
shpirti më mbushet me lumturi...

Katër Qytetarë të rinj Nderi në Shupenzës

Nga ZABIT LLESHI

Komuna e Shpenzës brenda mandatit të fundit shpalli katër "Qytetarë Nderi" të Komunës, ish veteran të Luftës e të Punës, si Din Sinani, Haziz Jellën (pas vdekjes), si dhe mësuesit e palodhur, shumë të njohur në Grykën e Vogël, Nazmi Xheleshin e Osman Patrini.

Ditët e ngjeshura para fushatës nuk i dhanë mundësi ish-Komunës të organizonte një ceremoni të thjeshtë për këtë eveniment të rëndësishëm, siç janë ato të dhënies së titujve qytetarëve më të rinj "Qytetar Nderi" të Shupenzës. Për t'u njohur me këto vendime të Komunës edhe më tej, po i drejtohem gazetës "Rruga e Arbërit", e cila si gjithnjë e ka kryer mjaft mirë funksionin e saj për informimin e opinionit të gjërë me veprimtaritë dhe vendimet e organeve qendrore dhe lokale.

Komuna e Shpenzës dhe ajo e Gjoricës krujuan një traditë të mirë në vlerësimin e kontributorëve shoqërorë, si ato të djersës dhe të mendjes, të mësuesve, kuadrove e veteranëve, që me siguri Bashkia e Bulqizës do t'i çojë më përpara. Është në nderin e Bashkisë që vlerat njerëzore, që shquhen në fusha të ndryshme të jetës shoqërore (që për fat të mirë janë shumë), të bëhen herëpashere, pa fushata dhe mundësisht kur njerëzit janë gjallë.



1. DIN HALIL SINANI – lindi më 1922 në një familje të varfër të fshatit Boçevë. Si shumë familje dibrane të Grykës së Vogël, edhe familja Sinani përjetoi genocidin e shovinistëve serbë para dhe pas Shpalljes së Pavarësisë. Dini mbaroi shkollën fillore në Homash. Pushtini i Shqipërisë nga Italia, më 7 prill 1939, la gjurmë në ndërgjegjen e të riut, prandaj u cilësua antifashist në atë kohë. Me formimin e Brigadës 18-Sulmuese u regjistrua vullnetar i saj. Luftoi deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë, ndërsa edhe familja e tij ishte bazë e Luftës Nac.Çlirimtare.

Pas çlirimit punoi në komandën e vendit, në shërbim të ruajtjes së rendit e qetësisë, në rindërtimin e shtëpive dhe institucioneve të rrënuara nga Lufta. Në vitin 1949 emërohet mësues në shkollën e Gjurasit, për pak kohë edhe në Shupenzë. Krahas mësimit dhe kontribut në zhdukjen e analfabetizmit nëpërmjet kurseve të organizuara me të rinj e të reja, me burra e gra në fshatrat e Grykës Vogël.

Me krijimin e kooperativave bujqësore, zgjidhet kryetar i në fshatin Boçevë, ndërsa me krijimin e kooperativave të bashkuara (6 fshatra), zgjidhet zv.kryetar. Gjatë kohës ndoqi disa kurse kualifikimi, si atë të kuadrove bujqësore etj. Gjithnjë është shquar për ndërgjegje të lartë në punë dhe veçanërisht në marrëdhënie me njerëzit. Ndhimonte kuadrot e reja me eksperiencën e tij në përmirësimin e punëve në ekonomi.

Din Sinani mbetet ndër njerëzit e zgjuar

të Grykës së Vogël, njeri i sakrificës, bujar e mikpritës. Fëmijët e tij dallohen në veprimtaritë e tyre. Opinioni shoqëror i njeri si punëtorë, me sjellje shumë të mira në fshat e në qytetin e Bulqizës, duke mbajtur traditën e babait të tyre. Pas daljes në pension, Sinani u dallua si veprimtar shoqëror, duke mbajtur detyrën e kryetarit të Veteranëve të Luftës Nacional-çlirimtare të komunës Shupenzë, derisa u nda nga jeta në vitin 2009. Komuna Shupenzë, me vendimin nr.16, dt.22.04.2015, i jep titullin "Qytetar Nderi".



2. HAZIZ MUHARREM JELLA – lindi më 1920 në një familje me tradita patriotike në Bllacë. Shkollën fillore e mbaroi në Gjoricë, duke qëndruar te të afërmit e tij. Shkolla e Gjoricës në atë kohë ishte e sistemit 5-klasë, me mësues Haxhi Ademin. Më 1940 thirret për shërbim ushtarak në Batalionin ku ishte komandant Spiro Mojsiu dhe mori pjesë në luftën italo-greke. Pak kohë punon në Shkodër, ku bie në kontakt me njësitet guerriale, merr pjesë në disa aksione për çlirimin e qytetit. Në korrik 1944 regjistrohet partisan në Brigadën 18-Sulmuese, së bashku me vëllain e tij Halitin dhe shumë bashkëfshatarë të tjerë nga Bllaca. Shtëpia e tij u kthye në bazë e Luftës, ku priti Çetën e Haxhi Lleshit dhe drejtues të tjerë të Nacionalçlirimtares në Dibër.

Pas çlirimit Hazizi mori pjesë në disa aksione të rinisë për rindërtimin e vendit, në hapjen e rrugëve dhe në ndërtimin e hidrocentralit të Shkopetit. Pas viteve 1950 zgjidhet në tre legjislatura kryetar i këshillit, detyrë që e kreu me përgjegjësi. Punoi shumë në drejtim të forcimit të unitetit të fshatit e më tej. Në vitin 1967 vendoset me gjithë familje në Homesh, ku pak vite më para ishte vendosë këtu edhe vëllai i tij Hysen Jella. Gjatë qëndrimit në vendbanimin e ri, ai krijoi shoqëri me njerëzit e këtushëm, duke mbajtur lart cilësitë e mira që e karakterizonin.

Haziz Jella që herët gjatë Luftës kishte marrë një ftohje dhe shëndeti i tij vinte gjithnjë në rënie. Ai ndahet nga jeta në moshën mw tw mirw, vetwm 49 vjeç, por edhe pse nw moshw te re, la pas një jetë të mbushur me luftë e punë në shërbim të atdheut. Fëmijët e tij u shkolluan dhe i çuan më tej dëshirat e prindërve.

Komiteti i Veteranëve të Bulqizës i propozoi Komunës Shupenzë për vlerësimin e figurës së tij. Komuna Shupenzë, me vendimin nr.16, datë 22.04.2015, e shpalli "Qytetar Nderi".



3. NAZMI QAZIM XHELESHI – lindi më 14.04.1939. Familja Xheleshi ishte Mazhica e erdhi në Boçevë për një jetë më të mirë. Pas shkollës 7-vjeçare në Shupenzë, mbaroi shkollën pedagogjike në Peshkopi dhe më 1 gusht të vitit 1959 punën në mësues në Majtar të Maqellarës. Në vitin 1962 transferohet në Shupenzë. Institutin Pedagogjik 2-vjeçar të Shkodrës në degën Kimi-Biologji e mbaroi në vitin 1966 dhe rikthehet mësues në Shupenzë. Transferohet në Gjoricë më 1969 dhe shpallet ndër mësuesit e dalluar të Dibrës për vitin 1971.

Për punë dhe rezultate të mira, emërohet zv.drejtor i shkollës në Shupenzë më 1972-1978. Më 1982 fillon punë në Lubalesh, si pasojë e ndryshimeve biografike dhe e luftës së klasave. Pas 5 vitesh emërohet mësues në Gjoricë dhe nga viti 1992-1997 është drejtor i asaj shkolle. Ndërsa mbylljen e punës dyzetvjeçare së mësuesisë e bëri në Shupenzë, drejtor i shkollës 8-vjeçare të Shupenzës.

Tashmë në pension, Naim Xheleshi mbetet një ndër mësuesit e drejtuesit e shkollave me emër të mirë në Grykën e Vogël, veteran i arsimit, së bashku me bashkëshorten e tij Kadrie Llanin. Kjo e fundit një mësuese shembullore në Homesh e Boçevë. Të dy kanë kontribut të pazëvendësueshëm në edukimin e brezave në fushën e kulturës e përmirësimin e kushteve të jetesës në fshat.

4. OSMAN RAMIS PATRIA – është një figurë e arsimit në Shupenzë e fshatrat e saj. Lindi



më 7 shtator 1942 dhe pas kryerjes së arsimit të detyruar 7-vjeçar, vazhdoi dhe mbaroi shkollën pedagogjike "Shënjaze Juka" dhe Institutin Pedagogjik në Shkodër, dega Gjuhë-Letërsi. Osmani që në shkollën pedagogjike e më heret, kishte dëshirë dhe prirje letërsinë, veçanërisht krijimtarinë artistike dhe publicistikën.

Pas mbarimit të shkollës në Shkodër, filloi punën mësues në zonat e thella të Gollobordës, siç ishte Borova. Më 1964 e lëvizin për në Gjoricë, ku dha një ndihmë të të madhe në lëvizjen kulturore amatore, jo vetëm në shkollë, por edhe në grupin artistik të fshatrave të bashkuara. Në vitin 1968 transferohet nga Gjorica në Shupenzë, duke punuar me pasion. Më 1998 është drejtor i shkollës Shupenzë deri në vitin 2000 dhe mësues i shkollës së mesme deri në vitin 2010. Me përkushtim në arsim punoi edhe bashkëshortja e Osmanit, Kujtime Koçi, nga Çereneci, mbesa e e Sadik Koçit, patriot dhe bazë e Luftës Nacional-çlirimtare në Grykën e Vogël. Kujtimja punoi 35 vjet mësuese në Okshatinë, Boçevë e Homesh.

Shkollat e Grykës së Vogël, në saje të punës së këtyre mësuesve, kanë çuar përpara traditat patriotike të shkollës së Sait Najdinit, Shaqir Dacit, Abaz Xhafës, Haxhi Ademit, Hidër Manjanit etj. Me përvojën e krijuar, ata i radhitën shkollat tona në pararojë të shkollave të Dibrës.

Osman Patria nuk ishte thjeshtë mësues i gjuhës e letërsisë. Ai u muar me studimin e folklorit të Grykës Vogël, duke referuar në disa sesione e veprimtari të tjera shkencore. Ai është autor i librit "Thesaret e gjalla" dhe ka në dorëshkrim librin tjetër "Buka e gjakut", që hyn së shpejti në botim. Botimet dhe materialet e tjera të tij, janë dëshmi të punës së një intelektual të palodhur, të një mësuesi të talentuar, të një edukatori këmbëngulës.

Këshill i Komunës, bazuar në vlerësimin e kolektivit shkollor dhe veteranëve të fshatit, i jep titullin "Qytetar Nderi", me nr.13, datë 14.04.2015.

BASHKËPUNO ME REDAKSINË: NJOFTO RASTIN ME TELEFON OSE EMAIL DHE NJË GAZETAR I YNI DO T'JU NDIHMOJË TA BËNI PROBLEMIN TUAJ PUBLIK.

Mos ngurro! Duke bërë publike problemin tuaj, zgjidhja do të jetë më afër.
Shkruaj email: <rrugaearbërit@gmail.com> ose telefono: 069 20 68 603

**Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?
SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!
<rrugaearbërit@gmail.com>**

Pëllumbat e rrugës

(Fragment nga romani)

Nga RAMIZ GJINI

Tushi mori vesh se në sallën e bibliotekës së Bibollit, bëhej promovimi i një libri. Libri titullohej Blegërimat e dashurisë dhe ishte shkruar nga poeti dhe prozatori i madh Aush Loshi. Ai vendosi të shkonte në këtë aktivitet. Ky libër duhet lexuar, mendoi ai, pasi do të më bëjë të blegëri si një poet i madh. Lushja, do të preket nga blegërimat e mia e do fillojë të më dojë.

Kur hyri Tushi brenda sallës ku mbahej aktiviteti, qe ende shpejt; nuk kishte mbërritur ora e caktuar. Ndodheshin aty vetëm katër-pesë të ardhur, të cilët, kishin zënë vend të ulur në karrige. Organizatorët venin e vinin, për t'u dhënë dorën e fundit vendosjes së objekteve. Latif Kishaveci merrej me mikrofonin dhe foninë, duke bërë prova: një, dy, tre, katër...

Një mbesë e poetit Aush Loshit, studente e shkollës së mesme, po vendoste në tryeza shishet e pieve. Herë pas here, ajo ndalonte dhe hidhte vështrime për të parë nëse gjendej çdo gjë në vendin e duhur.

Diku andej nga radhët e para, Lemja, gruaja e shefit të policisë, Filip Zhulit, fliste me shitësen e bulmetit, Kaleme Shollën.

Kaleme qe gruaja e akademikut Hashim Sholla, që pritej të vinte për të mbajtur një kumtesë shkencore në lidhje me krijimtarinë e poetit dhe prozatorit Aush Loshi.

Tushi vajti dhe u ul diku pranë tyre.

Dy gratë po llafoleshin në lidhje me një krem, që quhej coconutoil. Kaleme thoshte se ky krem, i kishte prishur lëkurën e fytyrës dhe se nuk do ta përdorte kurrë më. Lemja, e kundërshtonte. Thoshte se kremi coconutoil, qe më i miri në botë dhe se e kishte lexuar në matrikull, që ishte njëqindpërqind organik.

Tushi i dëgjonte pa ndonjë interes, madje ngase i dhimbte koka, ndjeu bezdi dhe vendosi të ndërronte vend. Por ndodhi që gratë e ndërprejnë diskutimin rreth kremit coconutoil. Lemja, nisi t'i rrëfente Kalemes një histori tjetër. Kjo histori, filloi t'i pëlqente Tushit, ndaj mbajti vesh.

-Shitësi më dha kartën, të cilën e gërvish-ta, por nuk fitova. - thoshte Lemja. - Bleva një tjetër kartë, e gërvish-ta edhe atë, por prap nuk fitova! Mora edhe një kartë të tretë. E gërvish-ta dhe fitova pesë mijë lekë... Pesë mijë, thashë, moj, nuk thashë tetë! Me këto lekë bleva pesë karta. I gërvish-ta dhe fitova një mijë. Ia dhashë shitësit të më jepte një tjetër kartë dhe ai ma dha. Desha ta gërvish-ta, por nuk më bënte zemra ta gërvish-ta. Si, pse? Kisha frikë, moj ti, se do të humbisja... Përse, tjetër?! Ç'të bëja? Thashë me vete: mjaft kam gërvish-tur... Jo, moj, jo... Unë nuk i blej ato karta sepse dua të fitoj. Ti e di: kam aq shumë para sa nuk më duhen më. Sak nuk më duhen. Unë i blej ato, thjeshtë, sepse më pëlqen të gërvish. E, mirë, tani... Gërvish, gërvish, njësoj është. Por, kuptohet, që edhe të humb para nuk më pëlqen. Kështu, ia ktheva kartën shitësit dhe i mora lekët.

Me ato lekë, bleva tre llokume me arra. Llokume moj thashë, llokume... Një llokume e hëngra vetë, tjetra më ra padashje në tokë. Këto që vijnë nga Turqia, ti e di, janë llokume të mira. I ke provuar ndonjëherë? Janë aq të ëmbël sa të shkrihen në gojë. Jo, moj, jo, nuk janë vetëm sheqer. Kanë edhe shumë gjëra të tjera brenda. Blen edhe ti? Shumë mirë bën, që blen edhe ti nga ato, pasi këto të vendit nuk bëjnë fare. Unë blej gjithmonë... Pra, kur më ra llokumja në tokë, mu dhims. Thashë njëherë, të ulem e ta marr, por ti e din, moj Kaleme, që në tokë udhëtojnë mikroba. Kam lexuar diku, që mikrobet transportojnë sëmundje kondra-bandë nga njëri vend tek tjetri. Edhe njerëzit në pushtet, prandaj bëjnë kondra-bandë, sepse janë infektuar nga mikroba të tilla. Kontra-banda, është sëmundje, që shkaktohet dhe përhapet nga mikrobet. Kështu, e lash, nuk e mora fare atë llokume. Pastaj, pashë që ia ngjiti dorën një lypës, që kaloi atypari.

Llokumen e tretë, ia fala një fëmie qaraman, i cili, fare pranë meje, shkërryhej në tokë, përplaste këmbët e qante. Uaaa...! çfarë fëmije

Ramiz Gjini

Pëllumbat e rrugës
Roman

Botimet M&B


ISBN:
978-9928-172-56-3

Çmimi: 700 lekë

Ramiz Gjini

Pëllumbat e rrugës

Roman



BOTIMET M&B

mistrec që ishte, moj ti! I ankohej të emës: donte që në vend të një ariu prej pellushi, e ëma t'i blinte e t'i jepte minaren e xhamisë së Bibollit! Kur i dhashë llokumen, ai u qetësua, nuk e deshë më minaren e xhamisë. Prap po qesh ti? Jo, moj, jo, nuk e them për t'u tallur. Jam grua serioze unë, nuk jam shakaxhie... Dëgjo, tani, dëgjo...

E ëma e fëmijut, më falenderoi... Eh! mirë, edhe ti tani... Ngele duke më korriguar! Fëmijës, fëmijut, njësoj është. Pra, ajo më falenderoi. Madje shkëmbyen edhe numrat e telefonit. Më duket se quhej Hajrie. Hajria ngeli pa mend kur unë i thashë, që isha gruaja e shefit të policisë Filip Zhulit. Si...? u habit ajo. Je gruaja e sherifit të policisë? Jo e sherifit, moj, i thashë, por e shefit. Ne nuk kemi sherif në Biboll. Në fakt e kemi një sherif, kemi atë shoferin e autobuzit, Sherif Dermekun. Prit, moj, mjaft qeshë... E thashë ashtu kot, sa për muhabet, sepse e di që kemi shumë njerëz me emrin Sherif. Mirë, tani, mirë... Edhe pak dhe mbarova... Pra, kur i thashë se isha gruaja e shefit të policisë, nuk donte ta besonte. Prej habitës, bëri dy hapa prapa, u pengua dhe u rrëzua në tokë. Të be-tohem moj Kaleme, nuk të gënjej.

E ndihmova të ngrihej dhe ajo e shkreta më falenderoi. Si u ndamë, vajta në shtëpi. U ula pranë dritares që të prisja të vinte im shoq, Filipi.

Teksa rrija në dritare, hodha sytë poshtë në rrugë dhe, uaaa...! moj Kaleme! Uaaa...! moj motra ime, çfarë llahtari! U llahtarisa kur mendova, që disa gra të Bibollit, marrin guximin dhe hidhen nga kati i pestë, apo i gjashtë, edhe pse e dinë, që vdekjen e kanë të sigurtë. Unë për vete nuk do ta bëja kurrë këtë. Kurrën e kurrës! Do ta bëje ti, Kaleme? Hë, pra... Nuk bëhet, jo. Fundja, moj motra ime, përse do ta bëjmë? Nuk kemi asnjë arsye për ta bërë një gjë të tillë. Apo e kam gabim? Hë, thuaj! A nuk është tmerr, vetëm ta mendosh?! Si? Ç'thua moj? Po u hodhe, hapi krahët sa të duash, vdekjen e ke të sigurtë. I thonë gjashtë kate, oj ti! Nuk po hidhesh në valle, por po hidhesh nga maja e pallatit. Pastaj jeta është e bukur... Një gjumë do t'i fshinte të gjitha mendimet e liga. Prandaj fika dritën dhe u shtriva për të fjetur. ...Hë moj dëgjo se ngele duke kthyer kokën nga dera! Do të të vijë edhe burri. Duro. Të tha që do të vijë? Atëherë, përse mërzhitesh? E di, e di, që ka për të mbajtur kumtesë... Dëgjo, tani, dëgjo: andej nga e vona, erdhi im shoq, Filipi. Menjëherë e kuptova që kishte pirë, sepse e dëgjova qysh kur ndodhej prapa derës. Lu deshën dhjetë minuta të fuste çelsin në vrimë për të hapur derën. Pastaj kur hyri, kuptova që nuk isha gabuar, sepse të qelbte era e alkolit. Epo, hajt ma, thashë me vete, do ta bëjmë njëherë; sepse burri sido që të jetë, i dehur apo jo, ai burrë është, në krevat nuk është i keq. Pse qesh, moj si budallaçkë? A nuk është kështu? Uuuu... kjo! Të raftë pika, të raftë! Shikon? Edhe ty ta ka qefi... Mjaft, tani, mjaft qesh! Mjaft, pra...! Do më lësh ta tregoj gjer në fund apo jo? ...Pra, siç thashë hyri Filipi

brenda. Si hyri brenda, u zhvesh, u fut poshtë jorganit dhe u rehatua. Pastaj tamam kur unë prisja të zgjaste dorën të më prekte, ai hapi gojën e tha se bota po shkonte drejt ngrohjes globale dhe se kjo do të ishte një katastrofë e madhe për gjithë njerëzimin. Tani merre me mend vetë, moj motër, çfarë ndjeva ato çaste. E di si u bëra?! Më erdhi aq inatë sa... Çfarë prisja unë të thoshte dhe çfarë tha ai, damull-madhi! Mu ngritën nervat. Im shoq, moj ti, gjithmonë mendon më të keqen. E mendon dhe e thotë bash në vendin dhe kohën e gabuar. Dhe unë, nuk di çfarë të bëj me të. Nuk është fare optimist. Unë nuk u shqetësova pse ai nuk... Kupton ç'dua të them? Fare, fare nuk u shqetësova. Por, a ishte vendi dhe koha për ta thënë atë llaft, moj aman? Rri, pra, mos qesh! Shif, kjo... Do më lësh të mbaroj, apo si? Ku e kisha fjalën? Hë, po... I fola, nuk lash fjalë pa i thënë, derisa më në fund, më erdhi shumë keq për veten dhe nisa të qaja. Kurse ai, në vend që të prekej e të më merrte me të mirë, lëshoj një pordhë aq të madhe, sa u ngrit jorgani përpjetë. Atëherë, nuk u përbajta dot dhe e quajta derr. ...Prap po qesh ti, moj? Për kokë të fëmijëve, derr i thashë. Nuk po tallem. Do më lësh të mbaroj, apo si e ke hallin. Prit, pra, ta vazhdoj... I thashë: ik shko e pordhë në ndonjë konferencë shtypi; ose pordhi sekretares tënde, asaj fyryfçkës... Ti s'je tjetër veçse një derr me feçkë të llangosur. Kështu i thashë. Si? Të shkruva? ...Më raftë pika, po të gënjeva! ... Si?! E çfarë pastaj pse e kam burrë? Mirë, po pres sa të mblendhësh veten ti, pastaj vazhdoj prap unë... Ai nuk u besoi veshëve. E di si u bë? Ç'të të them...! Pa thënë asnjë fjalë, u ngrit, u vesh, hapi sirtarin e komosë dhe mori pistoletën. Më ngriu gjaku se thashë do më vriste. Por ai mori edhe dy krëhër të tjerë me fishekë dhe doli nga shtëpia. I hypi makinës, dhe për ta bërë veten të pakrahasueshëm, vajti belaziu e vrau gjithë tufën me derra të Ndoc Noksanit. Kur u kthye tani, moj grua, gjej ndonjë krahasim tjetër sepse nuk ka më derra. I vrava të gjithë.

Tani, moj Kaleme, qesh sa të duash, sepse e ke hak... Nuk ka më derra, tha Filipi! Si nuk paska më derra?! Derra nuk pati vetëm Ndoc Noksani, derra ka gjithë bota. Si i thua ti kësaj, moj Kaleme? Si i thua ti kësaj, moj motër? Një i dehur, kur nuk është agresiv, bëhet i lezeçëm... Por dëmit, moj, atij si i bëhej? I thashë Filipit, të shkonte menjëherë dhe t'i paguante dëmin Ndocit. Sepse unë...
Ato çaste, Lemja e ndërpreu rrëfimin, sepse ua afrua aty vetë poeti Aush Loshi.

Aushi, i vuri Tushit dorën në sup dhe me shumë dashamirësi i tha:
- Ti more djalë, po më dukesh shumë i mërzhitur. A nuk më thua ç'hall të ka gjetur?

- Jam mirë, - tha Tushi. - Vetëm se po më dhemb pak koka.

- Nga cila anë, du me thanë, të dhemb më shumë, more bir?- pyeti Aushi.

- Nga ana e majtë, - tha Tushi. Dhe preku kokën me dorë.

- Si të vjen dhimbja, me hope, apo e vazh-

"Pëllumbat e rrugës" është romani që përmbyll trilogjinë e rrëfimeve mbi 'Bibollin'.

dushme.

- Më vjen me hope. Në kokë kam rrahje si ato të zemrës. Sa herë rreh, dhemb.

- Po anën tjetër të kokës, si e ndjen?

- Atë nuk e ndjej fare. - tha Tushi.- Sikur nuk e kam timen, sikur kanë marrë gjysmën e kokës së një personi tjetër dhe ia kanë ngjitur gjysmës time.

- E ka nga dashuria, - tha poeti Aush me sigurinë e një kompetenti.- Gjysma e kokës tënde, dhemb për shkak të gjysmë tjetër, që nuk është e jotja. Njerëzit dashurohen sepse janë gjysma. Prandaj kërkojnë të bashkohen për t'u plotësuar. Bashkimi i dy gjysmave bën një të plotë. Por do bëjmë diçka...

Mori nga tryeza librin e tij me blegërima dashurie, shkruajti një autograf, ia la në dorë Tushit e tha:

- Të rekomandoj ta hapësh librin në faqen numër dyqind e pesëdhjetë. Aty do të geshë një poezi, që unë e kam shkruar për dhimbjen e kokës, që shkakton nganjëherë dashuria. Sapo ta lexosh, do të të pushojë. Pastaj mund të lexosh të tjerat, një nga një...

- Ju falenderoj shumë... - tha Tushi.

- Nuk ka përse, - ia ktheu Aushi. - Unë jam poet i popullit, shkruaj për popullin dhe preki me penë aty ku i dhëmb popullit.

- Nëse mund t'ju pyes, - tha Tushi, - a gjen-det këtu në këtë libër edhe ndonjë poezi për shtërgimim e barkut, sepse nganjëherë... Pastaj mua më dhëmbin edhe kyçet kur prishet koha.

- Të them të drejtën, - nisi të thoshte Aushi, - në librin tim, nuk ka ndonjë poezi, shkruar enkas për këto lloj dhimbjesh, por e them me bindje të thellë, që secila prej tyre, mund t'ju ndihmojë disi... Du me thanë, do ndjeni një far lehtësimi, menjëherë sapo t'i lexoni.

Ato çaste, mbërriti aty Liza Piluri, një zonjë e shëmtuar kjo, por që vishej bukur me paratë e të shoqit që bënte biznes ndërtime.

Aushi, i kërkoi ndjesë Tushit dhe u kthye të përshëndetej me Lizën, e cila, ndërsa ecte drejt tij, hapi krahët e thirrri:

- Po ku je more gjigand, more Sulejmani i Madhërisëm i letërsisë bashkëkohore?! Uaaa! Sa shumë kohë u bë pa u parë! Uaaa...! Sa shumë kohë!

- A vërtet, ti je Liza? - pyeti Aushi dhe hapi krahët ta përqafohte. - Vërtet ti je?! Tani që po të shikoj nuk po u besoj syve. Si ka mundësi që nuk paskeni ndryshuar fare?! Qenke tamam ajo Liza e bukur, ajo që keni qenë para tridhjetë vjetësh, pa asnjë ndryshim. Uaaaa...! çfarë befasi!

Dhe u shtrënguan në një përqaftim që zgjati plot dhjetë minuta. Gjatë këtij përqaftimi, ata patën rastin të bënin edhe një dorë muhabet duke i pëshpëritur njëri-tjetrit vesh më vesh. Sa herë i pëshpëriste Aushi, qeshte Liza, kur i pëshpëriste Liza, qeshnin të dy.

Kjo Liza e bukur, kishte një hundë si sqep papagalli, majën e së cilës, e kishte lyer padashje me të kuq buzësh. Qe e dobët si thaçkë, por i kish mbushur gropëzat e faqeve me krem të trashë. Për t'i dhënë fytyrës formë të rregullt ovale, në vend të furçës, ajo kishte përdorur një shpatull gura ato që ustallarët i përdorin për të patinuar muret. Mbante në kokë një kapele me pupla, të cilat, padyshim vinin nga pularia me shumë emër e Hilë Kakarriqit. Kishte mbathur një palë këpucë me taka të larta prej qelqi delikat, ndaj ecte ngadalë e gjithë kujdes, që të mos i thyeshin. Nga supi i djathtë, i varej me rryp një çantë e bukur, moderne, sa një kuti shkrepseje, brenda së cilës, mbante kunjat për të rruar dhëmbët e prishur.

Tushi i hodhi një sy librit që i la në dorë Aushi dhe kuptoi, që ky libër, do t'i qëndronte shumë gjatë kohës, sepse kishte kapakë të trashë, fletë të trasha, shkronja të mëdha të shkruara me bojë të trashë, si dhe ishte qepur me pë, gjithashtu të trashë.

Kur i shfletojte fletët, ata lëshonin një si gërvimë aq melankolike sa duhej të kishte zemër të fortë t'i përballonte emocionet që të pushtonin. Edhe po të mos i lexojte fare blegërimat që kishte brenda ky libër, mjaftonte kjo gërvimë, që lëshonin fletët për të kuptuar vlerat e Aushit si poet.

Ai u përpoq të gjente faqen me numër dyqind e pesëdhjetë, ku ndodhej ajo poezia, që i rekomandoi Aushi, por u çudit kur zbuloi, që libri na kishte vetëm njëqind e dhjetë faqe.

Kështu, ai mendoi, që ndoshta nuk e kish pas dëgjuar mirë çfarë i tha poeti Aush.



Ftesë për bashkëpunim


Gazeta "Rruga e Arbërit" në bashkëpunim me Botimet M&B ka në projekte për disa veprimtari dhe botime në fushën e kulturës, me vlera historike, kulturore dhe kombëtare për Dibrën dhe gjithë Shqipërinë.

Ftojme individë, shoqata apo institucione vendore të bëhen bashkërealizues të këtyre projekteve.

Për më shumë informacion mund të shkruani në email mmbotime@gmail.com, rrugaearbërit@gmail.com

ose mund të telefononi në numrin **069 20 68 603**.
Faleminderit!

Librat e botuar nga Botimet M&B mund ti gjeni në Tiranë pranë librarisë së Shtëpisë Botuese M&B, në rrjetin e librarive "Adrion", si dhe në disa librari kryesore në Tiranë.
Në Peshkopi: Libraria "Fleta XXI", pranë Muzeut.
Në Durrës: Libraria "Dyrrah". Tel. 0694053353
Për porosi: tel. (04) 22 33 283 / 069 20 68 603
068 65 08 441 / 067 30 73 265
E-mail: <mmbotime@gmail.com>



Pajtohu në gazetën RRUGA E ARBËRIT

Merr versionin PDF ose kopjen print duke filluar me 50 lekë/muaj



Gazeta ofron faqet e saj për REKLAMA apo NJOFTIME të ndryshme për biznese dhe individë.

ÇMIME TË ARSYESHME për faqet me ngjyra dhe bardh e zi.

Për individët, njoftimet deri në 50 fjalë (1/16 e faqes) ofrohen falas!

Për informacion:
E-mail: rrugaearbërit@gmail.com
Tel: +355 69 20 68 603

 **BLERTA METHASANI**
photographer

Mob. 069 88 55 999
E-mail: blerta.methasani@gmail.com
FB: Blerta Methasani Photography

Wedding, Event
Portraits & More

Qendra Shqiptare e Syve

Prof. Asc. ALI TONUZI
kirurg vitreorentinal



Adresa: Rr. "Dibrës", Kompleksi Halili, Përballë Vila "Gold", Kati II.
Tel: +355 4 2419087
Cel: 0694003600
E-mail: tonuzi_ali@hotmail.com

Eja në Botën e Ngjyrave

"ZAYA STUDIO"
nën kujdesin e piktorit Zaim Elezi, me një eksperiencë të madhe në këtë fushë

ORGANIZON KURSE PËR TË GJITHA MOSHAT

Së bashku ne mund:

- Të mësojmë të vizatojmë
- Të mësojmë të pikturojmë
- Të mësojmë gjithçka rreth artit figurativ

Adresa: Rr. "Zenel Baboçi", pall. Ferar.
Tel: 068 22 46 400

Bëj pajtimin tënd me



përmes emailit
<rrugaearbërit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

